



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 11 DHE 12 KORRIK 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 11. I 12. JULA 2013. GODINE**

**KORRIK - JUL
2013**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sistemin e lejeve dhe licencave,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221 dhe nr. 04/L-116,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tarifat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë,
5. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 04-L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor,
6. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2012,
7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për masat mbrojtëse në importe,
8. Shqyrtimi i raportit vjetor të performansës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012,
9. Shqyrtimi i raportit përfundimtar të Komisionit Hetimor Parlamentar,
10. Zgjedhja e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës.

Dnevni red

1. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-165 o Budžetu Republike Kosova za 2013. godinu,
2. Prvo razmatranje Nacrta zakona o sistemu dozvola i licenci,
3. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 03/L-048 o mendožiranju javnih finansija i odgovornostima, izmenjen i dopunjen zakonima br. 03/L-221 i br. 04/L-116,
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona o posebnim tarifama akcize na početnu i malu proizvodnju alkoholnih produkata proizvedenih na Kosovu,
5. Razmatranje preporuke Komisije za budžet i finansije u vezi odluke Predsednika Republike Kosova o vraćanju Zakona br.04/L-163 o robi oslobođene od carinskog poreza i robe sa nula tarifom carinskog poreza,
6. Razmatranje godišnjeg izveštaja Regulativnog autoriteta elektronskih i poštanskih komunikacija za 2012. godinu,
7. Razmatranje izveštaja Komisije za ekonomski razvoj, infrastrukturu, trgovinu i industriju o nadgledanju sprovođenja Zakona o zaštitnim merama na uvoze,
8. Razmatranje godišnjeg izveštaja o performansi sa reviziranim finansijskim pregledima Kancelarije generalnog revizora za 2012. godinu,
9. Razmatranje završnog izveštaja Parlamentarne istražne komisije,
10. Izbor direktora Agencije za menadžiranje memorijalnih kompleksa Kosova.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
Zëvendëskryeministra,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

E do fjalën Adem Grabovci, apo Arben Gashi? Për rend dite, Adem Grabovci, kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!
Propozoj që si pikë e parë e rendit të ditës në këtë seancë të hyjë leximi i dytë i Projektligjit për amnistinë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kryetari Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Edhe ne e përkrahim të futet në rend të ditës.

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, kryetari i Grupit, Visar Ymeri, e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!
Siç e kemi thënë edhe më herët, kjo shkelje flagrante e rregullave dhe procedurave të Kuvendit është e papranueshme. Dhe, nëse ka diçka që po e dhunon këtë Kuvend, është pikërisht kjo që po ndodh kështu në aspektin formal të shkeljes së rregullave, dhe kjo trysni informale që po i vjen këtij Kuvendi nga qarqet e ndryshme.

Po ju përsëris edhe një herë, neni 56 i Rregullores së Kuvendit thotë që shqyrtimi i parë i një projektligji nuk mund të bëhet pa kaluar dy javë pune, e as më vonë se katër javë pune nga dita e shpërndarjes së tij, ndërkohë që Ligjin për amnistinë, le që e diskutuam pa kaluar as gjashtë ditë të mira pune, por tash kërkohet që ta fusim edhe në rend dite pa kaluar as një ditë e plotë në lexim të dytë.

Neni 57, thotë: Pas miratimit të projektligjit në shqyrtim të parë, Kuvendi e ngarkon për shqyrtim të mëtejshëm Komisionin Funksional si raportues dhe komisione tjera, që janë komisione të përhershme, katër sosh.

Po ashtu thotë që, nën tre: Amendamente në projektligj mund të parashtrojë deputeti, grupi parlamentar, komisioni parlamentar dhe Qeveria në afat prej dy javësh pune nga miratimi në parim. Këtu nuk po ua japim as grupeve parlamentare, as deputetëve individualë dy javë kohë në mënyrë që të parashtrojnë amendamente. Pra, amendamentimi i këtij projektligji po bëhet i pamundshëm, përveç disa amendamenteve që kanë ardhur nga seanca.

Edhe pika gjashtë e këtij neni thotë: Komisioni Funkcional i Kuvendit paraqet raportin me rekomandime për projektligjin brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë. Pra, po e përsëris, po paraqiten brenda dy orëve vlerësimet e katër komisioneve që i kemi këtu, që na kanë ardhur tash, domethënë që u shpërndanë tash pasi hymë në seancë, vlerësimi i katër komisioneve, të cilat e paskan vlerësuar këtë Ligj për amnisti dhe i paskan dhënë vlerësimet e tyre për ngarkesat buxhetore e kështu me radhë dhe përputhjen me ‘acquis communautaire’, përputhjen me Kushtetutën e Kosovës e kështu me radhë. Domethënë, edhe po të kishim super-komisione nuk do të mund ta bënim një gjë të tillë, po mënyra si po udhëhiqen edhe komisionet, e veçanërisht këto komisionet e përhershme, është për të të ardhur keq se çfarë po i bëhet këtij Kuvendi që po quhet i Republikës së Kosovës, një kuvend të cilin të tjerët po e mbrojnë si një kuvend demokratik.

Pra, ne jemi absolutisht kundër të kësaj shpërfilljeje të Kuvendit dhe të këtij dhunimi të Kuvendit dhe procedurave të Kuvendit, se nëse nuk i ndjekim rregullat dhe procedurat, atëherë nuk mund të themi që kemi kuvend. Dhe nëse këto rregulla shpërfillen në këtë masë kaq drastike nga këta deputetë, atëherë vërtet çdo gjë lejohet në Kuvend dhe çdo gjë do të lejohet brenda këtij Kuvendi. Faleminderit!

KRYETARI: Nën një, Rregullorja e Kuvendit nuk e ka vetëm një, ose dy nene. Neni 84, shmangia e Rregullores, shkruan: “Për t’iu shmangur Rregullores së Kuvendit vendoset me 2/3 e deputetëve të pranishëm në mbledhjen plenare. Shmangia mund të bëhet kur kjo nuk bie në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me standardet evropiane”. Pra, shmangia është bërë nga 2/3 e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Nëse kjo rregull bie ndesh me rregullat evropiane, atëherë nuk është dashur të jetë fare në Rregullore.

Neni 44 i Rregullores shkruan: “Kryesia, në bashkëpunim me kryetarët e grupeve parlamentare, e përcakton rendin e ditës për mbledhjen e radhës së Kuvendit, rendi i ditës u dërgohet deputetëve”, pika një.

Pika dy: “Rendi i ditës konsiderohet i miratuar, përveçse ku në fillim të mbledhjes një ose më shumë grupe parlamentare përfaqësuese të një ose më shumë komisioneve, së paku 6 deputetë, ia propozojnë me shkrim kryetarit një amendament për rendin e ditës, përkatësisht nëse një deputet e ngre çështjen e ngutshme dhe kjo e merr miratimin e shumicës”, neni 42 i Rregullores.

Shqyrtimi i çështjeve urgjente, neni 49 i Rregullores: “Në secilën mbledhje plenare, deputeti, duke e njoftuar përkatësisht kryetarin e Kuvendit mund të propozojë që Kuvendi ta shqyrtojë menjëherë një çështje urgjente, e cila duhet të jetë në përputhje me përkufizimin e shtojcës së parë të shprehjeve të Rregullores”. Do të thotë, Rregullorja është anashkaluar dhe i jep mundësi Kuvendit në raste të caktuara për t’iu shmangur rregullave tjera që janë në fuqi.

Vazhdojmë me Aleancën, kryetari Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kryetar!
Nuk kam çfarë të shtojmë, duhet të procedojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!
Edhe Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah shqyrtimin e dytë të projektligjit.

KRYETARI: SLS-ja, kryetari Sasha Milosavleviq e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLEVIĆ: Hvala predsedniče!
I Poslanički klub Samostalne liberalne strane se slaže sa tim da prva tačka dnevnog reda bude Zakon o amnestiji.

KRYETARI: Grupi Parlamentar “6+”, kryetarja Myfer Shiniq, e ka fjalën.

MYFERA SHINIK: “6+” parlamentar grupu da bu naktanën geqmesini, ynerilen noktanën gjyndeme alnmasënë kabuledijor. Teshekyrederim!

KRYETARI: Dhe, kryetari i Grupit “Zajednička Budućnost”, Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedničke!
I Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” slaže se da se Nacrta zakona o Amnestiji bude na dnevnom redu na drugom čitanju.

KRYETARI: Atëherë shkojmë në votim për shmangie, për ta caktuar pastaj si pikë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 86 vota për, 14 kundër dhe asnjë abstenim, bëjmë shmangie. Do të thotë Kuvendi e pranon shmangien dhe e radhit si pikë e parë e rendit të ditës.

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për amnisti

Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit!
Të nderuar kolegë deputetë,
Komisioni për Legjislacion, me kërkesë të kryesuesit të seancës dhe të seancës së paradites, mbajti mbledhje, në të cilën e shqyrtoi Projektligjin për amnisti dhe vendosi që komisioneve kryesore dhe deputetëve t’u procedohet për shqyrtim dhe miratim Projektligji për amnisti pa amendamente. Faleminderit!

KRYETARI: Grupet parlamentare e doni fjalën, apo e keni thënë atë? Mirë, janë katër amendamente. Një amendament i parashtruar nga deputetja Lumnije Morina dhe tri amendamente të propozuara nga deputetja Alma Lama, pa përkrahjen e Komisionit Funksional, por do të hidhen në votim.

Prandaj, para se të fillojmë votimin, ju lus për një votim për ta konfirmuar praninë e deputetëve. Votojmë tash!

Prania është 106 deputetë, edhe pse këtu shënon 111. Prania fizike është 107 deputetë.

Fjalën e ka deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Kryetar, veç të njoftohen deputetët se a duhet të kalojnë amendamentet me 2/3 që të konsiderohet se kanë kaluar. Ta dinë që për të kaluar një amendament duhet të votohet me 2/3 e votave të gjithë deputetëve, sikur ligji.

KRYETARI: Dihet që edhe për amendamentet për të kaluar duhet t'i kenë së paku 80 vota. Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Për procedurë, zoti kryetar!

Përpiqem ta kuptoj edhe këtë mënyrë të jashtëzakonshme të funksionimit me shmangie nga procedura, por kjo çështje nuk lejohet në mënyrën siç po e bëjmë ne. Ne po e instalojmë sot praktikën që me 2/3 e votave t'i mohohet e drejta cilitdo deputet ose cilitdo grup më të vogël se 2/3 që edhe ta procedojnë një amendament. Është krejt e palejueshme dhe krejt jodemokratike.

Për më tepër, ne sot e kishim diskutimin, megjithatë në parim dhe ishte vazhdim i seancës së përparshme. Unë kam paralajmëruar dhe kam bërë praktikisht 2-3 amendamente orale. Te ne, për fat të keq, këto nuk janë proceduar, por amendamentet orale në praktikën demokratike parlamentare janë po ashtu të barasvlershme. Nuk është krijuar hapësira për shqyrtimin e tyre dhe mendoj që në shqyrtimin në parim, meqë ishin substanciale dhe parimore, duhej shqyrtuar nga sponsoruesi i ligjit, duhej thënë pajtohen ose s'pajtohen, në mënyrë që pastaj ne të vendosim. E konsideroj të lëndueshme proceduralisht këtë praktikë.

Prandaj, megjithatë, unë insistoј që të respektohet procedura, në rastin e kundërt më imponohet që të mos votoј. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Hydajet! Të gjitha grupet janë më të vogla se 2/3 e deputetëve në Kuvend.

Unë këtu i kam 4 amendamente për të cilat do të votojmë. Është puna e deputetëve se si votojnë. Prandaj, ne po e ndjekim anashkalimin e Rregullores. Është votua me 2/3 e deputetëve. Nuk është një çështje që nuk e kemi ditur, kur e kemi votuar këtë çështje.

Nëse kjo që e vendosëm ne është kundër Kushtetutës, janë mënyrat dhe deputetët mund ta dërgojnë në Gjykatën Kushtetuese dhe atje janë interpretuesit finalë të Kushtetutës. Kështu që këto rregulla mendoj që janë të qarta.

Fillojmë me votimin e amendamenteve.

Fjalën e ka deputetja Lumnije Morina për amendamentin nr. 1, të propozuar nga ajo.

LUMNIJE MORINA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Amendamenti, të cilin e kam propozuar në seancën plenare të paradites, nuk e ka marrë në shqyrtim Komisioni për Legjislacion, edhe pse unë jam kujdesur që t'i respektoj të gjitha procedurat, e kam dorëzuar te stafi, i cili duhet ta protokollojë, është protokolluar dhe i ka kaluar të gjitha procedurat e nevojshme. Pra, e kam dorëzua me shkrim dhe e kam protokolluar.

Mirëpo, tani të gjithë deputetët e Parlamentit të Kosovës e kanë para vetes amendamentin, të cilin e kam propozuar edhe para dite dhe nuk po e shoh të arsyeshme ta lexoj, vetëm kërkoj prej deputetëve që ta përkrahin dhe ta mbështetin këtë amendament. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Pra, e votojmë amendamentin e propozuar nga deputetja Lumnije Morina, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Me 14 vota për, 59 vota kundër dhe 4 abstenime, amendamenti nuk kalon.

Amendamenti 2 nga deputetja Alma Lama. Deputete, e do fjalën për arsyetimin e amendamentit?

ALMA LAMA: Faleminderit, kryetar!

Edhe unë në lidhje me procedurat do të thosha që nuk i shoh si demokratike. Vetëm në rast se do ta kishim ndonjë gjendje të jashtëzakonshme do të mund të miratohej një ligj brenda ditës, por sido që të jetë, pavarësisht se kjo po ndodh me urgjencë, unë po me urgjencë i përgatita tri amendamente, në mënyrë që të përmirësohet sadopak ky projektligj. I kam shkruar me shpejtësi, si do që të jetë.

Amendamenti i parë është ky: Në lidhje me Projektligjin për amnistinë të fshihen nga ky projektligj të gjitha ato vepra penale, të cilat janë të rreshtuara aty, që janë kundër individit, e që nuk kanë janë të drejtuara kundër rendit kushtetues të Republikës së Kosovës.

Arsyetimi: Përfshirja e veprave penale kundër individit është në kundërshtim me nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe kjo ka të bëjë me mjetet juridike. Besoj që i kam shpjeguar edhe në seancën e paradites. Prandaj, ju ftoj ta hidhni në votim këtë amendament.

KRYETARI: Të tjerë për diskutim nuk ka. Shkojmë në votim, e votojmë amendamentin 2, të propozuar nga deputetja Alma Lama. Votojmë tash!

Me 18 vota për, 63 kundër dhe 3 abstenime, nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 3, i propozuar nga deputetja Alma Lama. Dëshiron ta sqarosh deputete? Fjalën deputetes Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Amendamenti im i dytë ka të bëjë me kohën kur duhet të fillojë amnistia, sepse e konsideroj që është e palogjikshme që të ketë një amnisti të papërcaktuar në kohë. Në fakt, është koha kur përfundon, por jo kur fillon.

Dhe, koha të cilën unë e kam propozuar është data 17 shkurt 2008, sepse pas kësaj date kemi mosfunksionimin e organeve gjyqësore në veri, të cilat u shkatërruan nga serbët atje.

Kështu që mendoj që është shumë e rëndësishme të ketë një datë të fillimit, sepse mungesa e kësaj date do të thotë t'i amnistosh të gjitha krimet që janë kryer në Kosovë. Mund ta marrim edhe nga 1900-ta, nejtë ato kanë vdekur por mund t'i marrim krimet e kryera gjatë '98-tës dhe '99-tës, për shembull zjarrvënja, janë djegur rreth 200 mijë shtëpi këtu. Pse duhet të amnistohen ato?

Prandaj, ju ftoj ta votoni edhe këtë amendament. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Besoj që të gjithë deputetët e kanë përpara amendamentin. Atëherë shkojmë në votimin e tij.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votimin e amendamentit të tretë të propozuar nga deputetja Alma Lama, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Votojmë tash!

Me 16 vota për, 61 kundër dhe 4 abstenime, nuk kalon amendamenti i tretë, i propozuar nga deputetja Alma Lama.

Edhe amendamenti 4 është i deputetes Alma Lama. Deputete, dëshiron ta shpjegosh? Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Më vjen keq që deputetët nuk po e kuptojnë që ky projektligj do të mund të ishte përmirësuar dukshëm me këto amendamente, sidoqoftë unë po e bëj punën time.

Amendamenti i tretë ka të bëjë me këtë: Të përcaktohen grupacionet që përfitojnë nga ky projektligji, grupacione të cilat kanë vepruar për shkak të bindjeve të tyre politike, pra kanë qenë vepra të motivuara politikisht dhe këta persona nuk e kanë njohur rendin kushtetues të Kosovës.

Arsyetim: Vepra të tilla penale, për shembull, si evazioni fiskal apo zjarrvënia mund të jenë të kryera edhe si vepra kundër shtetit, por edhe si krime ordinere. Kështu që mendoj që është shumë e rëndësishme që të bëhet kjo ndarje dhe të mos ketë një lloj amnistie kështu me një të rënë të lapsit, sepse mendoj që është shumë e dëmshme për shtetin e Kosovës. Thjesht, po amnistohen krimet me këtë ligj, prandaj ju ftoj ta votoni të gjithë edhe këtë amendament.

KRYETARI: Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. E votojmë amendamentin 4, i propozuar nga deputetja Alma Lama, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Me 13 vota për, 68 vota kundër dhe 2 abstenime, nuk kalon as amendamenti i katërt, i propozuar nga deputetja Alma Lama, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Para se ta votojmë projektligjin në tërësi me amendamentet që nuk u miratuan, lus deputetët që të votojnë për praninë. Votojmë tash!

Të pranishëm janë 103 deputetë, prania me kartelë është 112, prania fizike 111.

Tani lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. E votojmë ligjin në tërësi. Votojmë tash!

Konstatohet se me 90 vota për, 17 kundër dhe një abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për amnistinë.

Vazhdojmë pikën e dytë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

E ftoj ministrin e Financave, zotin Besim Beqaj, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që para jush ta prezantoj sot propozimin për rishikimin e buxhetit për vitin 2013.

Qeveria e Republikës së Kosovës vazhdimisht është përkushtuar për ngritjen e kapaciteteve të saj për një planifikim afatgjatë fiskal, që bazohet në analiza në saktë të

ambientit makro-ekonomik, si dhe nevojat zhvillimore të vendit, të përcaktuara në deklaratën e prioriteteve të Qeverisë, si dhe dokumente tjera strategjike.

Puna jonë graduale ka bërë që buxheti, të cilin po e propozoj sot për rishikim të ofrojë shërbime dhe iniciativa që kanë mbështetje financiare pothuajse dy herë e gjysmë më të larta se buxheti para gjashtë vjetësh dhe kjo rritje e jashtëzakonshme e ofertës buxhetore është bërë duke e mbajtur në nivele të ulëta deficitin buxhetor, që mesatarisht gjatë viteve të kaluara ka qenë rreth 2% të bruto-produktit vendor.

Projeksionet tona për të hyrat buxhetore mbeten të njëjta me parashikime fillestare, në vlerë prej 1 miliard e 423 milionë euro.

Po ashtu, shpenzimet e përgjithshme mbeten të njëjta, në shumë prej 1 miliard e 586 milionë, me ndryshme minimale në strukturë.

Për më shumë, këtë qasje racionale në realizimin e ambicieve zhvillimore e kemi instaluar dhe vazhdojmë ta instalojmë edhe nëpërmjet infrastrukturës ligjore.

Në vitin 2011 e kemi amendamentuar Ligjin për menaxhimin e financave publike, duke e bërë të obligueshëm respektimin e parimit të neutralitetit buxhetor gjatë rishikimit të buxhetit.

Në vitin 2013 kemi dorëzuar në Parlament, duke kaluar tani në leximin e parë, dhe unë besoj sot e kemi leximin e dytë një rregull fiskale që imponon kontrollin e shpenzimeve rrjedhëse dhe orienton rritjen e buxhetit drejt shpenzimeve kapitale.

Disa javë më parë, të nderuar deputetë, ne përfunduam suksesshëm rishikimin e parafundit të programit me Fondin Monetar Ndërkombëtar, duke përçua sinjale të fuqishme se Qeveria e Republikës së Kosovës në mënyrë të suksesshme ka arritur t'i implementojë reformat e saj ekonomike dhe fiskale. Është konkluduar se të gjitha kriteret e performansës kuantitative dhe atyre strukturore janë përmbushur në tërësi. Ne e vlerësojmë që si rezultat i politikave, të cilat janë reflektuar edhe në këtë rishikim të buxhetit, programi 'Stand by arrangement' do të përmbushet me sukses deri në fund të këtij viti.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në pika të shkurtra t'i prezantoj ndryshimet kryesore që përfshin ky propozim për rishikim të buxhetit.

Pjesa tekstuale e Projektligjit për plotësimin e Ligjit për buxhetin për vitin 2013 i rregullon tri fusha të reja me rishikim të buxhetit. Nëpërmjet këtij projektligji rregullohet krijimi i fondit zhvillimor të mirëbesimit, i cili pas aprovimit të ligjit do të mundësohet të krijohet nga përfaqësuesi special i Bashkimit Evropian në Kosovë për komunat në pjesën veriore të Kosovës.

Nën dy, rregullohet mënyra e ndarjes së shpenzimeve të fondit për shpenzime kontingjente në komunat e reja, meqenëse ligji javën e kaluar është tërhequr nga Qeveria, do të thotë ky nen duhet të amendamentohet e amendamenti do të propozohet nga Qeveria. Rregullohet mënyra e ndarjes së shpenzimit të kontigjencës për financimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, që paraqitet në nenin 3, paragrafi me numër rendor i këtij projektligji.

Pjesa e tabelave të projektligjit për plotësimin e Ligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013 brenda kornizave të theksuara më parë dhe arsyeshmërisë së kërkesave buxhetore i rregullon këto fusha: lejimi i transferove dhe i alokimeve brenda organizatës buxhetore. Krejt kjo shkon në funksion të rritjes së efijencës dhe efikasitetit në leximin e buxhetit për vitin 2013 brendapërbrenda organizatave buxhetore.

Gjetjen e kursimeve për t'i mbuluar obligimet e reja ose të pa parashikuara brenda kufijve totalë. Kursimet kanë ardhur nga ndarjet, për të cilët ende nuk është bërë zotimi; mosndryshimi i kufijve në paga dhe mëditje dhe punësim; përfshirja apo rregullimi financimit brenda ndarjeve buxhetore për të gjitha obligimet që Qeveria ka në raport me financimet nga kreditë dhe bashkëfinancimet.

Në rast të ndryshimit të papritur të rrethanave dhe rialokimet e mëtutjeshme sipas Ligjit të menaxhimit të financave publike dhe llogaridhënies mund të bëhen në tetor të këtij viti, me autorizim të ministrit të Financave, por duke kaluar edhe nëpërmjet Kabinetit qeveritar. Në pajtim me zhvillimet e jashtme makroekonomike dhe reflektimin e tyre në të hyrat doganore, Qeveria me anë të një vendimi të veçantë nuk do ta alokojë shumën prej 11 milionë eurove si masë sigurie për ta arritur cakun e deficitit të përcaktuar me kriteret brendapërbrenda 'Stand by arrangement' me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Më lejoni që të ritheksoj edhe një herë se kapacitetet tona për planifikim afatgjatë janë përmirësuar dukshëm, prandaj edhe përmbajtja e këtyre shikimeve është vetëm strukturore dhe bëhet në funksion të përgatitjes edhe më të mirë për bazën planifikuese për buxhetin e vitit të ardhshëm.

Ashtu siç e theksova dhe në fillim, në vitet e ardhshme presim të zhvillojmë një buxhet i cili është i bazuar në rregull fiskale dhe presim që kjo së shpejti të aprovohet në Kuvend.

Realizimi i saktë i buxhetit të sivjetmë dhe rishikimi i sotëm janë një veprim i domosdoshëm për ta krijuar një pako shpenzimesh që arrin të jetë në pajtueshmëri të plotë me rregullën fiskale brenda periudhës 2014-2016.

Të nderuar deputetë,

Pas diskutimeve që do të kemi, për propozim për rishikimin e buxhetit, ju ftoj që ta aprovojmë në parim këtë propozim-ndryshim të buxhetit dhe në ndërmjet dy leximeve, së bashku me Komisionin për Buxhet dhe Financa, sigurisht edhe me komisionet tjera, të cilat janë të parapara të kalojë Ligji i buxhetit, ne do t'i bëjmë amendamentet eventuale, duke e ruajtur parimin e neutralitetit buxhetor. Pas kalimit të leximit të dytë, atëherë do të

fillojmë, dhe normalisht sipas procedurave, pas nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi, të procedojmë me buxhetin e rishikuar për vitin 203.

Edhe një herë ju falënderoj dhe ju bëjë ftesë që ta aprovojmë në parim Projektligjin për rishikimin e buxhetit për vitin 2013. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën tani e ka kryetarja e Komisionit Funkcional, deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013 më 26.6.2013, me ç'rast ka qenë i pranishëm edhe ministri i Financave me stafin e tij.

Pas një debati të gjerë, projektligji është miratuar me shumicë votash dhe i është rekomanduar seancës që ta miratojë në parim dhe t'i japë mundësi Komisionit për Buxhet dhe Financa që t'i bëjë ndryshimet dhe plotësimet që Komisioni i konsideron si të nevojshme për t'i bërë.

Plotësimet e Ligjit të buxhetit në këtë gjashtëmuor të vitit 2013 i kam paraqitur në njëfarë mënyre si përkushtim të Qeverisë për ta ruajtur qëndrueshmërinë fiskale dhe për t'i harmonizuar qëndrimet e veta me Fondin Monetar Ndërkombëtar, ashtu siç e kanë përcaktuar me letrën e qëllimit të mirë.

Nëse e shikojmë me kujdes Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për buxhetin, e shohim se buxheti në përgjithësi nuk i ka ndryshuar ky rishikim kufijtë ekzistues, të cilët kanë qenë edhe më parë sa u përket shpenzimeve. Sa i përket pjesës tekstuale, e përmendi dhe ministri, janë dy ndryshime të rëndësishme, të cilat janë bërë në këtë projektligj, e të cilat janë përkrahë edhe nga ana e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Në pjesën tabelare është vërejtur se ka disa ndryshime, të cilat janë kryesisht ndryshime që kanë ndodhur brenda organizatë e buxhetore dhe kjo është bërë me qëllim që të ketë një realizim më të mirë të buxhetit gjatë vitit 2013.

Nëse i analizojmë tabelat, e shohim se janë ruajtur kufijtë buxhetorë dhe mendoj se është bërë një punë e mirë që është bërë përfshirja apo rregullimi i financimit brenda ndarjeve buxhetore për të gjitha obligimet që Qeveria i ka në raport me financimet nga kjo ditë dhe bashkëfinancimet, gjë që ka qenë një dobësi në buxhetet e mëparshme. Nga materiali që na është sjellë për rishikim, shohim se janë bërë përmirësime të dukshme sa i përket planifikimit të buxhetit, kështu që është edhe një bazë e mirë planifikuese për vitin e ardhshëm.

Ne në Komisionin për Buxhet dhe Financa e kemi amendamentuar Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, ku brenda këtij plotësim-ndryshimi të Ligjit për menaxhimin e financave është përfshirë edhe rregulla fiskale që ky projektligj

është pikë e dytë të rendit të ditës të kësaj seance, kështu që rishikimi i sotëm është edhe një veprim i domosdoshëm për ta harmonizuar pakon e shpenzimeve që do të jetë në pajtueshmëri me rregullat fiskale, të cilat duhet të përfshihen brenda periudhës 2014-2016.

Me këtë rishikim, Qeveria e ka treguar një vetëdije dhe vetëpërmbytjen në ruajtjen e treguesve makroekonomikë, pjesë dhe kontribut i të cilit është edhe ky projektligj që ne sot e kemi në shqyrtim, kontribut i cili konsiston në minimizimin e deficiteve vjetore përtej presioneve të krizës ekonomike, botërore dhe zhvillimeve që kanë të bëjnë me ekonominë e vendeve tjera të rajonit.

Anëtarët e komisionit i janë drejtuar me shumë pyetje ministrit të Financave dhe drejtorit të Buxhetit për çdo ndryshim-plotësim të bërë në rishikimin e buxhetit. Kryesisht objekt shqetësimi i disa deputetëve kanë qenë ndryshimet në pjesën tekstuale të ligjit, por janë kërkuar sqarime dhe për çdo ndryshim-plotësim të bërë në pjesën që ka të bëjë me pjesën tabelore të buxhetit, ku për secilin kategori është kërkuar sqarim veç e veç. Ministri ka dhënë sqarime për çdo shqetësim të ngrehur nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, dhe në fund komisioni ka vlerësuar se projektligji i plotëson kushtet për procedim të mëtutjeshëm dhe e ka përkrahur si të tillë dhe ka rekomanduar që të miratohet në lexim të parë dhe t'i jepet mundësi komisionit që t'i bëjë plotësim-ndryshimet, të cilat i sheh si të arsyeshme për t'u bërë në procedurat e mëtutjeshme.

Prandaj, i ftoj deputetët që ta përkrahin rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe ta votojnë rishikimin e buxhetit për vitin 2013.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputetja Valbona Dibra e ka fjalën.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

Plotësim-ndryshimi i këtij ligjit, ndër më të rëndësishmit, garanton qëndrueshmërinë në aspektin makroekonomik dhe financiar dhe është në pajtueshmëri të plotë me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Me plotësim-ndryshimin e këtij ligji është paraparë fondi zhvillimor i mirëbesimit, si dhe fondi kontingjent prej afro 2 milionë eurosh për ish të burgosurit politik, kategori kjo e cila meriton një përkrahje financiare.

Qeveria e Republikës së Kosovës në vazhdimësi po tregon një menaxhim të mirë me buxhetin, e kjo po vërtetohet me vazhdimin e projekteve të mëdha dhe në këto projekte të mëdha është edhe autostrada Morinë-Merdar, e cila po e lehtëson në mënyrë të jashtëzakonshme zhvillimin ekonomik, shkëmbimin tregtar, si dhe lëvizjen shumë më të lehtë të qytetarëve në drejtim të Shqipërisë. Prandaj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah plotësim-ndryshimin e Ligjit të buxhetit të Republikës

së Kosovës për vitin 2013 dhe njëherësh i fton edhe deputetët ta votojnë këtë plotësim-ndryshim të ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Naser Osmani e fjalën e ka.

NASER OSMANI: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër i Financave dhe ju ministra të tjerë,

Gjatë shqyrtimit të buxhetit për vitin fiskal 2013, ne si LDK kemi tërhequr vërejtjen për disa anomali dhe diskrepanca buxhetore, duke theksuar se buxheti i vitit 2013 nuk do të jetë zhvillimor. LDK-ja nuk e ka mbështetur atë, pasi është në dëm të qytetarëve dhe interesave të bizneseve.

LDK-ja ka kërkuar që të rishikohet shpërndarja e investimeve kapitale, veçanërisht në arsim, duke synuar që të ketë rritje së paku 15% të buxhetit total të vendit. Në infrastrukturën rrugore të ketë shpërndarje të drejtë nëpër komuna, duke u bazuar në formulën për shpërndarjen e granteve. Është kërkuar që të bëhet rishikimi i shpenzimeve në shëndetësi për të mundësuar furnizimin e rregullt të institucioneve shëndetësore me ndarjen e fondeve për krijimin e kuadrove të reja shëndetësore dhe pajisjen e klinikave me teknologji.

Po ashtu, LDK-ja ka kërkuar që të dizajnohet një program për rritjen e kapaciteteve në Administratën Tatimore të Kosovës, në mënyrë që të mundësohet mbledhja e tatimeve në brendi, si dhe mekanizmat për luftimin e evazionit fiskal. Duhet rishikuar edhe një herë burimet e të hyrave të menjëhershme, sepse kemi vlerësuar se nuk ka bazë ligjore për privatizimin e Postës dhe tani Qeveria na e sjell përpara draftligjin për rishikimin e buxhetit, i cili përmban anomali në sistemin financiar të një buxheti të ardhshëm jo të konsoliduar, por të cunguar dhe të kamufluar.

Neni 2, paragrafi 3, që ka të bëjë me fondin, të jua lexoj, se keni pasur rast këtyre ditëve edhe ta përfilitni: Të gjitha paratë publike të mbledhura prej mallrave të importuar nga bizneset e regjistruara në veri të Mitrovicës, Zubin-Potokut, Leposaviqit apo Zveçanit, të cilat janë të destinuara për konsum në këto komuna, në momentin e hyrjes në Kosovë nëpërmjet pikës doganore në Jarinjë ose Bërnjak, duhet të dërgohen në Fondin e Kosovës, duke u identifikuar dhe regjistruar veçanërisht në sistemin e integruar të menaxhimit të financave dhe të ndahen për fondin zhvillimor të mirëbesimit, që do të krijohet nga përfaqësuesi special i Bashkimit Evropian në Kosovë, në një bankë komerciale, nën ky i cili thuhet se buron nga marrëveshja, e nuk është pjesë e marrëveshjes, të cilën e kemi ratifikuar në Parlament, nën i cili do të krijojë implikime të mëdha, sidomos në të ardhmen, sepse mungesa e limitit kohor nuk na krijon mundësi për të ditur se sa kohë ka nevojë ky territor i privilegjuar të ketë fond zhvillimor, si dhe çfarë sasive parash nevojiten për ta arritur nivelin e dëshiruar zhvillimor.

Ne si deputetë kemi dilema sa i përket qarkullimit në këto dy pika doganore. Në fund, a derdhen vetëm të hyrat nga Dogana, apo edhe të hyrat nga akciza dhe tatimi mbi vlerën e

shtuar, si dhe komunat përfituese veriore a do të përfitojnë edhe nga ndarjet e rregullta buxhetore, apo do të jenë të mbuluara vetëm nga ky fond. Ky nen do të ketë pasoja në të ardhmen, sepse firmat prodhuese të Serbisë, e sidomos Qeveria e Serbisë, nëpërmjet lehtësirave biznesore e tregtare do t'i stimulojë firmat e regjistruara në 4 komunat me shumice serbe, në mënyrë që qarkullimi i mallrave të Serbisë të bëhet kryesisht në këto dy pika doganore dhe që bizneset e regjistruara aty të luajnë rol ndërmjetësues, duke e furnizuar tregun në tërë Kosovën, pasi nuk ka instrument matës se sa janë nevojat për konsumin e gjerë për këto komuna veriore.

Me këtë nen atakohet edhe Ligji nr. 04/L, neni 5, 115, për ndryshimin dhe plotësimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, pasi fondi zhvillimor i besimit do të krijohet nga përfaqësuesi special i Bashkimit Evropian në Kosovë, pra nuk do të menaxhohet, por do të krijohet. Kky është një dallim jashtëzakonisht i madh. Pra, nuk është fjala për menaxhimin, por është fjala për krijimin. Dhe, në fund, lidhur me nenin 2, fondi do të jetë në një bankë komerciale. Ne mendojmë se fondi duhet të mbahet në llogarinë e Bankës Qendrore, sepse është para publike. Do të jetë e palejueshme nëse do të mbahet fondi në 'Komercijalna Banka', e cila, meqë e ka degën në Mitrovicë, që është e regjistruar në Bankën Qendrore, por me një vendim politik, kështu që Qeveria nuk do të ketë mundësi të marrë të dhëna të sakta se cili është qarkullimi, cilat janë shpenzimet. Ministri mund edhe të na e argumentojë të kundërtën që do të merren të dhënat nga Dogana për ditën sa është e hyra, por në këtë rast na intereson sa do të jetë sa do të jetë shpenzimi dhe kur do të jetë ai shpenzim.

Neni 3, paragrafi 3, në tekstin në vazhdim, fondi për shpenzimet kontingjente për këto dy komuna. Tani ky nen nuk ka fare vend më këtu, sepse ky ligj ka jetë vetëm 6 muaj. Kryeministri e ka tërhequr ligjin për kufijtë administrativë të komunave, por ajo që mund t'u themi dy komunave të Hasit, që gjatë hartimit të buxhetit për vitin 2014 ne do t'i kemi parasysh dhe do të jenë të trajtuara sikur të ishin të formuara tani. Pra, proceduralisht, ky nen nuk mund të zbatohet.

Sa i përket paragrafit 4, që ka të bëjë me fondin për kontingjent për financimin e të dënuarave politikë, edhe ky nen duhet të riformulohet duke pasur një vendim të Qeverisë dhe një përlllogaritje afatmesme të kostos buxhetore për këto kategori të përfituesve. Dhe, në fund, disa fjalë së përgjithshme për të dhënat tabelare të të hyrave dhe shpenzimeve të Qeverisë. Derisa në nenin 2 parashihet se nga dy pikat kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak të ketë shmangie nga të hyrat buxhetore, ku të hyrat doganore do të derdhen në fondin zhvillimor të mirëbesimit në llogarinë komerciale, duke mos e ndryshuar pozicionin e tyre, pra në buxhet kanë mbetur të planifikuara 915 milionë, kurse në rishikim përsëri nuk është rishikuar që do të kemi shmangie tash në këto dy pika kufitare. Ky pozicion është dashur, se për aq sa do të shkojnë paratë në fondin për zhvillim, por aq do të zvogëlohen edhe të hyrat buxhetore. Kjo është shumë e qartë.

Duke mos u ndalur vetëm në këto ndryshime të shpenzimeve rrjedhëse dhe ato kapitale, nuk është rishikuar pozicioni i financimit të njëhershëm, pozicion ky i cili ka mbetur njësoj i parashikuar. Është fjala për 322 milionë euro kur tani kemi të bëjmë me shumat e caktuara të ofertës për shitjen e Postës që 277 milionë dhe shitjen e Distributimit të

energjisë elektrike për 26,8 milionë, domethënë paraqitet nevoja e përmirësimit adekuat të rishikimit, nga 322 milionë, në 304 milionë, sa është në fakt e prezantuar. Por, më konkretisht, nëse shikohet shuma reale e shitjes nga këto dy privatizime, është që të priturat për shitjen e Postës nuk janë më 277 milionë, por disa janë realisht 252, ndërsa për Distributim nuk janë më 27 milionë, por janë faktikisht 9 milionë, se 17 milionë vetëm iu kanë kthyer kompanisë “Limak”.

Pra, rishikimi real është dashur të jetë në pozicionin 261 milionë, e jo 322 milionë. Ndoshta kjo është bërë krejt me qëllim që deficitin buxhetor të ruhet në atë që është paraqitur aty në 200 milionë, ndërsa e vërteta është që deficitin buxhetor është 261 milionë. Kjo domethënë që është bërë një kamuflim që krejt kjo të paraqitet se nuk do të ketë deficit më të madh se ajo që është planifikuar gjatë hartimit të buxhetit.

Unë nuk do të ndalem më tepër në lëvizjet të cilat janë bërë brenda rishikimit, nuk do të flas edhe për arsyeshmërinë ndoshta që është bërë lëvizja 5-milionëshit, por për mua gjithmonë do të jetë që në rishikim do të shohim cili është problemi, apo cila është arsyeja që Komunës së Gjilanit i është...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka kryetari i Grupit, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Natyrisht që ky rishikim i buxhetit është më i çuditshëm se sa herëve tjera, jo për shkak të ndryshimeve në numrat dhe në shumat që janë prezantuar këtu, por për shkak të një ndryshimi rrënjësor që po i bëhet sistemit fiskal të Kosovës dhe unitetit doganor të Kosovës me krijimin e një fondi që këtu po quhet i mirëbesimit, pra në nenin 2, pika 3, që e përmendi edhe deputeti Osmani.

Sa i përket këtij neni, mendoj që aty shumë qartë thuhet që të gjitha paratë që mblidhen, pra paratë publike që mblidhen nëpërmjet këtyre dy pikave doganore do t’i shkojnë këtij fondi. Pra nuk është këtu fare e dyshimtë nëse do të jenë vetëm taksat doganore, apo taksat doganore apo taksat doganore plus tatimi në vlerë të shtuar, apo edhe tatimet tjera, të cilat arkëtohen nëpërmjet këtyre dy pikave doganore. Pra, të gjitha paratë publike që mblidhen në këto dy pikat doganore thuhet që do të shkojnë në fondin për zhvillim.

Sa herë kemi folur në këtë Kuvend, por edhe nga shoqëria civile, për kërkesa për fondet e ndryshme, të cilat do ta trajtonin një çështje të caktuar, urgjente në Kosovë, përgjigjja e Qeverisë ka qenë që Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë na e ndalon krijimin e fondeve alternative në Kosovë, përveç se fondit të konsoliduar, siç quhet, apo Buxhetit të Republikës së Kosovës, dhe kjo ka qenë përgjigjja e vazhdueshme e Qeverisë për secilën kërkesë të mundshme që e kanë pasur qytetarët e Kosovës për një fond të caktuar. E, tash, në marrëveshje me Serbinë po kërkohet nga ne që ta krijojmë një fond të tillë, pa e ndryshuar madje as Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Pra, ose nuk paska qenë kurrë në kundërshtim, ose tash po e shkelim këtë

ligj me dy këmbët, në këtë ligjin për buxhetin që na ka ardhur këtu dhe paramendojeni, me Ligjin për buxhetin, pra me Ligjin e menaxhimit të financave parave publike ne po e shkelim vetë ligjin bazik për menaxhimin e financave publike, që është një absurd i llojit të vet, e që po i ndodh vetëm Kosovës.

Pra, ky fond dhe mënyra se si është formuluar në nenin 2, pika 3, krijimi i këtij fondi, është në kundërshtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe është në kundërshtim edhe me frymën edhe germen kushtetuese të Republikës të Kosovës që, përveç tjerash, garanton unitetin territorial doganor fiskal të Kosovës dhe, në anën tjetër, garanton edhe barazinë e qytetarëve të Kosovës. Pra, nuk ka asnjë rajon, asnjë komunë dhe asnjë qytetar të Kosovës, nuk ka një fond të veçantë të vetin, të cilin e financon prej dy pikave të veçanta doganore, përveç tash asociacioni, i cili është krijuar në marrëveshje me Serbinë.

Çështja e dytë është gabim të quhet fond, sepse ky fond e ka mënyrën e të funksionuarit njëloj sikur një buxhet. Por, është buxhet paralel i asociacionit, jo fond për zhvillim dhe këtë duhet ta themi shumë qartë. Pse është buxhet? Sepse i ka edhe të hyrat e dedikuara nga dy paratë publike, nga dy pikat doganore të caktuara dhe pastaj i ka shpenzimet e dedikuara, të cilat janë të ndara në një territor të caktuar, që në këtë rast është territori i asociacionit të komunave me shumicë serbe. Pra, kur i ke të hyrat e dedikuara, të përcaktuara, atëherë këto janë dy funksionet elementare kryesore që e bëjnë buxhetin buxhet, apo jo? Pra, dihet se ku i merr të hyrat, dihet se ku shpenzohen ato para dhe këto janë para publike të Kosovës, të cilat tash po e marrin formën e një buxheti paralel për asociacionin.

Por, të mos e quajmë fond dhe të mos e rrejmë veten, sepse është buxhet dhe Kosova prej tash e tutje, po qe se ka kalon ky ligj i buxhetit edhe në lexim të dytë, atëherë do të jetë një territor, i cili i ka dy buxhete, njëri prej të cilave menaxhohet dhe administrohet në mënyrë transparente, ta quaj ashtu, deri diku për shkak se votohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe ai tjetri, i cili nuk ka kurrfarë transparence në menaxhimin e tij për shkak se krijohet nga një instancë që nuk ka pushtet ekzekutiv përbrenda Kosovës dhe po ashtu shpenzohet dhe menaxhohet nga një instancë, e cila nuk ka pushtet ekzekutiv përbrenda territorit të Kosovës. Dhe, ky është aspekti tjetër i shkeljes flagrante të ligjeve pozitive në Kosovë për shkak se, siç e tha edhe deputeti Osmani, po i jepet pushtet ekzekutiv për mbi paratë publike të Kosovës një instance që nuk ka pushtet ekzekutiv as me ligjet e Kosovës, e as me deklaratat dhe vendimet e Bashkimit Evropian që ia kanë mundësuar praninë kësaj instance këtu në Kosovë.

Pra, Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian nuk ka pushtet ekzekutiv në Kosovë dhe tash ky është rasti i dytë që Kuvendi i Republikës së Kosovës, përmes një ligji prapë po i shkel parimet kushtetues të Republikës së Kosovës duke i dhënë pushtet ekzekutiv një instance e cila deri dje nuk ka pasur. Pra, rasti i parë është kur është krijuar Agjencia për Verifikimin e të Dhënave për Regjistrin Kadastral dhe Civil në ligjin që është kaluar në këtë Kuvend vitin e kaluar dhe tash ky është rasti i dytë ku Përfaqësuesit Special të BE-së po kërkohet t'i jepet pushtet ekzekutiv dhe atë ku, përmbi paratë e Republikës së Kosovës.

Çështja e tretë, thuhet në të njëjtin nen, që këto të hyra, pra këto para publike që do të regjistrohen të veçanta dhe pastaj që do të transferohen automatikisht në një llogari, në bankë komerciale në Fondin e krijuar nga Përfaqësuesi Special, do të jenë vetëm për mallrat e destinuara për konsum në veri. Kjo është natyrisht vështirë e përcaktueshme pastaj, sepse përveç që nuk ka të dhëna, kjo do të mund të përcaktohej se vërtet është ashtu vetëm nëse vendoset edhe një pikë kontrolluese doganore te lumi Ibër për ta verifikuar se cili prej atyre mallrave që ka hyrë në veri po del në jug e cili jo, përndryshe nuk ka kurrfarë mundësie për ta vlerësuar këtë.

Tash, natyrisht ministri do të na thotë që do t'i ndërtojë mekanizmat ose që do t'i përdorin mekanizmin e tregut, por ne e dimë shumë mirë se si ka funksionuar kjo që 14 vjet. Sa malli është kontrabanduar këtu në Kosovë e kurrë nuk është zënë e tash po shpresojmë që këto mallra, të cilat do të jenë një lloj kontrabande, pra duke e pasur parasysh formulimin ose mënyrën e formulimit të nenit, automatikisht ne do t'i kemi mundësitë për t'i vlerësuar.

Dhe, çështja tjetër është që për sa i përket këtij buxheti paralel në Ligjin për rishikimin e buxhetit nuk kemi kurrfarë të dhëna, as sa do të jenë të hyrat e as sa do të jenë shpenzimet dhe ku do të shkojnë ato. Pra, për shpenzimet tjera që i bën Qeveria e Kosovës, të paktën e kemi një lloj projektimi, një lloj zotimi të Qeverisë së Kosovës se ku do të shpenzohen ato, në cilat zëra buxhetore, ndërkohë që për sa i përket buxhetit për asociacionin nuk ka kurrfarë zotimi, nuk kemi kurrëgjë në letër për ta ditur sa do të jetë ky fond, ta zëmë prej momentit kur fillon të mbliidhet deri në fund të vitit edhe sa do të jenë shpenzimet dhe ku do të shpenzohen këto para të Asociacionit, në cilat projekte, për cilat qëllime, në çka do të jetë zhvillimi, në cilat komuna e kështu me radhë?

Pra, nuk kemi kurrfarë informate dhe po kërkohet nga ne që ta votojmë një fond për të cilën nuk dimë asgjë, një fond fantom dhe këtë po thuhet nën vellon apo nën panerin ta quaj ashtu të mbrojtjes së interesave të vendit. Unë nuk di çfarë interesi mund të ketë Kosova nga falja e parave për një fond për të cilin as nuk e din se çfarë do të jetë, çka të bëhet me të, ku do të shpenzohet, kujt do t'i shkojnë edhe si?

Çështja tjetër, u përmend këtu që unë e kam një qasje pak më ndryshe, përveç asaj që domethënë te të hyrat doganore ta zëmë në tabelën fillestare, në tabelën 1 të buxhetit, ku janë të përmbledhura të gjitha të hyrat dhe shpenzimet thuhet që për buxhetin e vitit 2013, pra janë të llogaritur të hyrat doganore të jenë 915 milionë euro, ndërkohë që te buxheti i rishikuar do të jenë 915 milionë euro. Pra, kjo nuk ka lëvizur fare. Dhe kjo do të thotë që Qeveria jonë është qind për qind e saktë në projekte, gjë që nuk ka dal asnjëherë.

Dhe, çështja tjetër është që meqenëse është kaq e saktë në projekte, Qeveria e Republikës së Kosovës kurrë nuk paska projektuar që mallrat që hyjnë përmes dy pikave doganore në veri t'i marrë dhe t'i fusë në buxhetin e vendit. Pra, në njëfarë mënyre ky është projektim qeveritar i kontrabandës që e kanë kryer strukturat kriminale në veri, sepse paska llogaritur që në fillim që këto para kurrë nuk do t'i marrë dhe t'i fus në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Pra, këtu a po e shihni që njëfarë mënyre krimi që ndodh në Kosovë, kontrabanda që ndodh në Kosovë, shmangia nga tatimi që ndodh në Kosovë është projekt qeveritar, sepse është sipas projekteve të Qeverisë. Edhe po ashtu te privatizimi që e përmendi, por edhe deputeti Osmani po më bie për t'iu referuar shpesh fjalës së tij, është që 322 milionë euro kanë qenë të parashikuara dhe 322 milionë euro kanë mbetur.

Por kjo nuk më çudit fare për shkak se është hera e tretë që në Buxhetin e Republikës së Kosovës, Qeveria projektonte të hyra nga financimi i njehershëm të cilat nuk i dalin asnjëherë ashtu siç kanë qenë. Pra, iu kujtohet edhe me buxhetin e vitit 2011 i kemi pasur 300 milionë euro të cilat nuk kanë ardhur kurrë edhe me buxhetin e vitit 2012 i kemi pasur po ashtu 300 milionë euro që nuk kanë ardhur kurrë, i kemi pasur në fillim të vitit 2013 në buxhetin 322 milionë euro dhe tash në rishikim na mbetet shuma e njëjtë edhe pse një pjesë e atyre ndërmarrjeve publike prej të cilave, prej privatizimit të së cilës Qeveria ka shpresuar t'i marrë 322 milionë euro tashmë janë privatizuar apo jo, dhe njëra prej tyre ka kushtuar 26 milionë euro, pak më shumë se 26 milionë euro prej të cilave është detyruar pastaj KEK-u që t'ia japë 17,9 milionë euro, t'ia kthejë asaj pra që kanë mbetur jo më shumë se 8 milionë euro që është dashur t'i marrë Buxheti i Republikës së Kosovës dhe në anën tjetër i kemi ofertën deri tash, për PTK-në 277 milionë euro e cila automatikisht është zbritur në 242 milionë euro për shkak të 35 milionë euro që i kanë kërkuar për t'i mbajtur aty si financa dhe të cilat tash çdo ditë po zbret edhe më shumë, por i kanë kërkuar edhe 20 milionë euro shtesë për t'ua hequr prej çmimit për shkak të teknologjisë... i kanë kërkuar për t'ua hequr edhe nga 20-30 milionë euro për shkak të mundësisë së futjes së operatorit tjetër nga Serbia...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimi e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Zoti Gjini në emër të Grupit Parlamentar.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Do të provoj të jem goxha i shkurtër, e vërteta është se sa herë të flasim për buxhet ose për mjete monetare, sidomos në gjashtë vjetët e fundit është një mal me tepër, shumë probleme, jashtëzakonisht problematike është çdo pikë për të cilën kjo qeveri ka të bëjë me të hollat, me shpenzimin.

Fillimisht, mendoj se në ditët që vijnë gjatë punës në Kuvend deri në shqyrtimin e dytë të këtij projektligji, ministri i Financave do të duhej të përgjigjet në disa pyetje jashtëzakonisht serioze që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me buxhetin dhe jo vetëm me këtë buxhet, por kanë të bëjnë me të ardhmen e Kosovës, seriozisht po them me të ardhmen e Kosovës.

Çështja e parë për të cilën duhet të përgjigjet ministri i Financave dhe ish-ministri i Zhvillimit Ekonomik është, a ka pësuar kolaps plotësisht procesi i ndërtimit të termocentraleve të reja në Kosovë? A është e vërtetë që Qeveria e Kosovës ka mbërri në

atë pikë sa të kërkojë prej investitorëve të mundshëm ata t' i vendosin kushtet? A është e vërtetë që ka dërguar letër? Mbasi ta dëgjojmë përgjigjen gjatë ditëve që vijnë do të dimë edhe ne se si do të tregojmë pak më shumë, a është e vërtetë do të thotë që Qeveria e Kosovës ka mbërri në atë pikë, gjashtë vjet mbasi që e ka pasur të gatshëm projektin ta shkatërrojë plotësisht edhe të mbërri në atë pikë që të kërkojë kushte prej investitorëve të mundshëm e mos t' i vendosë kushtet vetë. Kjo është pyetja e parë.

Pyetja e dytë është: a po pëson kolaps plotësisht edhe shitja e “Valës”? A është e vërtetë që kompania e cila me letra e ka blerë nuk është e gatshme për t' i paguar mjetet se s'ka mjete dhe ata që kanë qenë dashur për t'ia dhënë mjetet nuk i kanë për t'ia dhënë për shkak se ka biznesmenë vendorë dhe zyrtarë tepër të lartë të Qeverisë së Kosovës, të cilët kanë pretenduar t' i kenë 22% të aksioneve në “Valën” e shitur. A është e vërtetë?

Do të thotë, do të na tregojë dhe pastaj do të duhej të bisedojmë. A është e vërtetë që këto mjete nuk do të vijnë në Buxhetin e Kosovës edhe pse projektohen? A është kjo e vërtetë? A e dini që vetëm këto dy çështje do të kenë pasoja për dekada që vijnë për Kosovën, jo vetëm në këtë buxhet, jo vetëm deri në miratimin e buxhetit 2014 që do të jetë para fundi i këtij viti. A është e vërtetë që deficitin është 260 milionë euro, e tha dikush, e tha deputeti Osmani.

A është e vërtetë që është 260 milionë euro e jo sa shkruajnë këta? A është e vërtetë që deri tash kemi 30 milionë euro më pak të hyra në dogana se sa që është paraparë? A është e vërtetë kjo? A është e vërtetë që nuk keni mjete për të eksproprijuar më tutje për autostradë? A është edhe kjo e vërtetë?

Mendoj se ministri i Financave është fajtor për ato dy të parat që i thashë, por do të jetë fajtor edhe nëse nuk përgjigjet në të gjitha këto pyetje, në ditët dhe javët që vijnë për shkak se menaxhimi i parasë publike nga Qeveria e Kosovës është aq i keq sa po ju them edhe njëherë do t' i shihni pasojat edhe ju vetë edhe populli i Kosovës edhe për një kohë që do të vijë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja zonja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit! I nderuari nënkryetar i Kuvendit!

Përshëndetje për ministrin,

Duke marrë parasysh se sot në rend të ditës kemi Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2013, mund të themi se gjatë shqyrtimit të këtij projektligji, i nderuar ministër unë do të kërkoja sot nga ju që në pjesën e parë të projektligjit në nenin 2, ndoshta do të jetë çështja që kërkoj pak sqarim më shumë nga ju, për arsye se thuhet në nenin 9, të Ligjit vjetor të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2013, paragrafi 2, shtohet një paragraf i ri me numër rendor 3 me tekstin në vazhdim: “të gjitha paratë e mbledhura prej mallrave të importuara nga bizneset e regjistruara në veri të Mitrovicës, Zubin-Potok, Leposaviq apo Zveçan, të cilat janë destinuar për konsum në këto komuna, në momentin e hyrjes në Kosovë nëpërmjet pikave doganore në Jarinjë ose Bërnjak duhet të dërgohen në Fondin e Kosovës duke u identifikuar dhe regjistruar veçanërisht dhe të ndara për Fondin Zhvillimor të

Mirëbesimit, që do të krijohet nga Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë në një bankë komerciale”.

I nderuar ministër,

Duke marrë parasysh se vonë e keni marrë postin e ministrit të Financave, kërkoj nga ju që ndoshta në mënyrën më të mirë të duhur se është bërë debat dy herë në seanca plenare për Ligjin për amnisti, kërkoj nga ju që ky fond se ne e kemi miratuar një marrëveshje mes Kosovës dhe Serbisë që ky fond zhvillimor i mirëbesimit të jetë në Bankën Qendrore të Kosovës për arsye se aty e kemi edhe Thesarin nga të cilat mund të ndahen linjat buxhetore. Ndoshta kjo do të jetë mundësia më e mirë që mund ta bëni si ministër, për arsye se ju jeni ministër i Financave.

Dhe çështja, tjetër Koalicioni për Kosovë të Re përkrah fondin e ndarë nga Ministria e Financave për kontingjentin për financimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, ndërsa tash do të hyj në tabelën e parë ku jepen sqarimet për çështjen e përshkrimit apo shpenzimeve të Qeverisë, të hyrat në buxhetin e 2013 dhe buxheti i rishikuar për vitin 2013. Këtu nuk kemi kurrfarë ndërrimi me përjashtim të shpenzimeve kapitale, kisha kërkuar ndoshta një sqarim nga ministri, për arsye se ministri e dinë më mirë ku janë zvogëluar këto të hyra në shpenzimet kapitale, nën një.

Nën 2, ministër a janë veç të parashikuara çështja e financimit të menjëhershëm ndoshta paratë nga privatizimi i Distribucionit dhe Furnizimit dhe paratë nga privatizimi i Postë-Telekomit të Kosovës dhe,

Nën 3, ministër kisha kërkuar çka po ndodh me grandet për Prishtinën, duke marrë parasysh se ne jemi pjesa më e madhe, të cilët jetojmë në Prishtinë, punojmë në Prishtinë dhe ju jeni ai që jetoni dhe punoni në Prishtinë. Çfarë grande do të ndani për Prishtinën?

Në parim e përkrahim, por dua sqarime në këto pyetje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar SLS zonja Bontiq.

JELENA BONTIĆ: Havla, predsedavajući!

Poštovani kolegnice i kolege,

Samostalna Liberalna Stranka smatra da rebalans budžeta ne odstupa mnogo od politike Vlade, koju je usvojeni budžet za 2013.godinu oslikavao. Smatramo da i rebalans budžeta ima razvojni karakter, a da su neophodne promene unutar budžetskih linija na nivou, koji bitno ne menja karakter budžeta.

Pokazalo se da je ocena Međunarodnog monetarnog fonda, koji je usvojeni budžet tada ocenio pozitivno i pohvalio makroekonomske i finansijske politike Kosova.

Posebno je važno da se naglasi da rebalans budžeta ne sadrži povećanje deficita i da je u tom smislu usvojen i budžet dobro projektovan.

Najveće izmene u odnosu na budžet za 2013. godinu, koju smo izglasali su sredstva, koja su planirana za formiranje opštinskih administracija na severu Kosova shodno Briselskom sporazumu a što prirodno nije bilo moguće uvrstiti u budžet, koji smo početkom godine doneli.

Rebalans ograničenih sredstava neće rešiti najveće probleme Kosovskog budžeta a to je njegova ograničenost u odnosu na sve potrebe, ali je njegov razvojni karakter i dalje njegova osnovna osobina. Kapitalna ulaganja i razvoj infrastrukture su preduslov za stvaranje uslova za ekonomski rast i u rebalansu budžeta nema promene tog kursa.

Zamerke koje smo kao poslanička grupa izneli prilikom usvajanja budžeta, na žalost ostaju i ovim predlogom nerešene. Zato želim da iskoristim priliku da predlažaču zakona, dam naše primedbe kako bi između dva čitanja pokušali da bar delimično otklonimo propuste. Na tim primedbama insistirali smo i kod donošenja budžeta za 2013.godinu. I pored preporuke evropske komisije da se budžet Ministarstvu za zajednice i povratak uveća, on je i ovim rebalansom ostao isti.

Poseban problem je loša praksa da se ministarstvo za zajednice i povratak doživljava kao ministarstvo koje treba da reši i one probleme manjinske zajednice, koje treba da rešavaju druga resorna ministarstva. Tako, u kapitalne investicije Ministarstva Zdravlja, Obrazovanja, Infrastrukture u budžetu nisu predviđena sredstva za srpske zajednice.

Samostalna liberalna stranka razume činjenice da sa rebalansom budžeta ne mogu otkloniti najkrupniji nedostaci donetog budžeta i da su ograničena sredstva svakako veliki problem

Nadamo se a će ukupnim razvojem privrede na Kosovu, koja zahteva da se započeti infrastrukturni projekti završe biti više sredstava u Budžetu, kako bi se zadovoljili viši zahtevi nego što smo to sada u prilici.

Samostalna liberalna stranka će danas glasati za predlog Vlade i pokušaće da svoje primedbe obrazloži na komisijama i tako doprinese boljem rebalansu budžeta. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! “6+”, cila e keni Myfera ose zonja Balje. S’po di cila doni merreni. Myfera, si kryetare.

MÜFERRA ŞİNİK: Faleminderit!

Kosova Cumhuriyeti’nin 2013 yılı Bütçe Yasa Tasarısının değişiklik ve eklemeleriyle ilgili önerilerinin görüşüldüğü bu oturumda, yıl başlangıcında geçen önerilerin tamamlanması gerekmektedir. Öyleki diğerleri arasında Mitroviça’da yapılmasına başlanan Türk Kültür Merkezinin 87 000 Euro onaylanmasından sonra zaman açısından gecikmeye uğrayan bu projenin sadece 35400 euro meblağı kullanılabilmiştir.

Kalan kısmı kullanılamamıştır. Bu Kültür Merkezinin tamamlanması için 50 000 euronun eklemelerde yeniden değerlendirilmesi için Bütçe Komisyonuna amandman olarak sunduğumuzda kabul edileceğine inanarak bu Yasa Tasarısının değişiklik ve eklemeleriyle ilgili önerileri “6+” Parlamenetre Grubu olarak kabul etmekte ve desteklemekte olduğumuzu bildirmek isterim.

Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga “Zajednička Budućnost”, zoti Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala gospodine predsedavajući,

Poštovani poslanici,

Poštovani članovi vlade,

Danas kao poslanik govoriću o budžetu Kosova iz ugla gledanja s opštinskog nivoa, to jest pokušaću da ukašem i prenesem zabrinutosti s kojima se susreću lokalne administracije, zbog smanjenja budžeta u srpskim opštinama.

Naime, kada danas govorimo o ovom nacrtu zakona o budžetu za 2013.godinu moramo uzeti u obzir i dobijeni budžetski cirkular za 2014.godinu, koje su opštine dobile izdatog od strane Ministarstva finansija, u kome smo dobili iznos budžeta za 2014.godinu, na koji ću se vratiti malo kasnije i reći zašto smo i s tim predlogom budžeta nezadovoljni.

Kao primer uzeću opštinu Gračanice, kao najbolju novuformiranu opštinu na Kosovo kao i opštinu koja ima zavidan priliv sopstvenih prihoda. Planirani budžet za opštinu Gračanica za 2013.godine bio je 5 miliona 708 hiljada 467 evra, od toga za plate i dnevnice robe i usluge, subvencije i kapitalni troškovi je izdvojeno određene sredstva, upoređeno sa 2012.godinu gde je budžet iznosio 4 miliona 978 hiljada 470 evra, budžet je veći za 14,66%. Ali ako uporedimo po ekonomskim kategorijama, vidimo da i u ekonomskoj kategoriji plate i dnevnice, budžet za 2013.godini znatno smanjen i to za oko 9,71% a da je pritom ukupan broj radnika povećan.

Gospodo poslanici, upravo ovde se javlja jedan paradoks, dok nam je povećan broj zaposlenih radnika, smanjena nam je policija, količina finansijskih sredstava za iplatu tih radnika. Trenutno u opštini Gračanicu počinje 479 radnika ili 74 radnika od odobrenog broja. Ovim putem apelujem na nadležno ministarstvo da opštini Gračanica odobri povećanje budžeta u ekonomskoj kategoriji plate i dnevnice za planiranu projekciju, popunjavanje radnih mesta, to jest da na rebalansu budžeta za 2013. godinu sredstva iz kategorije kapitalne troškove prebacimo u ekonomsku kategoriju plate i dnevnice, kako bismo uposlili još preostale radnike, koji su nam neophodni za pravilno funkcionisanje opštinskih organa, gde bi se umnogome poboljšalo rad u pružanju usluga u obrazovnom i zdravstvenom sistemu.

Poštovani poslanici, kao što sam na početku izlaganja rekao, danas moramo da kažemo i naše brige na predlog iznosa budžeta za 2014.godini po kojoj formuli su se izračunali grantovi, gde se kaže da se 89% budžeta dobije po osnovu broja stanovnika u jednoj opštini.

Kako popis stanovništva koji je bio sproveden u 2011.godini, nije u potpunosti uspeo i to je rezultiralo da imamo i smanjenje broja stanovnika u tim opštinama, a samim tim i smanjenje budžeta.

Najdrastičnije smanjenje budžeta se oslikava u sekundarno zdravstvo, u primarno zdravstvo i obrazovanje.

Kada govorimo o sekundarnom zdravstvu, moram da napomenem da se i predlogom gospodina Marti Ahtisarija opština Gračanice ima nadležnosti za obezbeđivanje sekundarne zdravstvene zaštite uključujući i registraciju o izdavanju licenci zdravstvenim ustanovama, zapošljavnaje i isplatu plata kao i obuku zdravstvenih radnika. Ali nažalost projekat za izgradnju bolnice, koja je započeta i koja je od izuzetnog značaja kako za građane opštine Gračanice, tako i za šire, izgradnja je prekinuta upravo zbog nedostatka sredstava.

Apelujem na Vladu da u rebalansu budžeta uzme u obzir i obezbedi sredstva, kako bi se nastavili razvoj i bolnica završila.

Kada govorimo još o zdravstvu i problemima kojima se ono sada susreću, moram da napomenem da je budžet u sekundarnom zdravstvu smanjen za 26,5% a u primarnom zdravstvu za 27,21% što sa odobrenim budžetom i u trenutnim brojem zaposlenih, kao i trend povećanja broja zaposlenih radnika imaćemo sredstva samo ekonomsku kategoriju plata i dnevnica, što bi umnogome ugrozilo rad zdravstvenih ustanova.

Analizirajući tabelu opštinskog finansiranja za 2014.godinu iz budžetskog cirkulara 2014/1 primećujem da je u nekim opštinama kao što su Priština, Uroševac i Gnjilane, od kojih je takođe došlo do smanjenja stanovnika na osnovu zadnjeg popisa, upravo u tim opštinama došlo do povećanja budžeta, pa se s pravom pitami kako je moguće da se kod nekih opština od kojih je došlo do smanjenja stanovnika po popisu imamo i smanjenje budžeta, kao što je i Gračanica, Parteš, Klokot i Štrpce po formuli za dodelu budžeta a u nekim opštinama gde je došlo do isto do smanjenja broja stanovnika po popisu je došlo do povećanja budžeta.

Pa vas zato gospodo poslanici, pitam dali je u pitanju neka čarobna formula koja ima dva aršina, da se u zavisnosti od opština za koji se dodeljuje grant, po potrebi smanjuje ili povećava budžet ili je u pitanju nešto drugo.

Zato se ovim putem obraćam komisiju za dodelu opštinskih grantova, da objasni kako je moguće da ima, kao što sam rekao dva aršina i ovim putem ih pozivam da revidiraju odluke za već dodeljene grantove, za one opštine koje su dobile manj budžeta u poređenju iz 2013.godine.

Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” podržaće u načelu usvajanje rebalansa budžeta ali tražiće objašnjenja za dodelu opštinskih grantova. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Përshtëndetje për ministrat,

Të nderuar deputetë,

Unë nuk do të flas për diskrepancën buxhetore, as për kriteret në prioritetet të shpërndarjes së projekteve dhe grandeve, as nuk pretendoj dizajnim të ri të shpërndarjes të buxhetit në këtë rishikim, por dëshiroj zoti ministër t'i keni në konsideratë dy projekte, të cilat ndryshojnë cilësinë e jetës së qytetarëve të Komunës së Malishevës dhe të Komunës së Rahovecit dhe të Gjakovës, por konkretisht do të ndalem në një projekt që është strategjik dhe shumë i rëndësishëm për Komunën e Malishevës.

Në Senik të Malishevës, kompania e ujërave, e ujësjellësit në Prizren me makinerinë e saj dhe teknologjinë bashkëkohore ka shpuar katër puse dhe ka zbuluar një burim uji i cili furnizon 12 fshatra të Malishevës të cilët kanë nevojë jetike për këtë ujë shumë të cilësisë së mirë dhe të nevojshëm, i cili ujë do të ndryshojë cilësinë e jetës së këtyre qytetarëve. Është një projekt me një kosto të akceptueshme dhe besoj që ju do të keni mundësi buxhetore të gjeni mundësitë për ta mbështetur këtë projekt jetik për 12 fshatra pothuaj 1/3 e komunës së Malishevës.

Ndërsa projekti tjetër që ju lus ta keni në konsideratë është një rrugë e cila përshkon nga Gjergjica për në hyrje të Gjakovës ku përshkon një pjesë të fshatrave të Malishevës të ekskomunikuara, një pjesë të fshatrave të Rahovecit dhe kryesisht e afron Gjakovën me Prishtinën në një relacion 17 kilometra dhe në kthesë tjetër 17, 34 kilometra për ata që e bëjnë këtë rrugë çdo ditë.

Dhe, ky ka logjikë për t'u pasur në konsideratë dhe natyrisht që duke pasur parasysh se 75% të kësaj vije dhe të kësaj rruge kalon nëpër pronë shoqërore natyrisht që edhe kostoja e shpenzimeve zvogëlohet dhe duke pasur edhe interesin jetik të qytetarëve i cili është jashtëzakonisht në përmasa të këtyre tri komunave.

Unë dhe gjithë qytetarët të cilët frekuentojnë këtë rrugë, gjithë qytetarët që furnizohen nga ky burim i ujit do t'u jenë mirënjohës juve, Qeverisë dhe Kuvendit që do të aprovojë këto dy projekte jetike dhe shumë të rëndësishme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami e ka fjalën.

KYMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Në fakt më bie që të përmend shumë gjëra të cilat u përmendët nga bashkëpartia im Osmani dhe nga kolegu deputet Ymeri, mirëpo patjetër duhet të ritheksoj se me të vërtetë janë gjëra të cilat ky Parlament nuk mund t'i kapërdijë.

Rishikimi bëhet me qëllim që plani t'i përafrohet realitetit, do të thotë që ndryshimet në terren të reflektohen në atë që është planifikuar para 6 muajve.

Ne si parti që në dhjetor të vitit 2012 kur ky Kuvend e ka aprovuar buxhetin e vitit 2013 që po e shikojmë tani kemi pasur vërejtje të shumta të cilat një nga një janë konfirmuar në gjashtëmujorin e parë të këtij viti. Buxheti i vitit 2013 është buxhet politik, i tillë është edhe rishikimi i tij. Ky buxhet nuk bazohet në objektiva zhvillimore pasi që të njëjtat i mungojnë kësaj Qeverie.

Përpos vërejtjeve që kemi në nenin 2 dhe nenin 3, me të cilat pajtohem pikë për pikë me ato çka u thanë nga deputeti Osmani dhe deputeti Ymeri, në fakt ne kemi edhe vërejtje të tjera të cilat reflektojnë mos ndryshimet apo mos rishikimin në pjesën tabelore e të cilat gjithashtu u përmendën më parë.

Shpenzimet janë shkurtuar për diku 7,8 milionë euro, kryesisht janë bërë lëvizje në shpenzimet kapitale nga të cilat 1 milionë i ka marrë vetëm komuna e Gjilanit. Kur flasim për shpenzimet u tha edhe më herët është shumë shqetësues vendimi i Qeverisë që ka marrë për mosalokim të 11 milionë eurove e cila nuk reflektohet në rishikim të buxhetit.

Ky është një mashtrim i institucioneve pasi që ky buxhet ekziston në tabelat buxhetore të organizatave buxhetore, mirëpo me një vendim të Qeverisë atyre u ndalohej që t'i shpenzojnë apo t'i zotojnë ato mjete.

Ndërsa sa i përket planit të hyrave që u përmend edhe më herët neve na shqetëson fakti se si të hyrat nga doganat janë planifikuar në buxhet të vitit 2013, 915 milionë dhe të njëjtat në rishikim i kemi 915 milionë dhe unë këtu parashtoj pyetje direkte ministrit të Financave si ka mundësi që shmangia e të hyrave doganore nga dy pika doganore të cilat do të thotë kjo shmangie do të hyjë në fuqi me hyrjen në fuqi në lexim të dytë të këtij ligji nuk është reflektuar në 915 milionëshin për më tepër duke marrë për bazë vetëm 40% e planit të hyrave doganore është realizuar në gjashtëmujorin e parë.

Ju duhet të na tregoni se sa kanë qenë në gjashtëmujorin e parë të hyrat doganore nga pikat 1 dhe 31 Bërnjak dhe Jarinjë dhe për të njëjtën shumë është dashur që të korrigjohet 915-milionëshi.

Mandej është shumë shqetësuese llogaritja e të hyrave të njehershme e cila u tha paraprakisht. Unë ministër e di shumë mirë që oferta për PTK-në është 277 milionë bile shfrytëzoj rastin që në këtë rishikim t'ju rikujtoj që nga shumë deputetë të këtij Kuvendi dhe nga shumë përballje që kemi pasur ne kemi kritikuar rënd vendosjen e paracaktimit të PTK-së sepse ju kemi thënë që nuk keni të merrni më shumë se 300 milionë dhe tanimë keni një ofertë për 277 milionë, me kusht që në llogari në çastin e dorëzimit PTK-ja t'i ketë 35 milionë që e zbret ofertën në 42 milionë.

Unë e di që justifikimi juaj është që këto 35 milionë janë kapital qarkullues i PTK-së, mirëpo prapë PTK nuk është shitur për 300 milionë, por është shitur për 277 milionë dhe ju të paktën është dashur t'i korrigjoni të hyrat e njehershme për 23 milionë, sepse aq keni marrë ofertën, për aq më pak duke mos i llogaritur të gjitha kërkesat që AKSOS-i i ka vendosur para jush.

Ne sot kur bëjmë rishikimin e shifrave buxhetore të cilat nuk janë rishikuar, por janë bërë shumë konfuze dhe është munduar që të mbulohen vrimat buxhetore me numra, ne në fakt duhet t'i kthejmë edhe sytë nga gjendja në terren. Ne sot jemi në muajin e shtatë dhe ka iks projekte kapitale një numër shumë i madh i projekteve kapitale të cilat në fakt nuk kanë filluar të implementohen. Të njëjtat kanë mbetur pa u implementuar edhe një vit më herët. A është kjo politikë e Qeverisë tuaj, që ju në fakt të planifikoni projekte të mëdha

dhe mandej të mos ndodhë asgjë në mënyrë që ju të mbuloni në kësi forme deficitet dhe vrimat buxhetore të cilat ju paraqiten gjatë vitit?

Gjithashtu deklaroj se Lidhja Demokratike e Kosovës nuk do ta mbështetë këtë rishikim pasi që ne mendojmë se me rishikim të këtij buxheti jo që është përmirësuar dokumenti, por në fakt është bërë edhe më i keq dhe më i pa vërtetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën zonja Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem predsedavajući!

Poštovani ministre,

Više od dve godine insistiram da Vlada odnosno određeno ministarstvo izdvoji finansijska sredstva za investiranje vodovodne mreže u dva najveća naša bošnjačka sela u regionu Prizrena, Gornje Lubinje i Donje Lubinje međutim do dan danas nismo dobili nikakav odgovor.

Takođe u stalnim smo konsultacijama sa Švajcarskom ambasadam i USAID-om, vrednost tih projekata je oko pola miliona evra pa možda bismo mogli zajednički da investiramo.

Takođe postoji jedna inicijativa od prošle godine, obećana od strane Ministarstva za obrazovanje, to je jedna mala investicija u južnom delu Mitrovice odnosno u Osnovnoj školi “Elena Gjika” treba da se dodaje jedan aneks škole, da bi se elementarni uslovi za našu školsku decu poboljšali. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Lama!

ALMA LAMA: Faleminderit zoti kryesues!

Unë nuk do të hy në debate në lidhje me buxhetin, sepse shumë gjëra u thanë këtu, por do të merrem me një çështje shumë konkrete.

Para disa ditësh kam qenë në një vizitë në një fabrikë e cila është shumë, shumë e suksesshme - kompania “Red Eagle”, fabrikë e pijeve, është e suksesshme jo vetëm në rajon, por edhe në botë sepse atje eksporton.

Gjëja që më bëri përshtypje ishte që rruga për të shkuar te kjo fabrikë ishte gropa – gropa. Qeveria e Kosovës jo vetëm që nuk investon ose nuk harton politika për të ndihmuar kompanitë prodhuese vendore jo vetëm që nuk subvencionon siç bëjnë shtetet e tjera, por nuk bën as minimumin t’ju shtrojë rrugët në mënyrë që t’ju lehtësohet disi transporti dhe po kështu të krijohet një imazh më i mirë i njerëzve të cilët kryesisht janë të huaj që shkojnë për të vizituar këto lloj fabrikash të cilat në radhë të parë hapin shumë vende pune, një gjë shumë e domosdoshme në Kosovë.

Kjo kompani për shembull jep taksa buxhetit të Kosovës çdo vit nga 800 000. Ministri s’po dëgjon, po flet në telefon, me ju e kam ministër, nga 800 000 euro deri në 1 milion euro taksa paguan, ndërsa rruga për të shkuar deri aty kushton shumë, shumë më pak. Mund të kushtojë 100 000, ose 200 000 euro.

Prandaj, i bëj thirrje ministrit të Financave që t'i marrë parasysh këto gjëra. Unë e di që kjo Qeveri ka investuar shumë në rrugë, mund të quhet ndryshe edhe "Qeveria e asfaltit", por nuk ka investuar në rrugët prioritare. Dhe një nga këto rrugë prioritare ose nga rrugët prioritare janë rrugët të cilat u mundësojnë kompanive prodhuese që të kenë një mënyrë më të lehtë për të bërë biznes.

Unë do ta paraqes si amendament propozimin që kjo rrugë, Qeveria e Kosovës të ndihmojë, të financojë që t'i shtrohet rruga deri tek fabrika, nuk është ndonjë gjatësi e madhe, është 1,5 kilometra, por është shumë e rëndësishme për këto biznese vendore të cilat, siç e thash, përveç të tjerash hapin edhe shumë vende pune. Prandaj, e ftoj zotin ministër që ta marrë në konsideratë këtë, por edhe të hartojë politika të cilat do të mund të ndihmonin kompanitë vendore për të prodhuar dhe për të rritur punësimin e njerëzve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar ministra,

I nderuar ministër Beqaj,

Kolegë deputetë,

Në parim e mbështes propozim-ndryshimin e buxhetit për këtë vit. Mund t'i bëhen vërejtje, mbështes disa nga vërejtjet, sidomos ato që kanë të bëjnë me kërkesën për trajtim të balancuar të gjitha pjesëve të Kosovës.

Këtu u përmend disa herë Gjilani, në një kontekst jo sa duhet të qartë, por unë dëshiroj vetëm të nënvizoj një fakt, në gjithë pjesën lindore të Kosovës, prej Mitrovice e deri në Shkup, këndej magjistrates nuk ka asnjë kilometër të vetme, madje asnjë 100 metërsh në katër korsi. A do koment?

Por, megjithatë kësaj radhe më lejoni që të shtroj një çështje tjetër. Do të dëshiroja të ringre edhe një herë para këtij tempulli të demokracisë një çështje të ndjeshme që e kemi pasur në shqyrtim edhe muaj më parë, edhe vite më parë, çështjen e të drejtave të parealizuara të ish- të burgosurve politikë.

Dëshiroj të informoj shkurtimisht për rrjedhën e deritashme të procesit të krijimit të parakushteve ligjore, institucionale, materiale për realizimin e të drejtave të dënuarve politikë të parapara me Ligjin numër 3/95 dhe në emër të mijëra ish- të dënuarve politikë dhe familjeve të tyre të shumëvujtura të kërkoj sërish mbështetjen tuaj, nismës vijuese për të zvarritur për fat të keq, për adresimin dhe rregullimin me ligj dhe zbutjen e njërës prej padrejtësive më të mëdha të së kaluarës.

E drejta e kompensimit të ish-dënuarve politikë, siç e dini, zonja e zotërinj, është rregulluar me Ligjin për të drejtat e ish të dënuarve politikë që është miratuar me mbështetje konsensuale, më 29 tetor 2010, tri vjet më parë, shpallur në Gazetën Zyrtare dhe hyrë në fuqi brenda afatit ligjor.

Ligji ka pas paraparë nxjerrjen dhe miratimin nga Qeveria dhe ministrinë përkatëse të akteve nënligjore të parapara brenda 6 muajve të parë të vitit 2011 dhe realizimin e të drejtës së kompensimit gradual të ish të dënuarve politikë përfitues në periudhë katërvjeçare duke filluar 6 muaj pas hyrjes në fuqi, respektivisht në korrik të vitit 2011.

Ndonëse me vonesë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka themeluar në shkurt të vitit 2012 Komisionin qeveritar për njohjen e statusit të ish të dënuarve politikë dhe ka miratuar rregulloret përkatëse - Rregulloren e funksionimit të Komisionit dhe Rregulloren për kushtet dhe kriteret e kompensimit.

Komisioni i ka bërë të gjitha përgatitjet e duhura për zbatimin e ligjit duke përfshirë iniciimin, përgatitjen dhe draftimin edhe të akteve të parapara nën-ligjore. Në bashkëpunim me Shoqatën e ish të Burgosurve Politikë ka qenë e organizuar dhe përmbyllur me sukses fushata e evidentimit paraprak të listës së ish të dënuarve politikë, ka qenë bërë mbi këtë bazë edhe parallogaria e kostos financiare të ligjit dhe brenda afatit ligjor i është proceduar Ministrisë së Financave në fund të vitit të kaluar. Do t'ua bashkëngjis këtë. Ua kam bashkëngjitur në shkresë edhe instancave qeveritare dhe Komisionit përkatës.

Në konsultimet midis Komisionit dhe drejtuesve të Qeverisë, kryeministrit, zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Drejtësisë si dhe ministrit të Financave, ka qenë konfirmuar gatishmëria për të filluar zbatimin e ligjit në fillim të vitit 2013 dhe kjo është deklaruar edhe publikisht.

Megjithatë, me rekomandim të Qeverisë, të kryeministrit dhe ministrive përkatëse fillimit të zbatimit të ligjit që shtyrë për gjysmëvjetorin e dytë të vitit 2013, pas rishikimit të buxhetit të këtij viti, do të thotë pas këtij rasti që e kemi tani.

Në pajtim me këtë, në fillim të muajit maj të këtij viti në praninë e kryeministrit të Kosovës dhe përfaqësuesve të lartë qeveritarë, u hap në mënyrë solemne fushata e aplikimit për statusin e ish të dënuarve politikë. Gjatë kësaj fushate dymujore janë parashtruar gjithsej 9.043 aplikime, e përsëris, të përfshirë jo vetëm të dënuarit, por edhe të përndjekurit, edhe të dënuarit me kundërvajtje, prandaj të mos shkaktohet konfuzion. Dhe është grumbulluar një fond i konsiderueshëm i dokumentacionit të dosjes së burgut politik, praktikisht që nuk ka qenë askund i koncentruar.

Nga numri i përgjithshëm i aplikuesve 4.656 prej tyre, sipas vlerësimit para preliminar konsiderohen si përfitues potencialë të së drejtës së kompensimit, ndërkaq numri i tyre që i plotësojnë kushtet e kërkuara dhe që kanë trashëgues ligjorë del të jetë dukshëm më i vogël.

Një numër i aplikuesve janë pengje dhe të burgosur të luftës dhe si të tillë kanë aplikuar edhe në Komisionin për njohjen e statusit të kategorive të dala nga lufta dhe meqë me ligj nuk mund të përfitohet mbi dy baza, si të thuash, për të njëjtën arsye, llogaritet se numri i përfituesve do të jetë edhe më i vogël.

Për të gjitha këto arsye mendoj që është e arsyeshme kërkesa dhe presim edhe mbështetjen tuaj për alokimin e mjeteve të nevojshme financiare dhe zotimin e tyre në linjë të posaçme buxhetore për kompensimin e ish të dënuarve politikë në kodin përkatës buxhetor sipas Rregullores të miratuar nga Qeveria në Ministrinë e Drejtësisë, jo në kategoritë e çështjeve sociale, por në kategorinë e dënimeve të padrejta, sepse ligji e përcakton kështu dhe ky është kualifikimi i saktë dhe siç është premtuar në shumën prej 5 milionë eurosh dhe kjo është kërkesa e Komisionit, për të cilën besoj se do të kemi edhe mirëkuptimin tuaj. Kurse pjesa tjetër pastaj të planifikohet sipas kërkesave në periudhën katërvjeçare.

Nuk dua të zgjatem në arsyetimin e arsyeshmërisë së kësaj kërkesë, sepse besoj që është e njohur, është miratuar nga shumica dërmuese e deputetëve, është iniciuar nga ata, megjithatë theksoj vetëm faktin që Kosova vërtet ka qenë ekzemplari i veçantë i përvojës së burgut politik, represionit politik. Është edhe një obligim humanitar, është edhe një obligim ndërkombëtar nga rezolutat e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, ka qenë një obligim edhe nga Raporti i Progresit, është paraparë edhe në Letrën e Bardhë që e ka miratuar ky Kuvend në kategoritë e pa përfshira dhe mendoj që ë koha e fundit që ky proces të fillojë dhe të kryhet në të mirën e përgjithshme, besoj edhe me korrigjimet e kërkuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit, kryesues i kësaj seance!

Zoti ministër, faleminderit për praninë!

Rishikimi i buxhetit është mundësi e mirë për çdo kabinet qeveritar e ju si përfaqësues i këtij kabineti të sillni në Kuvend mundësi të reja buxhetore për ata që kanë nevojë, e kërkesat janë jashtëzakonisht të mëdha, ndërsa, pamundësi për ata që nuk dinë t' i menaxhojnë, nuk i shpenzojnë dhe nuk e drejtojnë drejt buxhetin e shtetit.

Duke i pasur parasysh krejt këto mundësi që ligji i ofron dhe krejt këto kapacitete që buxheti i Kosovës i ka, edhe në këtë rast, përkundër që jeni emëruar muajve të fundit në këtë detyrë, por keni qenë anëtar i kabinetit prej fillimit dhe besoj që nuk ka qenë hendikep apo pamundësi që ju të punoni më shumë në rishikim buxhetor.

Moszbatimi i formulës së grandit për pushtetin lokal në veçanti, ka qenë hendikep që në rishikim së paku të punohet shumë që të përmirësohet gjendja dhe të bëhet një barazi apo ndarje e drejtë buxhetore sipas regjioneve apo nahijeve në Kosovë, sepse diskriminimi si parim në shpërndarjen e buxhetit është jashtëzakonisht duke u ndie në disa vende, siç e tha edhe kolegu më herët, pjesa lindore e Kosovës është në një depresion të madh për shkak se është përjashtuar nga projektet kapitale të mëdha, siç janë autostradat e kombit, hekurudhat e premtuara që s' e ka ndërmend t' i bëjë kurrkush, as edhe studimet e fizibilitetit që kanë filluar për rrugë regjionale që s' po ecin.

Kjo është vetëm një, por po ashtu edhe nga arsimi, ndërtimi i objekteve dhe infrastrukturës duke pasur parasysh që është bërë qendër regjionale. Nuk po e përmendi tash Gjilanin në raport me Pejë, meqë ju jeni i Pejës dhe do të jem subjektiv, por herën e

kaluar e kam krahasuar duke parë elementin jo partiak të qeverisjes, por elementin e shpërndarjes së drejtë, sepse Pejën si pushtet lokal e udhëheq Aleanca, natyrisht se kanë nevojë, ndërsa Gjilanin si pushtet e udhëheq PDK-ja, ku lidhet me këtë qeverisje.

Për derisa të hyrat komunale janë dy herë më të mëdha në Gjilan, investimet janë dy herë më të vogla. Atëherë, qytetari edhe jep më shumë edhe merr më pak, dëmtohen në të dy rast. Tash nuk është përmirësuar, 1 milion euro të premtuara me rishikim buxhetor është servisim i borxhit prej 2,4 milionë eurove, që duhet parë se borxhi publik a është i mbuluar dhe a ka të drejtë Qeveria të servisojë borxhe të organizatave që hyjnë pa qeveri në borxh? Ky është 40% i borxhit, sepse nuk pritet kurrjë të zhvillohet në gjashtëmujorin e dytë.

Do të kisha lutur që të na mundësoni neve së paku si deputetë të këtij Kuvendi që e kemi prejardhjen prej atij regjioni, pra çfarëdo partie që jemi, t'i paraqesim disa nga projektet konkrete që mbulojnë interesin e qytetarëve në 7 komuna, sepse nuk bahet fjalë për 4 komuna, ai regjion i ka 7 komuna prej të cilave janë 4 me shumicë etnike serbe apo 3 sot udhëhiqen me shumicë etnike, pjesa tjetër është shqiptare. Por, edhe një kërkesë shtesë që ka të bëjë - thyerjen e parimit të diskriminimit që po vazhdon atje, duhet përjashtuar "duhet larguar diskriminimi" në shpërndarjen dhe përfundimisht ka ardhur koha për të fituar një lloj prioritetit të lehtë në shpërndarjen e investimeve, sepse nevojat janë jashtëzakonisht të mëdha dhe të papërballeshme tash për këtë që është në qeverisje.

Nuk është vetëm infrastruktura si detyrë bazike, sepse atje nuk është investuar kurrjë në rrugët regjionale, pak a shumë në rrugë komunale po punohet, por ka vende që vërtet kanë mbetur pa u prekur apo pa prekur pushteti absolutisht për 5-6 vjet asgjë, dhe kjo është dobësia më e madhe që reflektohet atje. Është arsimi, shëndetësia dhe janë projektet tjera konkrete që çdo vend duhet t'i ketë në prioritet.

Pjesa tjetër e kërkesës time me këtë rishikim ka të bëjë përfundimisht me krijimin e mundësive për subvencione më të mëdha për kategori që kanë nevojë siç janë njerëzit e dalë nga lufta apo kultura, sporti dhe kategoritë tjera që kërkojnë subvencionime urgjente dhe nevoja për zgjidhjen e këtyre problemeve është jashtëzakonisht e madhe. Pse të mos kihet mundësi, nëse çështja e veteranëve ka mbetur të zgjidhet në mënyrën tjetër, subvencionet totale për kulturë, rini dhe kategori tjera që kanë nevojë duhet të jenë pjesë e vlerësimeve të rishikimeve buxhetore, sepse edhe ashtu subvencione po ha shumë shteti, edhe më shumë shpenzime, e po ashtu enorme, dhe kategoritë tjera që mos t'i përmend rresht cilat janë ato që harxhojnë miliona euro dhe efekti i tyre është zero.

Nëse i krahasojmë shpenzimet e një organizate sot me këtë vit dhe vitet e kaluara, kemi shpenzime 100% të rritura dhe 100% nënkupton prej 200.000 euro në 300.000 euro, që janë jashtëzakonisht shpenzime të mëdha për organizata buxhetore çfarë janë komunat në Kosovë dhe mundësitë buxhetore që i kemi sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Ndryshimi i kornizës ligjore për zbatimin e marrëveshjeve me Serbinë është tejte i dëmshëm dhe i dhimbshëm.

Pra është e dhimbshme se si e gjithë korniza ligjore në Kosovë po ndryshon për një marrëveshje që e ndan Kosovën në baza etnike dhe e bën shtetin jofunksional.

Qeveria, Kryeministri, zëvendësi i tij, jo shumë kohë më parë patën deklaruar se Marrëveshja Thaçi-Daçiq është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës dhe ligjet e vendit dhe jo shumë kohë pas atyre deklaratave po ndodh krejt e kundërta.

Me këto ndryshime ligjore pra po shkelet sistemi unik, por edhe po betonohet autonomia e serbëve në pjesën veriore, e kjo më pas do të jetë shumë e vështirë apo më mirë të themi e pamundur të zhbëhet.

Neni 2 i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për buxhetin, në të cilin parashihet krijimi i fondit zhvillimor për veriun, bie ndesh me nenin 119 paragrafin 4 të Kushtetutës ku thuhet se Republika e Kosovës promovon mirëqenie për të gjithë qytetarët e saj duke inkurajuar zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

Pra, në kuptimin e kësaj dispozite, termi “promovon mirëqenie për të gjithë qytetarët”, shpreh frymën e barazisë dhe jo diskriminimit të të gjithë qytetarëve para ligjit dhe angazhimit të organeve shtetërore pa ndonjë dallim për cilëndo përkatësi.

Kjo frymë e barazisë dhe trajtimit të barabartë lidhet me dispozitat e nenit 24 të Kushtetutës, në kapitullin e të drejtave të njeriut, pra barazisë para ligjit.

Shteti duke garantuar barazinë në qasjen publike, në këtë rast të promovimit të mirëqenies së qytetarëve, duhet të kujdeset që kjo qasje të mos cenohet të drejtat individuale dhe kolektive të cilitdo komunitet brenda territorit të Republikës së Kosovës.

Pra, parimi i qasjes së barabartë të shtetit të Kosovës për të promovuar mirëqenien e qytetarëve përmes zhvillimit ekonomik, përfshin detyrimin e organeve shtetërore që përmes angazhimit dhe infrastrukturës juridike t’i qaset trendit të zhvillimit ekonomik.

Në rastin konkret, pra Fondi zhvillimor për veriun është në shpërputhje të plotë me parimin e barazisë që është shprehur me dispozitat e këtij paragrafi kushtetues.

Më tej, dispozita e nenit 120 paragrafi 1 i Kushtetutës - mbi financat publike thekson se shpenzimet publike dhe mbledhja e të hyrave publike duhet të bazohen në parimet e llogaridhënies, efektshmërisë, efikasitetit dhe transparencës.

Pra është detyrim kushtetues që shpenzimet dhe mbledhja e të hyrave publike të bazohen në parimet e llogaridhënies.

Në Republikën e Kosovës menaxhimi i financave publike rregullohet me ligj të veçantë, pra Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Duke marrë parasysh dispozitat e këtij ligji, pra neni 17 paragrafi 1 dhe 2, theksohet se paratë publike do të përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike. Asnjë autoritet publik, organizatë buxhetore, person apo ndërmarrje nuk mund të devijojnë, keq zbatojnë, ekspozojnë apo të përdorin në mënyrë të pa rregullt paratë publike.

Nga kjo nënkuptohet se, të gjitha të hyrat financiare, qoftë në nivel qendror apo lokal duhet të jenë të projektuara me Ligjin për buxhetin, dhe përjashtimisht për të hyrat vetjake të komunave, nëpërmjet miratimit të një planifikimi buxhetor nga kuvendi komunal përkatës.

Unike për të gjitha këto është se përdorimi dhe alokimi i këtyre mjeteve mund të bëhet vetëm me një miratim paraprak, që do ta përcaktojë pra akti i përgjithshëm i miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Sipas kësaj, vetëm organi legjislativ ka të drejtën e miratojnë një kornizë juridike mbi bazën e së cilës do të mund të shfrytëzohen paratë publike.

Në asnjë mënyrë, Përfaqësuesi i Special i Bashkimit Evropian nuk ka autorizim kushtetues që të themelojë një fond të veçantë për veriun. Pra, Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian nuk ka asnjë kompetencë ekzekutive e cila parimisht duhet të sanksionohet në rregullimin kushtetues.

Në paragrafin 2 të po këtij neni është theksuar se shpenzimi i parave publike mund të bëhet vetëm nga fondet e ndara dhe të alokuara dhe vetëm në përputhje me procesin i cili është themeluar nga Rregullat KMF-së sipas paragrafit 2 të nenit 38 të këtij ligji. Edhe me këtë paragraf përsëritet detyrimi i projektimit paraprak të mjeteve financiare, i cili është themeluar sipas rregullave të KMF-së. Pra, në asnjë mënyrë nuk mund të themelohet një fond i veçantë, për shkak të centralizimit të alokimit të mjeteve financiare nga Buxheti i Kosovës.

Gjithashtu, edhe në përputhje me nenin 18 paragrafi 1 theksohet se të gjitha llogaritë dhe nën-llogaritë e sipër cekura do të jenë pjesë e llogarisë së vetme të Thesarit. Të gjitha pagesat dhe shpenzimet e parave publike duhet të bëhen përmes kësaj llogarie. Për të kuptuar këtë dispozitë, duhet edhe ta trajtojmë definicionin e llogarisë së vetme të Thesarit. Pra, që do të thotë sistemi i cili përbëhet nga të gjitha llogaritë dhe nën llogaritë, të cilat mbahen në emër të Thesarit.

Andaj, është më se e kuptueshme se edhe mjetet financiare të grumbulluara nga taksat doganore duhet të alokohen në llogaritë, të cilat do të jenë pjesë e llogarisë së vetme të Thesarit e që paraqet sistemin, i cili përbëhet nga të gjitha llogaritë dhe nën llogaritë, që mbahen në BQK.

Në përfundim, Fondi për veriun nuk mund të themelohet dhe të menaxhohet nga autoritetet e presupozuara, ngase është në kundërshtim me parimet kushtetuese, konkretisht nenin 119 dhe 120 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është në kundërshtim me nenin 17, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi dhe është në kundërshtim me nenin 18, paragrafi 1 të Ligjit për

menaxhimin e financave publike dhe me praktikën e llogarisë së vetme të Thesarit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë e mora fjalën për të treguar se ky rishikim i buxhetit nuk dallon prej herëve tjera, duke pasur parasysh shpërndarjen racionale, që duhet të jetë një buxhet i një shteti, duke marrë parasysh të gjitha prioritetet, të gjitha ato që janë elemente të zhvillimit të shoqërisë sonë e në veçanti ndarjen proporcionale që duhet të bëhet.

Nuk më habit fakti, sepse që dy mandate, qoftë në projektimin e buxhetit, qoftë në rishikim të buxhetit, janë bërë diskriminime të cilat kanë lejuar, që në një pjesë të derdhen fonde të caktuara, madje edhe të pashfrytëzuara mirë ose të keqpërdorura dhe në një pjesë fare pak ose simbolikisht, sikur të jepen sadak, janë lëshuar mjete për rajone të caktuara.

Veç ka mbetur që Anamorava ta thërrasë Televizionin 21 dhe të thotë: “Edhe ne jemi Kosovë”, në mënyrë që të ketë një trajtim, jo me një politikë provinciale siç ka ndodhë deri më tani, por me një politikë racionale kombëtare, e cila mundëson zhvillimin jetësor në hapësirën e Kosovës.

Kemi një ngarkesë të jashtëzakonshme sa i përket edhe pjesëmarrjes së qytetarëve nga Lugina e Preshevës, të cilët tani ata qytetarë as nuk kanë mundësi të kthehen në vatrën e tyre e as nuk trajtohen as si refugjatë në Kosovë, por janë lënë në mëshirë të kohës dhe gjenden ashtu si munden, gjë që nuk është as në dinjitetin e këtij vendi e të këtij shteti.

Po ashtu, duke pasur parasysh se gjithmonë kemi llogaritur se jemi të barabartë në punë, në angazhime, në ndarje, në pjesëmarrje, ju sikur kërkon që të bëjmë kushtëzime me rastin e votimit të buxhetit dhe njerëzit të detyrohen të mos e votojnë, pikërisht pse nuk përdorni politika, të cilat janë avancuese për Kosovën e në veçanti atje ku ka nevojë më shumë.

Paramendoni, asnjë rrugë rajonale në territorin e Anamoravës nuk është e prekur nga ky pushtet. Dhe, nuk e di çka mendojnë ata qytetarë, nëse llogarisin se prej paraluftës nuk ka ndonjë trajtim. Derisa në vendet tjera kemi shuma marramendëse, të cilat edhe në rishikim tani i keni të ndara në rajone, normalisht, prej nga vijnë ministrat të cilët i bëjnë luks vetes ose për të përfutur votën, janë detyruar t'i trajtojnë edhe me buxhet.

Dhe, çështjen që e përmendi edhe zoti Hyseni, të gjitha shtetet të cilat kanë kaluar periudha të një sistemi monist, të burgosurit politikë janë trajtuar me një dinjitet nga shteti, ndërsa në Kosovë kemi edhe më tutje një neglizhencë të jashtëzakonshme dhe një shtet normal nuk do të lejonte që qytetarët e vet të mos i ketë në trajtim, së paku ata që kanë bërë një veprim për të ardhur deri te liria, ashtu siç meritojnë të burgosurit politikë.

Me këtë politikë që po e bëni, unë them se nuk është e mirë, nuk është racionale, nuk është e dinjitetshme për një shtet që duhet shpërndarë Buxhetin ashtu si duhet. Prandaj, edhe rruga që u përmend, ajo regjionale që është Prishtinë-Pejë, rrugët tjera janë të domosdoshme, por megjithatë le të bëhet një ndarje racionale e cila mundëson një zhvillim më të mirë të vendit në përgjithësi e jo edhe më tutje me ndarje selektive të cilat e dëmtojnë interesin qytetar të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

I nderuari ministër,

Të nderuar pjesëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë

U tha edhe këtu se rishikimi i buxhetit është një moment shumë i rëndësishëm për të parë se si po lëvizin çështjet në ekonomi dhe si po realizohen parashikimet e Qeverisë edhe në aspektin afatmesëm edhe në aspektin vjetor.

Ne po na vjen ky projektligj dhe propozimet për rishikim të buxhetit, pa një analizë serioze makroekonomike, së paku ne nuk e kemi, nuk e shoqëron Buxhetin.

Buxhetin nuk e shoqëron asnjë arsye ekonomike, financiare, politike dhe ekonomike, se pse duhet të bëhet rishikimi. Nëse është fjala për 3 – 4 milionë në tabelën kryesore të buxhetit, që zvogëlohen investimet publike, ne e dimë se Qeveria edhe ashtu e ka një mundësi diku deri me 15% të zërave që të bëjë përshtatje të caktuara dhe ta informojë Kuvendin.

Prandaj, tërë kjo si dhe shumë çështje të tjera po shkojnë në atë stilin e improvizimit, i cili nuk di ku do të na shpie dhe nuk di ku do të ndalet. Problemi themelor me të cilin është dashur të preokupohet rishikimi i buxhetit dhe Ligji i buxhetit është si të prodhojmë një rritje më të madhe ekonomike.

Ne kemi ngecje serioze edhe në parashikimet për këtë vit, po edhe vitet tjera në realizimin e rritjes ekonomike, normës së rritjes ekonomike. Të gjitha parashikimet serioze nuk parashohin asnjë rritje më të madhe ekonomike se 2%, përpos natyrisht Qeveria është optimiste si gjithmonë, por në fund të vitit sigurisht do të dalë që rritja ekonomike vështirë që do të jetë më e madhe se 2-2,5% .

Ky është një problem serioz. Ne nuk shohim preokupim. Nuk shohim preokupim, ajo që është problemi elementar, nuk shohim preokupim me këtë problem. Dhe, ne sot e kemi një ekspozë, ne kemi sot diskutim dhe nuk kemi një vështrim. Pse po ndodh kjo, çka do të bëjmë, që kjo të ndërkrehet. Nuk besoj që alokimi i 4 milionëve tjetërkund, që janë paraparë për investime publike do të ndikojë diçka pozitivisht në këtë drejtim. Ajo është krejtësisht e parëndësishme për këtë që po flas unë, prandaj edhe nuk meriton një seancë të rishikimit të buxhetit.

Situata sociale është shumë e rëndë, tensionet sociale janë duke u rritur. Ne kemi tash një shqetësim kur Qeveria e mori vesh që janë rreth 4 mijë kosovarë që po kërkojnë azil nëpër kampe të Hungarisë dhe nëpër kampe të Austrisë e ku di unë atje.

Edhe pse shqetësimi është pse kjo na bën problem për viza. Po mirë, na bën problem për viza, po shqetësimi duhet të jetë për cilësinë e jetës së kosovarëve. Ajo është më e madhe se sa liberalizimi ose mos liberalizimi i vizave. Por, edhe liberalizimi i vizave është shumë i rëndësishëm, megjithatë kur u bë problem, ngutu se tash na del problem me viza. Po na del, natyrisht do të na dalë problem me viza, në qoftë se ne nuk hapim perspektiva të zhvillimit, edhe me viza, edhe me ekstremizmi të llojeve të ndryshme, të cilat po i shohim sot në Kosovë.

Mirëpo, problemi më i madh i këtij buxheti është ajo që u theksua këtu, neni 2, pika 3, e cila është shumë interesant që nëpër një nen gjoja të parëndësishëm të rishikimit të buxhetit do ta fusë nëpër derë të vogël një çështje shumë serioze, që ka të bëjë me unitetin e sistemit doganor dhe unitetin e sistemit buxhetor të Kosovës. E propozimi që është dhënë këtu, për kah implikimet është shumë më serioz se sa ai që diskutuam në pikën e kaluar të rendit të ditës.

E gjithë shoqëria, pra nganjëherë tepër i nxënë disa çështje, edhe pse ajo është shumë serioze, por kjo po ju them, është shumë më serioze se ajo çështje që ne e votuam më herët. Implikimet potenciale janë shumë më serioze dhe të shumëfishta. Prandaj, Qeveria duhet edhe komisionet, duhet të riformulojnë ose ta heqin këtë nen, sepse nuk mund të ndryshohet me Ligjin për buxhet, të ndryshohet Ligji mbi menaxhimin e financave publike. Ligji mbi menaxhimin e financave publike është ligj organik, të cilit i nënshtrohet Ligji për buxhetin. Prandaj, nuk mund ta korrigjojë Ligji i Buxhetit Ligjin e financave publike.

Prandaj, të jemi seriozë. Ne i dimë nevojat politike, e dimë oportunitetin publik, nganjëherë duhet të kemi ndjesi edhe për këto gjëra, por nuk duhet këto të shkojnë jashtë rregullave, me improvizime, duke i shkelë ligjet. Pse të mos shkojnë gjërat në mënyrë të rregullt. Ja, duhet bërë dy lexime brenda ditës, ose të tjera, këto janë gjëra, që krejtësisht po na burojnë nga menaxhimi shumë i dobët i propozimeve dhe menaxhimi shumë i dobët i analizave dhe menaxhimi shumë i dobët i organizimit të punës parlamentare dhe të komisioneve.

Prandaj, një fond ndoshta mund të themelohet, por të themelohet si një fond që ndoshta është bërë me marrëveshjen e bashkë me Komisionin Evropian, në rregull, po për atë fond duhet ndarë para Buxheti i Kosovës për çdo vjet. Edhe ai fond duhet bërë me ligj të veçantë dhe në mënyrë të rregullt e jo ne me iu ngjitë pika kah po vinë paratë në sistemin doganor. Kështu s'ka kurrkund aso zgjedhje, kjo është zgjedhje shumë e çuditshme. Me iu ngjitë pika eurove, kah po vijnë, pikat, një sistem informativ edhe t'i çojmë atje automatikisht, po, kjo është qesharake, ky s'është sistem doganor.

Në qoftë se ekziston nevoja politike, ju lutem, në qoftë se ekziston nevoja politike të krijohet fondi, ne e kuptojmë atë, le të shkojë me ligj, le të rregullohet me ligje dhe

shkojmë ashtu. Mos të shkojmë me improvizime të tilla, mos të shkojmë me shkelje të ligjeve, sepse kjo mënyrë do të na devalvojë krejtësisht këtë Kuvend, ju lutem, krejtësisht. Secili devalvim dhe secili improvizim duhet ta ketë një kufi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Mustafa! Fjalën e ka zoti Idrizi.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Meqenëse u thanë shumë gjëra, unë nuk dëshiroj që t'i përsëris gjërat edhe për shkak të kohës, por dëshiroj që ta shpreh kënaqësinë time që investimet në sektorin e bujqësisë deri në vitin 2015 janë rritur dhe janë rritur në një masë jashtëzakonisht të madhe që është një kënaqësi për fermerët që prodhojnë produkte për tregun tonë.

Këtu dëshiroj ta theksoj që edhe subvencionet, ndarja e subvencioneve dhe e granteve për fermerët tanë është rritur dhe ata kanë filluar ta punojnë tokën, ta kursejnë paranë tonë në vend. Ne jemi në dijeni që bujqësia nuk është një sektor që zhvillon vendin, por është një sektor që krijon paqe sociale, krijon vende të punës, e mban popullsinë në vendet ku ata janë nëpër fshatra, e tjera.

Me këtë rast dëshiroj ta theksoj faktin që është mirë pasi që këto ditë kemi pas të reshura të breshrit, goditje të breshrit në kulturat bujqësore, mirë është që ministria ta marrë parasysh që ta themelojë një buxhet për kompensimin e fermerëve tanë në disa qytete të Kosovës, ku kemi pasur breshër dhe dëme.

Të tilla qytete kanë qenë Mitrovica, Rahoveci, Lipjani, ka qenë Shtimja, pastaj Vitia dhe Gjilani, ku fermerët kanë pësuar jashtëzakonisht shumë. Më mirë me thënë, në vërtetë ky pësim nuk është vetëm pësim material, por është edhe një dekurajim i tyre që të mos prodhojnë për shkak të frikës se këto fenomene natyrore ata mund t'i godasin vazhdimisht. Unë jam në dijeni që Ministria e Bujqësisë e ka ndarë një buxhet bashkë me donatorin kryesor USAID-in për themelimin e një fondi për sigurimin e kulturave bujqësore, por po ashtu edhe ju edhe unë jam në dijeni, që ky fond ende nuk ka filluar të funksionojë dhe për këtë vit nuk mund të bëhet asnjë gjë.

Po ashtu, jam shumë i lumtur që edhe investimet në ujitje janë rritur në këto tre vitet në vazhdim edhe kjo është një garanci e fuqishme, se do të kemi siguri në prodhimin e ushqimit në vend, po më duhet ta them që do të ishte mirë që Ministria t'i specifikojë projektet për ndarjen e këtyre investimeve, për shkak se ne, siç jeni në dijeni fazën e dytë të projektit të madh të Bankës Botërore Ibër-Lepenc nuk e kemi përfunduar me Lepenc, prandaj në njëfarë mënyrë do të ishte mirë që ky buxhet të ndahet, për ta përmbyllur këtë fazë në regjionet nga Graçanica deri në Han të Elezit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Faleminderit, kryesues!

Unë desha ta përmend edhe njëherë atë që është thënë vazhdimisht, e kemi thënë edhe përpara që me këtë rishikim të Buxhetit, po vazhdon një avaz i vjetër, njëjtë sikur kur erdhi buxheti në fillim e po ashtu, edhe ajo e njëjta se çka ndodh me buxhetin e vitit të kaluar dhe kjo për sa i përket buxhetit për bujqësi.

Tek pjesa e buxhetit të ndarë për bujqësi, në vitin e kaluar kemi pasur një shpërndarje të barabartë në mes të shpenzimeve kapitale dhe subvencioneve dhe transfereve. Por, në fund të vitit doli që asnjë para, pothuaj nga shpenzimet kapitale nuk u shpenzua dhe të tërat u bartën tek subvencionet.

Krejt paratë që ishin paraparë për rehabilitimin e sistemit të ujitjes dhe ato që ishin paraparë për ndërtimin e pikave grumbulluese, që janë dy projekte mjaft të rëndësishme për zhvillimin e bujqësisë, ato u bartën te subvencionet. Dhe kjo logjikë, pra këto dy projekte kapitale vit pas viti presin që të investohet në to e në fund të vitit të gjitha paratë barten vetëm te subvencionet.

Kjo mënyrë dhe kjo logjikë e menaxhimit të parasë është një logjikë e cila nuk sjell zhvillim në bujqësi. Nëse duam zhvillim në bujqësi, duhet të investojmë sot që të kemi suksese edhe mbas 4 vjetësh edhe mbas 5 vjetësh e mbas 10 vjetësh. Pra, ne duhet të investojmë sot për të ardhmen.

Nëse nuk investojmë në sistemin e ujitjes, e presim që ajo të ndodhë vitin tjetër, edhe kjo po ndodh vit pas viti, për atë rehabilitim do të na duhen vite të tëra, kur ne presim që të ndërtojmë, që të bëjmë në fakt një bujqësi intensive. Vetëm me subvencione nuk zhvillohet bujqësia. Kudo edhe me politikat e Bashkimit Evropian, në mes të subvencioneve dhe zhvillimit rural e projekteve të mëdha, ekziston njëfarë balance ku të dyja nuk munden pa njëra tjetrën, në ndërkohë që nuk mund as të avancohet vetëm njëra anë e të lihet mënjanë tjetra.

Dhe, çka po ndodh këtë vit? Këtë vit u prit që këto dy projekte të vitit të kaluar, pra tash të fillojnë e të realizohen. Dhe, kur e shohim buxhetin e vitit 2013 në fillim e shohim që për dallim prej vitit të kaluar, i cili ishte i balancuar në mes të shpenzimeve kapitale dhe subvencioneve, kur u bë buxheti i vitit 2013 u pa që për subvencionet u ndanë më shumë para siç ishin 9 milionë e 400 mijë euro, ndërsa për shpenzimet kapitale 8 milionë e 869 mijë euro.

Dhe, tash kur vjen puna te rishikimi i buxhetit, prapë kemi avancim edhe më të mëtutjeshëm të subvencioneve në dëm të shpenzimeve kapitale, ku tash për subvencione janë ndarë 12 milionë dhe për shpenzime kapitale kanë mbetur vetëm 6 milionë e 249 mijë euro. Çka po ndodh në fakt?

Tërë paratë Qeverisë dhe Ministrisë i duhen, që t'i japë kesh te qytetarët. Pra, jo t'i japë ato para si subvencion në bujqësi ta zëmë, në farë, në plehra kimike apo në naftë për bujqit, por jo, ajo duhet të jepet me para kesh tek bujqit, sepse në vjeshtë do t'i kemi edhe zgjedhjet lokale. Dhe kur bëhet fjalë për sistemin e ujitjes, në vend se të realizohet projekti, që quhet rehabilitim i sistemit të ujitjes, të gjitha paratë në vend se të shkojnë në

rehabilitim fillojnë të ndahen dhe të jepen në formë grantesh në mënyrë individuale, ku fermerët të caktuar përpiqen të bëjnë zgjidhje individuale dhe parcialet, vetëm për vete duke siguruar një burim uji dhe duke e bërë sistemin e ujitjes vetëm për parcelën e vet.

Dhe, Qeveria gjen para tash të investojë këtë mënyrë, në vend se të ndërtojë apo të rehabilitojë sistemin e ujitjes në përgjithësi, shumë më e leverdishme për pushtetin, por natyrisht jo kurrësi për bujqësinë, është që këto para t'ua japë në dorë drejtpërdrejtë dikujt, sepse kjo pastaj i përkthehet pushtetit në votë.

Vitin e kaluar absolutisht vetëm një grimë nga projekti i pikave grumbulluese në fund është dhënë në forma avansi dhe kur e shohim se çka ka ndodhur në këtë vit, tash në rishikim të buxhetit në vend të 3,5 milionëve, që janë paraparë në fillim për deponitë për grumbullim, tash në rishikim janë vetëm 89 mijë. Çka bëhet me paratë tjera?

Në vend se të bëhen pikat grumbulluese, këto paratë tjera, nga ky projekt që është shumë i rëndësishëm për bujqësinë, barten në kesh dhe ju barten bujqve drejtpërdrejt. Pra, kjo është mënyra më e thjeshtë, që të blihet drejtpërdrejtë qytetari. Por, kjo kurrësi në dobi të zhvillimit të vendit, kurrësi në dobi të zhvillimit të bujqësisë.

Nëse duam të kemi bujqësi, atëherë duhet të investojmë edhe në pikat grumbulluese edhe në rehabilitim të sistemit të ujitjes, duhet të investojmë edhe në industrinë që i përpunon produktet bujqësore, që ne i kemi. Por, jo vetëm të mendojmë se si do të japim para dhe në fund për produktet të cilat nuk i mbron shteti, të na përfundojnë në lum, siç na ka ndodhur më herët. Kaq.

Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Meqenëse jam i fundit, mendoj se edhe u shter debati, kemi mundësi pastaj gjatë leximit në komisione të bëjmë edhe amendamente. Dëshiroj vetëm një çështje ta ngre e ta shfrytëzoj praninë e dy ministrave, të financave dhe të infrastrukturës.

Meqenëse, Qeveria ka pasur në plan ose veç e ka shpallur një rrugë të rëndësishme së veçantë nacionale, rrugën që lidhë Luginën me segmentin e rëndësishëm Prishtinë-Shkup, ka qenë mirë që nëse nuk ka nga linjat ekzistuese buxhetore, mundësi që të paktën të bëhet një studim gjatë kësaj periudhe, do të ishte mirë, që vetë Qeveria gjatë kohës së punës në komision, të shikojë të përgatisë një amendament, që do të jetë në përputhje me këtë vendim të Qeverisë, që kjo rrugë e rëndësishme së veçantë ta ketë të paktën një studim, në mënyrë që në mundësinë e parë të financimit, të fillohet nga puna. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Vetëm dua edhe njëherë t'ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, sepse sigurisht që të gjitha diskutimet që janë bërë këtu do ta pasurojnë në mes të dyamendamenteve Ligjin për rishikimin e buxhetit.

Dua edhe njëherë të caktoj për qytetarët e Republikës së Kosovës, se fondi për të cilin në pjesën tekstuale flitet, nuk është fond sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike, i cili do të shkaktonte lëvizje nga uniteti fiskal i Republikës së Kosovës. Është ndarje buxhetore, nuk është fond. Është thirrur me emrin fond për shkak se flasim për mundësinë e kontributit të donatorëve në këtë pjesë. Pra, është ndarje buxhetore brenda kësaj dhe normalisht, menaxhimi do të bëhet në bashkëpunim me mekanizmat ndërkombëtarë.

Fondi për të burgosurit, gjithashtu tanimë ka linjë të veçantë buxhetore. Është buxhetuar me shumën prej 2 milionë eurosh për këtë vit dhe do të pasojë në vitet tjera, sipas përcaktimeve buxhetore, të cilat i kemi. Ndërsa, sa i përket afatit të ligjit, sepse u përmend këtu edhe afati. Afati i ligjit është tash në 6 muaj, pra flasim vetëm për këtë pjesë dhe kjo e definon edhe realizimin e fondit.

Ndërsa, dua të them që grandet komunale përcaktohen sipas bazës ligjore dhe prioritetet janë në bazë të njësive buxhetore, të cilat paraqiten tek Ministria e Financave. Ministria e Financave është vetëm një administrues i aspekteve buxhetore. Pra, prioritetet i caktojnë njësitë buxhetore, ndërsa grandet komunale ndahen sipas bazës ligjore dhe kjo është çka ne dëshirojmë edhe njëherë t'i sigurojmë të gjithë deputetët, por edhe qytetarët e Republikës së Kosovës.

Nuk ka asnjë lloj kolapsi në aspektin ekonomik në Republikën e Kosovës dhe nuk ka vend për shqetësime në aspektin afatgjatë, sepse Kosova edhe më tutje është stabile në aspektin makrofiskal. Kjo është vërtetuar edhe gjatë rishikimit të Fondit Monetar, rishikimit të katërt që kemi në kuadër të Marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe kjo nënkupton që jemi pa asnjë lloj problemi në këtë kontekst.

Normalisht, që rritje ekonomik kërkohet dhe buxheti kërkon edhe shumë të hyra. Sigurisht që ne do të bashkëpunojmë me gjithë juve dhe me asociacionet e biznesit, por edhe me qytetarët për të krijuar të hyra dhe për të krijuar sistem i cili mundëson rritje edhe më të fuqishme ekonomike. Edhe njëherë Faleminderit dhe do të bashkëpunojmë ngushtë me të gjitha komisionet të cilat kanë të bëjnë lidhur me amendamentimin e këtij ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, diskutimet janë kryer. Jo, unë po e shoh po s'ka replikë janë kryer këto sende. Shkojmë në votim. 83 vetë janë të pranishëm 103 me kartela.

Pra, konstatoj se në sallë janë 85 deputetë prani fizike, 103 elektronike. Votojmë për praninë fillimisht votojmë për praninë. Votojmë tash!

Pra, 81 prania fizike. Mund të shkojmë në votim. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Me 49 vota për, 35 kundër, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013. Kërkohej nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin sa më të shpejtë të mundshëm ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

A jeni dakord të gjithë? Mirë, atëherë vazhdojmë nesër në orën 10:00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, të filluar më 11 korrik 2013

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

Të nderuar deputetë,

I nderuari ministër,

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 11 korrik 2013.

Konstatoj se në sallë i kemi 60 deputetë. Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sistemin e lejeve dhe të licencave

Tani janë të pranishëm 61 deputetë, por zëvendëskryeministri dhe ministrja përkatëse nuk janë këtu. E shtyjme këtë pikë të rendit të ditës, nëse në ndërkohë vjen ministrja e Ministrisë për Ekonomi dhe Tregtisë.

Vazhdojmë me pikën:

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshime dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-221 dhe numër 04/L-116

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, deputeten Safete Hadërgjonaj, që ta arsyetojë raportin me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në disa takime të mbajtura radhazi e ka shqyrtuar dhe amendamentuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin financave publike dhe përgjegjësitë, në të cilat takime kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, të cilët i kanë dhënë arsyetimet e nevojshme për dispozitat e caktuara të projektligjit.

Po ashtu, Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka pasur parasysh sugjerimet që kanë ardhur nga Komisioni Evropian dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, për çka edhe e ka harmonizuar ligjin me disa ndryshime përmbajtjesore, të cilat janë bërë në ligj. Janë bërë edhe disa ndryshime tjera në projektligj i cili ka kaluar në lexim të parë dhe gjatë plotësim-ndryshimit në komision, të cilat kanë pasur për qëllim përshtatjen e gjuhës juridike, rregullave formale-juridike dhe teknikat e hartimit të legjislacionit, si dhe është bërë rregullimi i referencave në ligjin përkatës, pasi kemi të bëjmë me plotësim-ndryshim të ligjit.

Komisioni për Buxhet dhe Financa njëzëri i ka miratuar të gjitha amendamentet të cilat sot i janë rekomanduar seancës për miratim, kështu që kisha kërkuar nga të gjithë deputetët t'i votojnë amendamentet e propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

KRYETARI: Të paraqitur të tjerë nuk ka. Në këtë projektligj janë propozuar pra 11 amendamente të propozuara nga Komisioni Funkcional. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve. Fillojmë me amendamentin e parë.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Të pranishëm janë 67 deputetë. E votojmë tekstin në tërësi. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 60 vota për, 1 kundër, 1 abstenim, Kuvendi e miratoi për ndryshim dhe plotësim Ligjin nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-221 dhe numër 04/L-116.

Vazhdojmë pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tarifatat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për tarifatat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, zonjën Safete Hadërgjonaj, që ta arsyetojë raportin me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar dhe amendamentuar Projektligjin për tarifatat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë, në të cilat takime kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësuesit e Ministrisë për Financave, të cilët i kanë dhënë arsyetimet e nevojshme për dispozitat e projektligjit.

Ndryshimet e propozuara janë bërë me qëllim të përshtatjes të gjuhës juridike, rregullave formale-juridike dhe teknikave të hartimit të legjislacionit, si dhe është bërë rregullimi i referencave në ligjin përkatës, pasi kemi të bëjmë me plotësim-ndryshim të ligjit. Diskutimi më me interes është bërë rreth nenit 4, i cili në versionin e propozuar nga Qeveria është thënë se në rastet e veçanta Qeveria e Republikës së Kosovës, në konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës, mund ta ndryshojë listën e produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë, që u nënshtrohen tarifave të veçanta të akcizës dhe të përfshira në shtojcën a) dhe listën për sasitë dhe përqindjen alkoolike të shtojcës b) të këtij ligji.

Komisioni e ka amendamentuar këtë nen dhe ka propozuar që ndryshimi i shtojcës a) dhe b) të këtij ligji mund të bëhet me propozim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, por pasi të miratohet në Kuvend. Pra, është bartur autorizimi në Kuvend në rast të ndonjë propozimi për ta ndryshuar aneksin dhe jo që kjo çështje të propozohet në komision për pëlqim.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë dhe nuk i prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Po ashtu, edhe Komisioni për Integritet Evropian ka vlerësuar se dispozitat e projektligjit dhe amendamentet e propozuara nuk janë në kundërshtim me parimet bazë të *acquis communautaire* dhe nuk i cenojnë parimet e përgjithshme të legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Komisioni për Legjislacion, në mbledhjen e mbajtur më 4 mars 2013, e ka shqyrtuar Projektligjin për tarifatat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë dhe ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

Ndërkaq, në mbledhjen e mbajtur më 27 maj 2013, në rastin e shqyrtimit të amendamentit plotësues, të propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, që ka të bëjë me nenin 4 të projektligjit, ka vlerësuar se ky nen dhe amendamenti i propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk ka bazë juridike për procedim të mëtejshëm. Komisioni për Buxhet dhe Financa, pasi e ka shqyrtuar rekomandimin e Komisionit për Legjislacion lidhur me nenin 4, ka vlerësuar se rekomandimi nuk është konkret dhe bindës se çfarë duhet të bëhet me nenin përkatës, të riformulohet, të ndryshohet apo të fshihet dhe ka qëndruar prapa propozimit, të cilin e ka dhënë Komisioni për Buxhet, për t'u ndryshuar neni 4 i projektligjit, ashtu siç e ka votuar Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe i ka rekomanduar Kuvendit që amendamenti i propozuar nga Komisioni për Buxhet të votohet. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: I nderuari kryetar,

Vazhdon të përsëritet i njëjti problem, të bëjmë sa ndryshime të një akti juridik të vendosur në Kuvend me një akt tjetër më të ulët juridik. Është i njëjti problem dhe besoj se nuk është zgjidhur. Duhet akoma kohë që të konsultohemi dhe ta zgjedhim. Domethënë janë 3-4 ligje me të njëjtin problem, neni 4, ku synohet se vendimi i Kuvendit ose ligji të ndërrohet me një vendim në Qeveri ose Qeveria në bashkëpunim me komisionin, gjë që nuk është praktikë, e cila përdoret dhe nuk mund të lejohet. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka ministri i Financave.

MINISTRI BEQIR BEQAJ: Faleminderit, kryetar,

Të nderuar deputetë,

Është një çështje, e cila është kah diskutohet një kohë të gjatë. Ideja e Qeverisë kur ka ardhur ligji në Kuvend ka qenë që ne jemi të gatshëm në çdo kohë për prodhimet dhe stimulimin e prodhimit vendor, t'i marrim mendimet të cilave do t'u dalim në krahë duke bërë procedurat që janë edhe në ligjet tjera.

Pra, kemi ligjet tjera, të cilat i kanë procedurat e njëjta dhe kanë kaluar nëpër Kuvend dhe konform vlerësimeve tona ligjore nuk ka kundërshtim në bazën ligjore dhe aspektet tjera rregulluese në këtë shtet dhe ideja është që, meqenëse është kthyer dhe ka pasur probleme të tjera, sepse e kemi një ligj tjetër, i cili është kthyer dhe nga Presidenca, ideja është që ne ta marrim vendime në Qeveri dhe ato vendimet të shkojnë në Komision për Buxhet dhe Financa dhe me një vendim të Kuvendit, kështu është edhe amendamenti i fundit, të bëhen amendamentimet e anekseve, të cilat do të mundësojnë që Qeveria, respektivisht shteti t'u dalë në ndihmë shumë më shpejt, pa procedurat e gjata, pa amendamente të plota të ligjeve, të cilat mund të marrin kohë shumë të gjatë, që të marrim vendime, të cilat do t'i dalin në krah ekonomisë.

Sido që të jetë, seanca është e thirrur për të vendosur dhe ne jemi të gatshëm ta respektojmë atë, por unë ju bëj thirrje që ta votojmë amendamentin e Komisionit për

Buxhet dhe Financa dhe ta mundësojmë që me një vendim të Kuvendit, ky aneks të ndërrohet konform nevojave të ekonomisë së shtetit. Pra, është bërë për thjeshtësim dhe për t'i dalë në ndihmë ekonomisë, e cila duhet të zhvillohet nëpërmjet aktiviteteve prodhuese në vend.

KRYETARI: Urdhëro, Arben!

ARBEN GASHI: I nderuari kryetar!

Vetëm sqaroja ministrit çfarë lloj vendimesh nxjerr Kuvendi, domethënë me çfarë lloj vendimi mund të ndryshohet një ligj, përveç se me procedurë të rregullt ligjore. Faleminderit!

KRYETARI: Unë konsideroj se e dhe ministri, edhe Zyra Ligjore, që është në kuadër të çdo ministrie, edhe të komisionit, duhet ta kenë të qartë sesi ndërrohet ligji dhe mendoj se procedurat e ndërrimit të ligjeve janë të njohura e nuk ka nevojë tash të merrmi me atë se çka është e ligjshme e çka e paligjshme. Atëherë shkojmë në votim amendament për amendament, kur të vijmë te amendamenti 5 i komisionit, për nenin 4, mirë. Urdhëro Arben, edhe një herë.

ARBEN GASHI: Kryetar!

Unë momentalisht nuk e kam ligjin me vete këtu, sepse prej seancës dje më paska humbur materiali që e kam lënë këtu, por ajo çka mund të them është se neni 4 duhet të hiqet, sepse është në kundërshtim me procedurat dhe praktikën e vendimmarrjes në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Legjislacion e ka përkrahur edhe nenin që ka qenë në projektligj, aneksi i projektligjit të ndryshohet edhe me një konsultim në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Komisioni për Buxhet dhe Financa, pasi për ligjin pas këtij ligji, që është Ligji për lirimet doganore e ka kthyer Presidentja, tek pastaj komisioni e ka marrë dhe e ka shqyrtuar me seriozitet.

Komisioni për Legjislacion e ka miratuar edhe ligjin kur e kemi dërguar. Për herë të parë e ka përkrahur që ky ligj të shkojë me një konsultim në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Tani ne, pas intervenimeve që janë bërë nga Presidenca, e kemi ndryshuar dhe e kemi sjellë rekomandimin që aneksi 1 të ketë mundësi të ndryshohet me kërkesën e Qeverisë dhe me vendimin të cilin e merr Kuvendi. Domethënë, është fjala për vendimin që miratohet në Kuvend. Praktika të tilla ne kemi edhe në legjislacionet e tjera. Një praktikë të tillë e kemi përdorur edhe te Ligji për TVSH-në, ku kemi bërë shtyrjen e afatit për lirimet nga TVSH-ja, që është bërë me të njëjtën procedurë.

I tërë qëllimi është që të shkohet me një afat më të shkurtuar dhe çdo gjë të kalojë nëpërmjet Kuvendit, por jo të shkohet me zgjatje të procedurave që i marrin diku 6 muaj për një ndryshim të vogël, që bëhet në aneksin e ligjit. E gjithë kjo është bërë për t'u

ndihmuar bizneseve dhe praktika të tilla ekzistojnë në vende të ndryshme, që këto plotësim-ndryshime bëhen edhe brenda ditës, e jo siç po ndodh këtu.

Ne e kemi mbajtur edhe një debat këtu në këtë Kuvend, pikërisht për lirimet doganore që është iniciuar nga deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe të gjithë kemi qenë pro që të shkohet me lirimet doganore në procedurë sa më të shpejtë. Prandaj, nuk ka kurrfarë arsyeje që ky proces të pengohet tani. Meqenëse është fjala për miratimin e vendimit në Kuvend, atëherë unë kisha sugjeruar dhe kisha rekomanduar në emër të komisionit që të votohet amendamenti i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Meqenëse është fjala për aneksin, atëherë të votojmë pro që të bëhet me një vendim të cilin e nxjerr Kuvendi.

KRYETARI: Urdhëro, Arben!

ARBEN GASHI: Kryetar, këtu ka dy zgjedhje, ose të shkojmë në procedurë votimi, ose ta dërgojmë në lexim të tretë. Edhe amendamenti 5, edhe neni 4, janë të papranueshëm, sepse janë kundër praktikave vendimmarrëse. Arsyetimi se një ligj për t'u nxjerrë ose për t'u ndryshuar-plotësuar në Kuvendin e Kosovës i merr 6 muaj është i pasaktë. Ne e kemi pasur një praktikë dje, e jo më larg, që për një ditë e kemi kaluar ligjin në dy lexime, sepse kemi konsideruar se është në interes të vendit.

Dhe, nëse është në interes të vendit për ta plotësuar dhe ndryshuar një shtojcë për mallrat, të cilat lirohen nga tatimi ose dogana, edhe këtë mund ta bëjmë brenda dite, kështu që nuk është ndonjë problem jashtëzakonisht i madh. Nëse ka ndonjë qëllim tjetër, unë nuk e di, mirëpo në të dy format siç është i formuar, kemi thënë edhe më herët, në seancat e mëhershme, që është në kundërshtim me praktikën ligjvënëse dhe nuk mund të ndryshohet një ligj me një vendim tjetër. As me vendim Qeverie, as me vendim Qeverie në bashkëpunim me komisionin dhe as me një vendim tjetër të vetë Kuvendit, përveç ligjit.

Rezoluta nuk mund ta ndryshojë, as rekomandimi nuk mund ta ndryshojë ligjin. Cili është ai vendim tjetër që e nxjerr Kuvendi që e ndryshon ligjin, unë nuk e di. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, ministër!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë edhe një herë vetëm dua të tërheq vëmendjen tuaj, të nderuar deputetë, se jemi duke folur për procedura, për përkrahjen e prodhimit dhe, nëse ne gjatë këtyre ditëve marrim vendime që aneksi, sikur i kemi rastet e tjera, kemi edhe ligjet e tjera, të cilat kanë kaluar nëpër Kuvend pa vendim fare, por me vendim të Qeverisë dhe me harmonizim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, kjo do të ishte zgjidhja më e mirë për ekonominë e vendit.

Sigurisht që Kuvendi mund të marrë vendime edhe ta bëjë leximin e tretë, edhe ta kthejë, e ne nga Qeveria prapë do ta sjellim orientimin tonë dhe do ta sjellim gjithmonë duke tentuar t'i favorizojmë prodhimet vendore. Ky është interesi ynë. Ky është interesi që të

marrim vendime, sepse ne mund ta kemi nesër, të nderuar deputetë, një produkt, i cili del i ri dhe ka nevojë që të jetë konkurrent në treg, dhe ajo punë duhet të bëhet me procedurë shumë të thjeshtë. Prandaj, nëse e konsideroni se duhet ngarkuar procedurën, nuk ka problem, ne jemi të gatshëm që vendimet e Kuvendit t'i marrim ashtu siç mendon sovrani. Faleminderit!

KRYETARI: Safete, urdhëro!

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Po më duket se u dhanë mjaft sqarime lidhur me këtë çështje, megjithatë Komisioni për Legjislacion e ka miratuar edhe një variant që ka qenë, pa shkuar nëpërmjet vendimit të Kuvendit dhe e ka konsideruar se nuk ka shkelje kushtetuese. Dhe, tek pastaj, pas kthimit të ligjit nga Presidentja, ka ardhur një reagim i tillë. Nuk është fjala për ndryshimin e ligjit, por për ndryshimin e aneksit, i cili i është bashkangjitur ligjit që ka të bëjë edhe në këtë ligj.

Edhe në ligjin që e kemi pas kësaj pike të rendit të ditës, që ka të bëjë me aneksin, do të thotë ky aneks e lehtëson procedurën për t'i ndihmuar biznesit, të cilën çështje e kemi diskutuar edhe në Parlament.

Prandaj, unë konsideroj që, meqenëse vendimi merret në Kuvend, nuk ka ndonjë shkelje procedurale dhe është fjala për aneksin dhe jo për ligjin.

KRYETARI: Arben, urdhëro!

ARBEN GASHI: Kryetar,

Edhe një herë besoj se këto janë gjëra elementare. Aneksi kur është pjesë e ligjit, është vetë ligj. Nuk mund të trajtohet si diçka tjetër përveç se ligj dhe ndryshimi i aneksit nënkupton procedurë për nismë për ndryshim dhe plotësim të ligjit. Në këtë rast kemi nismë për plotësim dhe ndryshim të ligjit. Zgjidhja është e tillë: ose mbetet që të ndryshohet ligji, ose, nëse ka vullnet Kuvendi, mundet t'ia delegojë Qeverisë me akt nënligjor për ta rregulluar aneksin, ta bëjë një me akt nënligjor, ta vendosë listën e mallrave që i lejohen, mirëpo a do Kuvendi t'ia japë këtë kompetencë Qeverisë, është çështje tjetër. Është çështje pastaj edhe e rreshtimit politik, edhe arsytimit politik.

Mirëpo, aneksi si i tillë është pjesë e ligjit, është ligj dhe nuk mund të ndryshohet aneksi pa u ndryshuar ligji, dhe a ka kaluar një herë nëpër komision, e s'e ka vërejtur komisioni, pak rëndësi ka ajo. E rëndësishme është që në seancë a po lejojmë të shkojë një vendim, i cili është në kundërshtim me praktikën ligjvënësë në Kosovë, dhe në asnjë vend tjetër nuk mund të ndryshohet një pjesë e ligjit pa e marrë vendimin vetë ai institucion i cili e ka vendosur ligjin dhe institucioni që e ka vendosur ligjin është Kuvendi, e nuk mundet dikush tjetër ta ndryshojë ligjin, përveç Kuvendit, me të njëjtën procedurë, me të cilën e ka aprovuar ligjin.

Nuk ndryshohet me rezolutë. Vendimet e Kuvendit dihen, o janë rezoluta, o rekomandime, o ligje. Çfarë tjetër lloj vendimi mund të nxjerrim ne, unë nuk e di, që të mund ta ndryshojmë një ligj me të. Dërgoje në lexim të tretë, dhe u krye.

KRYETARI: Sabri, a e deshe fjalën? Jo. E vërteta është që ligji mund të ndryshohet me ligj, e nëse është çështja e prodhimeve vendore. Nëse është interesimi i prodhimeve vendore, unë nuk mendoj se Parlamenti do të krijojë problem për të votuar në favor të atij prodhimi. Kështu që, unë mendoj që ligji mund të ndryshohet me ligj, e jo me forma të tjera. Megjithatë, shkojmë në procedurën e votimit. Naser, urdhëro!

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Po, është një çështje që e kemi diskutuar. Tash unë jam ndërmjet dilemës së një vendimi që e kam sjellë vetë me Safeten, të cilin po e prezanton, dhe një arsye që po e jep Komisioni për Legjislacion, por në këtë rast thjesht jam për propozimin e Arbenit që të shkohet në leximin e tretë edhe bashkërisht të gjejmë zgjidhje. Por, unë i kisha lutur këta të Komisionit për Legjislacion që kur t'i drejtohen në këto raste Komisionit për Buxhet dhe Financa të mos na dërgojnë letra që vetëm nuk janë me parime juridike, por të na japin edhe propozimet konkrete sesi të veprohet, sepse ne nganjëherë për çështje juridike nuk po jemi shumë të përgatitur dhe po bëjmë këso lëshimesh.

Unë, megjithatë, kisha propozuar dhe besoj që edhe Safetja do të ishte pajtuar të na jepet edhe një shans që t'i harmonizojmë këto, që të mos bëjmë ndonjë gabim që tani mund të ketë pasoja.

KRYETARI: Safete! E dëgjove propozimin?

SAFETE HADËRGJONAJ: Kryetar, unë e dëgjova propozimin, ne po e shtyjmë për lexim të tretë, por, megjithatë, mendoj se këto janë ligje të cilat po shtyhen në Kuvend kot së koti. E kemi ligjin tjetër, të cilin ne për çdo ditë e diskutojmë se jemi të interesuar për lirimet doganore dhe e kemi mbajtur nëpër procedurat e Kuvendit tani e 7 muaj dhe nuk po mund ta nxjerrim ligjin nga këtu. Megjithatë, ne do të konsultohemi prapë, mirëpo një praktikë të tillë e kemi dhe një vendim të tillë e kemi marrë në Kuvend. Domethënë, nuk është rasti i parë.

KRYETARI: Faleminderit! Megjithatë, mendoj se nuk kemi nevojë të shkojmë në lexim të tretë, por e shtyjmë këtë për seancën tjetër dhe komisionet le t'i harmonizojnë dhe të na sjellin qëndrimet e harmonizuara. Kjo do të ishte zgjidhja më e mirë. Do të thotë, e heqim nga rendi i ditës. Na duhet një votim formal. Kush është për? A ka kundër? Faleminderit!

Domethënë, takohen dy komisionet dhe në seancën tjetër na e sjellin të harmonizuar.

Të pranishëm janë 80 deputetë. Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me vendimin e Presidentes të Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 04/L-163 për mallrat e liruar nga tatimet doganore dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor

Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Legjislacion, në pajtim me vendimin e Kuvendit, datë 11 prill 2013, e kanë shqyrtuar vendimin e Presidentes të

Republikë së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 04/L-163 për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor dhe Kuvendit ia kanë parashtruar raportin me rekomandime.

E ftoj kryetaren e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, deputeten Safete Hadërgjonaj, që ta arsyetojë raportin me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Zori kryetar!

Edhe këtu e kemi të njëjtin problem, të njëjtën çështje, kështu që kisha propozuar që ta shtyjme edhe këtë pikë të rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme dhe të shohim më tutje.

KRYETARI: Pra, u shty për mbledhjen e ardhshme me kërkesën e kryetares së Komisionit FunkSIONAL, deputetes Safete Hadërgjonaj. Edhe ky ligj mbetet për seancën e radhës.

Pika e gjashtë, përkatësisht pika 2:

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sistemin e lejeve dhe licencave

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin tij në parim.

E ftoj ministrin Beqaj që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Unë sot po e bëj prezantimin në emër të Qeverisë të Ligjit për sistemet e lejeve dhe licencave.

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Qëllimi i këtij projektligji është që t'i vendosë parimet dhe rregullat që e rregullojnë nga Qeveria sistemin rregullativ të veprimtarive private dhe publike për ta kufizuar rregullimin e tillë në atë që është e domosdoshme për ta mbrojtur shëndetin publik, sigurinë publike, mjedisin dhe përdorimin e resurseve natyrore në Republikën e Kosovës.

Objektiv kryesor i këtij projektligji është që të bëhet rrallimi i veprimtarive private dhe publike nga cilido organ qeveritar në Republikën e Kosovës, me qëllim të mbrojtjes të shëndetit publik, sigurisë publike, mjedisit, si dhe përdorimit të resurseve natyrore në Republikën e Kosovës. Duke pasur parasysh nevojën për nxjerrjen e këtij projektligji me qëllim të rregullimit të fushës së lejeve dhe licencave, si dhe duke plasur parasysh analizën që u është bërë vendeve të rajonit në lidhje me rregullimin ligjor të kësaj fushe, është arritur në përfundim se opsioni më i mirë i mundshëm është nxjerrja e Ligjit për sistemin e lejeve dhe licencave, i cili do të mundësonte vendosjen e parimit dhe

rregullave që u bëhen veprimtarive private dhe publike nga cilido organ qeveritar në Republikën e Kosovës.

Projektligji për sistemin e lejeve dhe licencave do të mundësojë një ambient më të favorshëm për funksionimin e sistemit të lejeve dhe licencës, si dhe përcaktimin e rregullave të përgjithshme që i rregullojnë lejimet në Kosovë. Po ashtu, me këtë projektligj do të përcaktohen llojet e lejeve-licencave, rregullat dhe procedurat që rregullojnë licencimin profesional, si dhe do të krijohet regjistri qendror i llojeve të lejeve dhe licencave në Republikën e Kosovës.

Çështja e rregullimit të sistemit të lejeve dhe licencave është e një rëndësie të veçantë, andaj ky proces kërkon një mbikëqyrje specifike të vazhdueshme, gjithnjë me qëllim të vendosjes së parimeve dhe rregullave që rregullojnë sistemin rregullativ të veprimtarive private dhe publike. Zbatimi i projektligjit për sistemin e lejeve dhe licencave nuk parashihet implikime buxhetore nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Duke pasur parasysh nevojën për nxjerrjen e këtij projektligji me qëllim të rregullimit të fushës së lejeve dhe licencave, si dhe duke pasur parasysh analizën që u është bërë vendeve të rajonit në lidhje me këtë fushë, është arritur në përfundim se opsioni më i mirë është nxjerrja e këtij ligji.

Çështja e rregullimit të sistemit të lejeve dhe licencave është e një rëndësie të veçantë, andaj ky proces kërkon një mbikëqyrje. Në këtë drejtim, unë i kërkoj Kuvendit miratimin në parim të këtij ligji dhe ndërmjet dy leximeve do të bëhen amendamentet e nevojshme, të cilat do të harmonizohen me deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti edhe Industri, zoti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, më datën 2 të këtij muaji e ka shqyrtuar këtë projektligj në parim dhe rekomandon që i njëjti të miratohet.

Është diskutuar në komision, nuk është një praktikë në vendet në regjion. Ky është një propozim i Qeverisë që ka për synim krijimin e hapësirës më të mirë për biznes edhe në procedurat për marrjen e lejeve dhe licencave. Në fakt, ky projektligj merret me parimet e përgjithshme të këtyre proceseve dhe reduktimin e burokracisë për të arritur më shpejt deri te lejet dhe licencat për ata që bëjnë biznes në Kosovë.

Ishte një vend, një praktikë në një shtet në Gjeorgji dhe si rezultat e ka ngritur nivelin shumë lart, rangimin e saj për të bërë biznes pas aprovimit të këtij ligji. Shpresoj që edhe në vendin tonë do të jetë kështu, por kërkohet që ky projektligj në grupe punuese, komisioni me kontributin e deputetëve, të përmirësohet dhe të shihet që të dalë sa më mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputetja Salë Berisha-Shala.

SALË BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje ministër,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë dhe ju të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar me vëmendje këtë projektligj dhe mendon se synimi i Qeverisë për hartimin e këtij projektligji ka të bëjë me racionalizimin e tërë procesit të lejeve dhe licencave, disa prej të cilave janë të rregulluara edhe me ligje tjera.

Grupi Parlamentar gjatë këtij analizimi ka identifikuar disa dobësi dhe konfuzione që paraqiten me këtë ligj dhe më lejoni që disa prej tyre t'i veçoj këtu para jush. Në nenin 1, teksti si në projektligj i këtij neni lë përshtypje se nuk e pasqyron saktë qëllimin e projektligjit. Një formulim pak më ndryshe mund të jetë kështu: “Ky ligj ka për qëllim përmirësimin e mjedisit për të bërë biznes nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative në kryerjen e veprimtarive ekonomike, tregtare apo profesionale, ose përdorimin e të mirave publike, duke garantuar njëkohësisht mbrojtjen e interesit publik në ushtrimin e këtyre veprimtarive dhe përdorimin e të mirave publike”.

Neni 2, dispozita e këtij neni lë të kuptohet se ky ligj i rregullon veprimtaritë private dhe publike vetëm ato të cilat rregullohen, përkatësisht kontrollohen nga organet qeveritare. Meqenëse ne e dimë se në Kosovë ekzistojnë edhe agjenci tjera të pavarura, mbi 30 sosh, të cilat nuk janë organe qeveritare, por që kanë përgjegjësi rregullimin e veprimtarive të ndryshme, atëherë teksti si i tillë i përjashton veprimtaritë të cilat janë nën përgjegjësinë e këtyre agjencive.

Tek neni 3, paragrafi 1.8, sipas tekstit të përkufizimit të shprehjes “sistemi i lejeve dhe licencave”, kjo shprehje nuk përfshin edhe veprimtaritë publike, por vetëm ato private. Nëse në nenin e mëparshëm, nenin 1, qëllimi i ligjit thuhet se ky sistem i lejeve dhe licencave përfshin edhe veprimtaritë publike, atëherë duhet që të jetë në përkufizim edhe licenca.

Tek neni 11, paragrafi 3, propozojmë që duhet të evitohen shprehjet latine, të harmonizohen me tërë tekstin e projektligjit. Mandej, te neni 14, po ashtu konsiderojmë se është e panevojshme që me ligj të parashihet qasja elektronike për publikun, kur dihet se tani këto janë tejkaluar dhe kjo është një çështje administrative.

Neni 33, në bazë të këtij projektligji, përkatësisht paragrafi 1 të këtij neni, thuhet se pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, institucionet qendrore brenda gjashtë muajve i propozojnë ndryshimet e ligjeve përkatëse. Nëse e llogaritim edhe kohën që kalon miratimi i ligjeve në Kuvend sipas Rregullores së Kuvendit, atëherë kjo kohë është jashtëzakonisht e shkurtër, sepse konsiderojmë se shfuqizimi i licencave një vit pas hyrjes në fuqi të këtij projektligji është një afat i shkurtër që do t'i pengonte edhe bizneset të cilat kanë leje me afat të gjatë.

Ne si grup parlamentar e mbështetim në parim, duke shpresuar se kualitetin e këtij projektligji do ta rritim në fazën e amandamentimit në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputeti Lutfi Zharku.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës e ka analizuar projektligjin dhe në parim shpreh rezervat e saj në lidhje me këtë projektligj.

Duke mos hyrë në detaje, unë do të përpiqem që në 3-4 pika, apo çështje kryesore t'i përmend sa i përket këtij ligji. E para ka të bëjë me atë se ligji absolutisht nuk i përmbush qëllimet e proklamuar të Qeverisë mbi eliminimin e një numri të madh të licencave, por në realitet bile krijohet përshtypja se shtohen licencat. Deri tash kemi pasur licenca, tash ligji parasheh leje, parasheh regjistrim, parasheh njoftim, parasheh edhe licenca tjera, që deri tash së paku unë personalisht nuk e di që janë.

Çështja tjetër ka të bëjë se nuk është problemi i procedurave administrative. Ne kemi problem me numër të madh të licencave. Ligji është dashur të vijë me një formë tjetër, që i përcakton cilat licenca janë të panevojshme sot në biznes, përgjysmohet apo thjesht një numër i caktuar i atyre licencave të hiqet, por jo të hyjnë çështje administrative të rregullimit të licencave në përgjithësi. Nuk ka licencë që jepet nga ana e cilitdo institucion shtetëror që nuk e ka një procedurë administrative të caktuar prej komisionit për licencim deri te procedurat e ankesave etj. Kështu që vetë përsëritja e gjithë atyre procedurave me një ligj është e panevojshme.

Domethënë, në parim nuk ka nevojë të themi të bëhet një ligj për procedurat për licenca, për sistemim të licencave, por duhet të jetë secila licencë, e cila është e nevojshme dhe cila është e panevojshme.

Çështja e tretë ka të bëjë me atë se ligji aktualisht, edhe nëse vazhdon, krijon një konfuzion të themi në zbatimin e ligjit. Janë disa dispozita që thuhet që nëse nuk është licenca në regjistrin qendror, ajo nuk vlen. Është e pakuptueshme nëse një institucion e lëshon një licencë vetëm se nuk është në regjistër qendror, licenca nuk vlen. Në anën tjetër, jepet një afat 6 muaj ditë, i cili të rregullon të gjitha ligjet tjera, kurse ka mundur të bëhet me udhëzim administrativ nga Qeveria që t'u jepet një urdhëresë ministrive, e në realitet ato t'i rregullojnë apo t'i iniciojnë procedurat për ndryshim-plotësimin e ligjit.

Dhe, çështja e fundit, ne besojmë se ky ligj është i panevojshëm nëse nuk hidhet në një çështje elementare apo thelbësore të rirregullimit të licencave, të secilës licencë, mendojmë që ligji është i panevojshëm. Kështu që në pikat përmbledhëse, këto janë arsyet për të cilat LDK-ja mendon se ligji është i panevojshëm dhe nuk do ta votojë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të grupit të "Vetëvendosjes", kryetari Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” mendon që ky ligj nuk bën të kalojë për dy arsye kryesore. Duhet ta kemi parasysh që natyrisht që lejet dhe licencat në dukje të parë mund të shkojnë në kundërshtim me tregun e lirë, por natyrisht që tregu për t’i shërbyer një ekonomie, jo vetëm siç është e Kosovës, por në përgjithësi ekonomive kombëtare të shteteve duhet të jetë i rregulluar.

Dhe, natyrisht, që tregu i rregulluar do të duhej të orientohej kah nevojat e shoqërisë për zhvillim ekonomik, e jo kah nevojat e tregut, siç ndodh këtu në Kosovë. Mirëpo, duhet po ashtu që ta kemi parasysh që duke e pasur parasysh mënyrën se si funksionon kjo qeveri, dhe duke e pasur parasysh se cilat janë qëllimet e kësaj qeverie, atëherë çfarëdo rritje e licencave, e lejeve dhe përgjithësisht rregullimit të ekonomisë nuk bëhet për ta zhvilluar ekonominë, por për ta zhvilluar biznesin privat të ministrave dhe Qeverisë në përgjithësi, dhe në këtë drejtim konsiderojmë që përkundër faktit që jemi që ta kemi një treg të rregulluar, tregu që synon ta rregullojë kjo qeveri është në fakt synim për ta kontrolluar atë treg për të mirat e tyre personale.

Prandaj, edhe ne jemi kundër.

KRYETARI: Në emër të Grupit Aleancës, deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmëri të Kosovës mendon se me këtë projektligj nuk rregullohet diçka që do të ketë lehtësira për biznesin dhe druaj që me këtë ligj mos po rriten procedurat administrative, dhe në vend se të bëhen lehtësira, mund të ketë probleme tjera dhe ngufatje dhe më shumë procedura tjera për licenca.

Prandaj, Grupi i Aleancës nuk do ta votojë në parim.

KRYETARI: Fjala është për kryetaren e Koalicionit Kosova e Re, deputeten Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Përshëndetje për ministrin dhe deputetët,

Duke marrë parasysh se Ligji për rregullimin e licencave dhe lejeve ka ardhur edhe nga Zyra e Kryeministrit, në bashkëpunim me Ministrinë e Integrimeve dhe Ministrinë e Tregtisë, atëherë duhet të kemi kujdes në rast se duam të jemi pjesë e BE-së, duhet t’u japim hapësirë më të madhe veprimtarive private, e jo veprimtarive publike, se nga Buxheti i Kosovës nuk mund të ndërtohet shteti i Kosovës, por duhet të ndërtohet nga bizneset private.

Dhe, me këtë projektligj, Qeveria e Republikës së Kosovës e ka përcaktuar çështjen e dhënies së licencave, trajtimit të tyre dhe mënyrës se si do të funksionojnë këto licenca.

Ne si Koalicion për Kosovën e Re do t'i japim përkrahje projektligjit dhe gjatë amandamentimit do t'i japim sugjerimet tona. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të SLS nuk ka të lajmëruar. Në emër të "6+", Enis Kervan e ka fjalën.

ENIS KERVAN: Faleminderit, kryetar!

Ish sahatсени dyznlе yasatasarisi uyelikle onaz ve izin belgelerini verilmesini duzenlemekte dir, o balamda "6+" parlament grubu olarak yasatasarisini destekliyoruz.

KRYETARI: Në emër të "Zajednička Budućnost", Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, predsedniče!

Poslanička grupa "Zajednička Budućnost" je analizirala pažljivo Nacrt zakona o sistemu dozvola i licenci. Mislimo da je zakon veoma važan i mislimo da će povoljno uticati i napraviti neophodan red u javnom i privatnom sektoru.

Poslanička grupa "Zajednička Budućnost" daće radom u funkcionalnim i stalnim komisijama svoj doprinos i mislimo da ćemo na taj način poboljšati Nacrt zakona. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Është radha e deputetëve. Për diskutim është lajmëruar deputeti Hashim Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Në kohën kur duhet të bëjmë më shumë përpjekje për lehtësimin e proceseve dhe procedurave për të bërë biznes, përkatësisht për të bërë punë individuale apo grupe, kur duhet eliminuar deri në minimum procedurat burokratike dhe ndikimin e Administratës shtetërore në ekonomi dhe në biznes neve na ofrohet një ligj, i cili dikton orientim krejtësisht të kundërt.

Projektligji për sistemin e lejeve dhe licencave ka plot mangësi dhe të meta. Ka shumë paqartësi, konfuzion, nuk i definon qartë kompetencat dhe përgjegjësitë, nuk e qartëson se cili është organi kompetent. Shumë gjëra janë thënë në mënyrë të përgjysmuar. E lejon mundësinë për veprim në bazë të momentit apo disponimit individual. Prandaj, që në fillim dua të them që projektligji kështu si është i propozuar është i dëmshëm dhe si i tillë nuk mund të aprovohet.

Pos vërejtjeve të përgjithshme që i ceka më lart, më lejoni që në pika të shkurtra t'i paraqes edhe vërejtjet konkrete që, për fat të keq, nuk janë pak. Shkojmë te përkufizimet:

1. Përkufizimi i parë rreth autoritetit kompetent thotë: "Autoriteti kompetent, një organ i Qeverisë qendrore apo lokal i autorizuar sipas rregullit që është kompetent për ta rregulluar një apo më shumë fusha të veprimtarisë", është përkufizim krejt i paqartë, se në fakt nuk përkufizon e as nuk sqaron asgjë.

2. Neni 4 flet se lejimi nuk do të ketë fuqi ligjore. Kjo do të bëhet nëse është gjetur që veprimtaria paraqet rrezik për shëndetin publik, për sigurinë publike etj., mirëpo nuk dihet se kush e përcakton këtë nivel të rrezikut. Kjo, jo vetëm që nuk thuhet në këtë nen, por në asnjërin nen nga 34 nene të këtij ligji.

3. Neni 6, lajmërimi. Mund të kërkohet nga një autoritet kompetent, por cili është ai autoritet, a është niveli lokal apo qendror, apo është ndonjë agjenci e pavarur. Pra, mungon adresa e saktë e këtij autoriteti.

4. neni 10, Bordi i licencimit profesional është që organi ekzekutiv që administron edhe mbikëqyr të gjitha fushat që kanë të bëjnë me licencimin e profesionalistëve në atë profesion. Nëse ai është organ ekzekutiv, atëherë çka do të mbikëqyrë. Në këtë rast ky ligj e fuqizon konfliktin e interesit. Meqenëse Bordi jep përgjegjësi mbikëqyrëse dhe ekzekutive. Këto të dyja nuk shkojnë bashkë. Po ashtu, nuk ka asnjë detaj rreth bordit, numrit të anëtarëve, struktura, profesioni, mënyra e zgjedhjes apo emërimi dhe kohëzgjatja e angazhimit, apo të punës në bord.

Kryetar, më duhet ta ndërpres fjalimin dhe ta dorëzoj me shkrim për arsye se nuk po dëgjohet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ju e dini që me Kushtetutë, deputetët nuk i nënshtrohen asnjë detyrimi. Ministri Beqaj e ka fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë e kuptoj që ka ndoshta shumë hapësirë që ligji të diskutohet edhe më tutje dhe të plotësohet, por ideja e këtij ligji është që të vihet një kornizë e përgjithshme e sistemit të lejeve dhe licencave në Republikën e Kosovës, të vihet një parim universal në nivel, edhe komunal, edhe nivel qendror, prandaj mendoj që është një ligj i arsyeshëm, një ligj i cili mundëson avancimin e zhvillimeve ekonomike në vend.

Dhe, unë ju ftoj që ta votojmë në parim dhe në ndërkohë ndërmjet dy leximeve të plotësohen të gjitha shqetësimet, respektivisht amandamentimet, të cilat e pasurojnë ligjin në fjalë. Faleminderit!

KRYETARI: Diskutime tjera nuk ka. Të lajmëruar nuk ka. Shkojmë në procedurën e votimit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Prania fizike 73 deputetë, me elektronikë 92 deputetë. Votojmë tash!

Konstatohet se me 34 vota për, 33 kundër, ligji miratohet në parim. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

6. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2012

Raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2012 e ka shqyrtuar Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2012 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputetin Zenun Pajaziti, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit në mbledhjen e datës 5, e ka shqyrtuar raportin vjetor të punës të Rregullatorit të Komunikimeve Elektronike për vitin 2012.

Komisioni ka vlerësuar se ky raport është në pajtim me nenin 11 të Ligjit për komunikimet elektronike dhe po ashtu ia rekomandon Kuvendit për miratim. Faleminderit!

KRYETARI: Vërtet deputetët nuk i nënshtrohen asnjë diktati, por është mirë pak një diktat moral ta kenë parasysh.

Në emër të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Deputeti Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar raportin e paraqitur nga ish-ART-ja, që tani quhet Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, apo shkurt ARKEP.

Autoriteti me kujdes të duhur e kishte përmbyllur arritjen e gjendjes optimale, duke iu referuar aspektit të harmonizimit të ndarjes së brezave frekuencorë për operatorët ekzistues të rrjeteve mobile në brezat të GSM 900 dhe mbi bazën e këtij raporti dhe analizave që janë bërë, është një arritje që sipas rekomandimeve të Autoritetit Qeveritar të Republikës së Kosovës ka nxjerrë vendime për miratimin e shenjës thirrëse të prefiksit Z6 për shërbimet radioamatore, me çka edhe janë krijuar parakushtet për rifunksionalizim.

Po ashtu është intensifikuar pjesëmarrja në mekanizmat ndërinstitucionalë të këtij institucioni rregullator në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, kur si rezultat janë harmonizuar dy marrëveshje teknike me shtetet e regjionit për harmonizimin e

radiofrekuencave në zonën ndërkufitare me brezat frekuencorë EGSM 900 dhe DCS 1800, në përputhje me parametrat teknikë të rekomanduar sipas standardeve të Bashkimit Evropian.

Ky rregullator gjatë aktivitetit njëvjeçar po ashtu ka asistuar në mënyrë aktive pranë grupeve të dialogut teknik, që është duke u zhvilluar në Bruksel, për të ofruar tërë performansën teknike dhe obligimet ligjore kushtetuese, që obligon dialoguesit në këtë dialog teknik, e që është duke u zhvilluar dhe qasjen e tyre për ta nxjerrë edhe numrin e prefiksit tonë ndërkombëtar si vend.

Duke e përmbyllur, përfundimisht ne ftojmë kolegët tanë që ta votojnë këtë material. Është një material voluminoz, që të gjithë deputetët e kanë pasur dhe ju falënderojmë për vëmendjen e shtuar gjatë diskutimit.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputetja Teuta Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, çdo vit me radhë vjen raporti i ish- ART-së, e tash i ARKEP-it, dhe si zakonisht është raport bukur detaj dhe i punuar teknikisht mirë.

Unë do të cek vetëm dallimet, të cilat janë në raport, për dallim me vitin e kaluar. Mendoj që pikat të cilat duhet të ceken janë ato të harmonizimit, ndarjes dhe arritjes së simetrisë së brezit GSM 900 dhe DCS 1800 mHz, gjë që deri në këtë raport nuk ka qenë rast.

Pika tjetër, e cila është për t'u përshëndetur, është se janë krijuar parakushtet dhe mundësitë për shfrytëzimin e resurseve frekuencore në dispozicion nga operatorët ekzistues të rrjetave mobile për ofrimin e shërbimeve të rrjetave telekomunikuese mobile për aplikimin e teknologjive të reja të gjeneratës së tretë dhe katërt, të njohura si shërbimet 3G dhe 4G, respektivisht të teknologjive UMTS, LTE etj.

Duke mos ndikuar negativisht në konkurrencë, mendoj që pikërisht kjo e ka hapur konkurrencën dhe e ka rregulluar tregun, duke i nxitur operatorët ekzistues që të shkojnë në nivelet më të larta teknologjike të telefonisë mobile.

Gjë tjetër, e cila duhet të përshëndetet, është gjithashtu marrja e prefiksit për radioamatorë, marrja e prefiksit Z6, me të cilën janë krijuar parakushtet për pranimin e këtyre operatorëve tanë në IRU. Është bërë harmonizimi i frekuencave me Malin e Zi dhe me shtetet tjera, gjë që është përsëri një vlerë e shtuar në krahasim me raportet e viteve të kaluara. Rregullimi i terminimeve për shërbimet mobil MTR dhe fikse FTR është përsëri diçka që mund të quhet si sukses dhe dallim me raportet e viteve të kaluara.

Gjithashtu, mendoj që duhet të ceket dizajnimi i sistemit efikas të kontrollit të brendshëm në menaxhimin financiar, në kontrollin e brendshëm, gjë që ka rezultuar me certifikimin ndërkombëtar TYV Nort, domethënë certifikimet e sistemit të menaxhimit të cilësisë, gjë

e cila ART-në apo ARKEP-in sot e ka shndërruar në një agjenci të certifikuar për menaxhim të cilësisë.

Në këtë raport kemi parë jo një realizim, por një premtim që në vitin 2014 pritet të aktivizohet Qendra për Luftimin e Krimit Kibernetik, gjë e cila deri më tani nuk ka ekzistuar. Gjithashtu, sa u përket të hyrave, e shohim që të hyrat e planifikuara në fakt janë tejkaluar dhe në vend të 4,5 milionëve, sa ishin planifikuar, duke iu falënderuar licencimeve, ARKEP-i ka inkasuar afërisht 5 milionë e 750 mijë euro.

Thuhet që edhe licencat tashmë merren për një kohë të shkurtër, duke iu falënderuar ligjit të ri, i cili ia ka mundësuar këtë procedurë. Por, gjërat tjera, të cilat duhet të cekën janë edhe shënimet, të cilat nuk janë karakteristikë vetëm e Kosovës, janë trend botëror dhe të cilat duhet të përmenden, e kjo është që platformat e zërit të ‘Valës’ dhe ‘IPKO’-s kanë pësuar një rënie prej 37% për shkak të platformave çfarë janë Skype dhe Viber, e kjo vazhdon të ketë rënie edhe në shërbimin e SMS-ve.

Telefonia fikse, gjithashtu, e ka një tkurrje prej 13,3%, gjë që përsëri nuk është trend vetëm në Kosovë, por është trend botëror. Por, në anën tjetër, interneti ka rritje prej 6,18%, gjë që edhe e arsyeton krijimin apo përdorimin më të madh të platformave çfarë janë Skype dhe Viber dhe platformat tjera të ngjashme. Dhe, sot, janë 152 mijë abonentë, gjë që Kosovën e rendit në një prej vendeve me një penetrim bukur të lartë të internetit në të gjitha viset.

Platforma e zërit ka ulje, por në anën tjetër numri i përdoruesve të telefonisë mobile ka rritje për 12%, përsëri në relacion me rritjen e internetit dhe përdorimin e teknologjive më të reja.

Penetrimi i rrjetit shkon deri në 90% dhe paraqet një mbulesë të mirë me sinjal, gjë që krijon kushte që një pjesë e zhvillimit ekonomik bukur të rëndësishëm të konsiderohet pikërisht këtu, gjë që nga bisedat e Qeverisë dhe Zhvillimit Ekonomik shihet që është plotësisht e anashkaluar, ndonëse ekziston një bazament i fuqishëm që zhvillimi ekonomik të bazohet pikërisht në teknologjinë informative.

Nga bisedat, të cilat i kuptuam gjatë raportimit të stafit të ARKEP-it, e pamë që ata janë thellësisht të inkuadruar në bisedimet për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë lidhur me telekomunikacion, ku angazhohen me marrjen e kodit telefonik dhe të internetit, sikur edhe për mbulesën e sinjalit digjital, ndonëse këto deri më tani jepen dhe vazhdojnë të jepen nga ITU-ja e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Tregu i telekomit sipas këshilltarëve dhe sipas raportit është vlerësuar si një treg kompetitiv dhe i shëndoshë, gjë e cila përsëri na vë në dyshim përse atëherë telefonia mobile, PTK-ja e Kosovës është shitur me një çmim aq të ultë, ndonëse ekspertët e kanë karakterizuar këtë treg si kompetitiv dhe të shëndoshë kah aspekti financiar.

Sa i përket mbulimit me sinjalin digjital, shihen pengesa nga Serbia dhe allotmentet të cilat deri më tani nuk janë lejuar për përdorim në Kosovë dhe pjesa e madhe e territorit

serb të Kosovës, dikur rreth 40%, mbulohet me këtë sinjal nga Serbia dhe karakterizohet si një agresion digjital nga ky shtet. Pjesa e buxhetit e cila ka munguar në raportin origjinal dhe e cila ka qenë pjesë e kritikës gjatë bisedës në Komisionin Parlamentar për Zhvillim Ekonomik është plotësuar dhe ka ardhur si një pjesë e veçantë, e cila i ka plotësuar kërkesat tona për shpjegime detale dhe krahasuese të ARKEP-it me vitet e kaluara.

Nga kualiteti i punimit të raportit dhe nga puna, e cila është evidentuar nga bisedat dhe nga raporti, Grupi Parlamentar i LDK-së mendon që ky raport duhet të marrë notë pozitive dhe të votohet.

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, kryetari i grupit, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Raporti vjetor i Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2012 karakterizohet me të njëjtat mangësi që ka pasur edhe në vitet e kaluara, por është një prej atyre raporteve dhe nuk është i vetmi, sepse ka edhe nëpër institucione tjera që është po aq i rëndësishëm në ato që nuk i thotë, sikur në ato që i thotë.

Natyrisht, që ato të arritura të Autoritetit, që janë të raportuara, kisha për të thënë në mënyrë shumë të mirë dhe të detajuar në raportin vjetor të vitit 2012, janë për t’u përshëndetur. Pra, sikur kodi, sikur puna e Autoritetit, në përgjithësi.

Po ashtu, nga raporti lehtë kuptohet se çfarë ndikimi dhe në çfarë mënyre udhëhiqet dhe rregullohet tregu u telekomunikimeve, veçanërisht në telefoninë mobile dhe në telefoninë fikse në Kosovë, gjë që e dëshmon edhe atë që e përmendi edhe zonja Sahatqija, pra nevojën edhe mosarsyetimin absolut ekonomik të kësaj ndërmarrjeje privatizuese që e ka Qeveria e Kosovës në këtë fushë, veçanërisht me shitjen e Postë-Telekomit, apo 75% të aksioneve të Postë-Telekomit të Kosovës, gjë që po shpresoj shumë që do të kemi rastin ta diskutojmë edhe njëherë këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe ta kemi rastin që t’i themi jo këtij privatizimi kriminal dhe shumë të dëmshëm për Kosovë.

Po, në anën tjetër ky raport nuk na tregon fare për dy çështje që janë shumë të rëndësishme e që kanë të bëjnë edhe me këtë dialogun apo negociatat, që po zhvillohen me Serbinë. Në njërin anë, sikur edhe në raportet tjera, përmendet që Serbia është problem, por nuk na thuhet se çfarë ka bërë autoritet, pra për ta evituar këtë problem, për ta shmangur këtë problem. Meqenëse është autoritet i pavarur i cili do të duhej të ishte fjala e fundit për sa i përket rregullimit të tregut dhe hapësirës telekomunikuese në Kosovë, këta duhet të ndërmarrin masa, në mënyrë që këtë ndërhyrje, këtë agresion që e bën Serbia në territorin e Kosovës, që ta shmangim atë.

Dhe, kjo nuk është një çështje që ka ndodhur vetëm vitin e kaluar, por që po ndodhë vazhdimisht dhe asnjëherë autoriteti nuk ka ndërmarrë ndonjë masë për ta evituar këtë. Ka pasur disa tentime herëve të kaluara, për t’i shkyçur antenat e kështu me radhë, gjë që janë ndalur nga instanca politike. Pra, kjo e sjell edhe një diskutim tjetër, për sa i përket funksionimit të këtyre autoriteteve, që ne i quajmë të pavarura e që janë nën Kuvendin e

Republikës së Kosovës, funksionimit të tyre në Kosovë, sepse po shihet qartë që autoriteti sado i mirë dhe i përgatitur të jetë kur politika është e gabuar, atëherë as autoriteti nuk mund të bëjë asgjë.

Dhe, këto ndërhyrje politike në autoritet, natyrisht që Kuvendi duhet të bëjë çmos që t'i shmang. Pra, është detyrë e jona që ta mirëmbajmë dhe ta mbikëqyrim pavarësinë e këtyre autoriteteve, përndryshe natyrisht që këto edhe kontrollohen nga politika jo fort të mira dhe jo fort të sinqerta karshi Kosovës, siç po ndodh edhe me autoritetin.

Shkuarja e drejtuesve të këtij autoriteti në Bruksel është edhe antikushtetuese, përveçse e palogjikshme. Pra, ky është autoritet, që duhet ta rregullojë për së brendshmi tregun e Kosovës dhe tregun e telekomunikimeve në tregun postar, në përgjithësi. Nuk ka kurrfarë detyre edhe nuk ka kurrfarë të drejte ky autoritet që të shkojë dhe të merret vesh ose të negociojë me Serbinë, për çështje që janë kryekëput çështje të Kosovës.

Në anën tjetër, është edhe një çështje që është dashur të jetë në raport në mënyrë më të detajuar, është çfarë ka bërë autoriteti karshi një rezolute të Kuvendit, për kodin telefonik që Kuvendi e ka votuar, me të cilin kërkon nga Qeveria që t'i ndërmarrë masat për të aplikuar kodin telefonik të Republikës së Shqipërisë në Kosovë. Pra, kjo rezolutë është ende në fuqi, siç e dimë të gjithë, por as Qeveria e as ky autoritet, të paktën nuk po na tregojnë se çfarë kanë bërë në atë drejtim, nëse kanë bërë ndonjë gjë.

Dhe, kjo është shumë brengosëse, sepse autoriteti po e them edhe njëherë është drejtpërsëdrejti nën Kuvendin e Republikës së Kosovës, është i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërkohë që rezolutat e Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk i merr fare parasysh. Dhe, kjo është shumë brengosëse për mënyrën se si po funksionon ky sistem i qeverisjes, do të thosha në Republikën e Kosovës. Prandaj, për shkak të këtyre mangësive, Lëvizja "Vetëvendosje" mendon që nuk mund ta votojnë këtë raport, edhe pse jemi të vetëdijshëm, që mos votimi i raportit prapë po e vazhdon avazin e njëjtë, por që është një problem që e kemi me të gjitha këto autoritete ne si Kuvend, që llogaritemi formalisht të jemi mbikëqyrësit dhe shefat e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka, në emër të AAK-së, deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Kolegë deputetë,

Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ka analizuar raportin e ART-së dhe vlerëson se raporti teknikisht është më i mirë se sa viteve të kaluara. Ka material më të hollësishëm edhe pse ka mungesa të shumta, atë që e thanë shumë mirë në mënyrë profesionale deputetja Sahatqija dhe deputeti Visar Ymeri, mirëpo, ka përparime në raport në pikëpamje teknike. Ndërsa sa i përket të hyrave buxhetore gëzon fakti, se kjo agjenci që krijon të hyra buxhetore ka një rritje më tepër se sa të planifikuar. Ndoshta mungon një analizë, se a ka mund të bëhet më shumë që të ketë të hyra buxhetore, mirëpo gëzon fakti se ka rritje në bazë të planifikimit.

Ndërsa, sa i përket raportit financiar, ata kanë dorëzuar një raport i cili në mënyrë të hollësishme është i detajizuar në mënyrë analitike dhe sintetike për shpenzimet dhe të hyrat.

Në parim grupi i Aleancës do ta përkrahë një raport me gjithë të metat që i ka, mirëpo disa gjëra dëshirojmë që edhe politikisht të zgjidhen me qëllim që ky raport në të ardhmen të jetë më i suksesshëm nga kjo agjenci me rëndësi për Kosovën.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, kryetarja zonja Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Koalicioni për Kosovë të Re ka shqyrtuar raportin e Autoritetit Rregullativ të Telekomunikimeve Elektronike dhe Postare dhe duke marrë parasysh se edhe në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Autoriteti i cili është i formuar si Autoritet i pavarur nga Kuvendi i Kosovës, i cili ushtron rregullimin ekonomik në sektorin e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare në bazë të Ligjit për komunikime elektronike, mund të themi se raporti i këtij autoriteti është raport shumë i mirë dhe pasqyron gjendjen faktike, e cila ndodhet në shërbimet ekonomike elektronike dhe shërbime postare, mirëpo në efekt shihet mjaft mirë, se ky Autoritet ka pas miratuar dhe Qeveria një agjendë digjitale për digjitalizimin, mirëpo tash të shohim në bazë të vendimeve të Republikës së Kosovës sa do të jetë ky Autoritet i përgatitur që të zbatojë këtë agjendë.

Në efekt, në raportin të cilin e ka pru Autoriteti në Kuvendin e Kosovës mund të themi se paraqiten pasqyrat e të ardhurave nga shërbimet e komunikimeve elektronike, internetit, telefonisë fikse. U tha edhe nga parafolësit tjerë që s'dua të përsëris, në efekt ky bord i Autoritetit është pjesë edhe e bisedimeve teknike mes të Kosovës dhe Serbisë për çështjen e telekomunikacionit dhe ne kemi kërkuar po nga anëtari i Bordit, kryetari i Bordit zoti Ekrem Hoxha që të na jep sqarime gjatë komisionit parlamentar, se çka po ndodh me çështjen e operatorit të ri i cili duhet të hyjë në rast se Kosova merr kodin e telefonisë fikse dhe telefonisë mobile.

Mirëpo, në efekt ai nuk na dha përgjigje direkte, por një përgjigje shumë të shkurtër, pritet që gjatë kohës së bisedimeve të shihet çka po ndodh. Mirëpo, Ligji i komunikimeve elektronike dhe postare e jep shumë të qartë mundësinë e ardhjes së një operatori të ri të telefonisë mobile, që ai duhet të marrë licencën brenda Autoritetit Rregullativ dhe në rast se s'merr licencë ne kemi mjaft probleme me brezat frekuencore, të cilat i shfrytëzojnë operatorët serb dhe për këtë mundësi ata duhet të kërkojnë nga ky Autoritet, që të kenë licenca, përndryshe nuk duhet të funksionojnë në Kosovë.

Të hyrat buxhetore, siç tha edhe pak më parë deputeti nga AAK-ja, është Autoriteti i vetëm i cili ka të hyra buxhetore mjaft të mira, mirëpo, edhe në efekt, auditori i cili jep pasqyrën e këtij Autoriteti nuk jep kurrfarë vërejtjeje. Do të thotë, se ky autoritet ka

shfrytëzuar mjaft mirë të hyrat buxhetore dhe buxhetin, i cili është i ndarë nga Buxheti i Kosovës.

Mund të themi se si Koalicion për Kosovë të Re e përkrahim raportin dhe urojmë që ky autoritet të japë vlerësimin përfundimtar edhe në bisedimet teknike mes të Kosovës dhe Serbisë dhe të thotë se në rast se do të vijë një operator i ri i telefonisë mobile, atëherë duhet të marrë licencën brenda këtij autoriteti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të grupeve parlamentare nuk është paraqitur dikush tjetër. Fjalën e ka kërkuar zonja Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Unë kam kërkuar fjalën në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Meqenëse, në bazë të nenit 81, pika 4 të Ligjit nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare i raporton Kuvendit për shpenzimet buxhetore me raportin vjetor.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor ka vlerësuar se në raport janë prezantuar shpenzimet në mënyrë të detajuar, sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike.

Raporti po ashtu, përmban të dhënat për të hyrat dhe planifikimin e buxhetit dhe krahasimet me realizimin e shpenzimeve në vitet paraprake. Nga të dhënat shihet se buxheti i Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare ka qenë 769 381 euro, ndërsa janë shpenzuar 632 278 euro apo 82% nga buxheti i planifikuar.

Për paga dhe mëditje janë shpenzuar 100%, kuptohet si të gjitha agjencitë tjera, mallra dhe shërbime 81%, shpenzimet komunale 74%, kurse shpenzimet kapitale janë 59% të shpenzuara.

Nëse marrim dhe shikojmë analogjinë e viteve të kaluara, shpenzimet kapitale, po ashtu janë në një masë shumë të vogël të shpenzuara, bile edhe nën 59% kemi pasur edhe 10 e 20% nga ky institucion, që ka shpenzuar tek investimet kapitale. Kurse, kemi një presion të fuqishëm nga ky institucion me rastin e miratimit të buxhetit, që të ndahen më shumë mjetet për investime kapitale.

Megjithatë, realizimi është në nivelin siç është, nuk është realizim i mirë, për çka kërkohet që ky autoritet t'i përmirësojë kapacitetet planifikuese, me rastin e planifikimit të buxhetit.

Të hyrat për vitin 2012 kanë qenë 5 749 363 euro, çka do të thotë se ka pasur një rritje të të hyrave në krahasim me vitin 2011.

Pas diskutimeve në Komision dhe sqarimeve që janë dhënë nga ana e përfaqësuesve të këtij Autoriteti, Komisioni njëzëri ka miratuar raportin financiar të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe vlerësoj se i njëjti përmbush obligimet

ligjore për raportim që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe i ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë vetëm desha për sqarim për publikun lidhur me asistimin që i bën Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare delegacionit tonë teknik në dialogun që është duke u zhvilluar në Bruksel, se nuk është antikushtetues siç u deklarua nga Grupi i “Vetëvendosjes” dhe kjo është një fatmirësi e madhe që një grup, një institucion i yni në mënyrë profesionale u asiston grupit politik gjatë dialogimit për të zgjidhur këto çështje, të cilat janë të pazgjidhura.

Prandaj, nuk është mirë që të refuzohet çdo gjë e cila edhe të thirret në emër të Kushtetutës, sepse nuk është antikushtetuese, por është një fatmirësi që grupet profesionale të Autoritetit Rregullativ u asistojnë në mënyrë konstante derisa të zgjidhet i tërë problemi. Faleminderit!

KRYESUESI: S’ka të tjerë të paraqitur, por nuk kemi kuorum për të votuar. Si duket duam të bëjmë praktike, se po thirrmi shumë herë, herë në praktikat e regjionit herë në praktikat e Evropës e herë në praktikat globale. Kështu që ne duam ta bëjmë një praktikë të veçantë, që asnjëherë kur ka raporte të mos qëndrojnë deputetët në sallë e t’i lëmë për të votuar pastaj javën tjetër... Si të doni!... Por, kemi edhe një votim dikur më vonë, që është votim i fshehtë dhe do të ishte mirë të jenë deputetët, të mos e shtyjmë për javën tjetër.

Pika e shtatë e rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për masat mbrojtëse në importe

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka mbikëqyrrur zbatimin e Ligjit nr. 04/L-047 për masat mbrojtëse në importe dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputetin Pajaziti për arsyetimin e raportit me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri në agjendën e vet e ka pasur edhe mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për masat mbrojtëse të importit. Anëtarët e Komisionit kanë zhvilluar të gjitha aktivitetet e parapara me rregullore për t’i takuar, ftuar dhe vizituar të gjitha institucionet, të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji.

Unë këtu i falënderoj të gjithë deputetët anëtarë të komisionit dhe, po ashtu, institucionet që i janë përgjigjur ftesës së Komisionit për monitorimin e zbatimit të këtij ligji.

Më lejoni, që të ju kumtoj që Komisioni rekomandon të miratohen një varg rekomandimesh dhe unë po e shfrytëzoj rastin këtu që t'i lexoj këto rekomandime dhe pastaj ju ftoj që këto të votohen dhe të miratohen edhe nga grupet politike.

Qeveria të përfshijë në plotësim-ndryshimin e strategjisë legislative për vitin 2013 plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për masat mbrojtëse në importe. Rekomandimet që plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit në veçanti të fokusohet në:

- Mundësinë e aplikimit të masës mbrojtëse në formën e kuotës dhe
- Shqyrtimin e kufizimit 25% për një prodhues, apo 50% për një grup prodhuesish, prodhimit të përgjithshëm të produkteve të ngjashme apo identike,
- Përfshirjen e mekanizmave shtesë për kërkesat e ruajtjes së informatave konfidenciale dhe
- Harmonizimin e afateve kohore për masat e përkohshme mbrojtëse me rregullat e OBT-së dhe BE-së.

Pastaj, rekomandim tjetër:

- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë të veprojë në pajtim me nenin 7 të Ligjit për masat mbrojtëse në importe, duke iniciuar hetim pa pasur kërkesë me shkrim nga ose në emër të prodhuesit vendor.

Qeveria dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë të përkrahë me veprime konkrete Departamentin e Tregtisë në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe administrative dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë duhet t'i raportojë Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për nivelin e zbatimit të ligjit, së paku njëherë në vit.

Këto janë rekomandimet të cilat i ka paraparë Komisioni. Kërkoj që të aprovohen nga Kuvendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Qeverisë nuk është i interesuar ta marrë fjalën. Përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje kolegë deputetë,

Përshëndetje për të gjithë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka marrë pjesë direkt në grupin punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për masat mbrojtëse në importe përmes deputetëve tanë në Komisionin funksional përkatës.

Rekomandimet që kanë dalë nga mbikëqyrja e ligjit, veçse u tha më parë nga kryetari i komisionit dhe ne si grup parlamentar i mbështesim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, me seriozitet ka përcjell zbatimin e Ligjit për masat mbrojtëse, vendimet e Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë të bazuara në këtë ligj si dhe në efektin që kanë sjell vendimet e këtilla.

Po ashtu, Grupi Parlamentar i LDK-së ka pasur parasysh edhe raportin e Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri. Madje, pajtohem me shumë gjëra që janë konstatuar nga Komisioni Parlamentar.

Njëkohësisht, Grupi Parlamentar i LDK-së ka pasur kontakte të shpeshta me përfaqësues të biznesit, si me ata të prekur nga ky ligj, përkatësisht vendimit të MTI-së, po ashtu edhe me ata që kanë nevojë për mbrojtje, por që vështirë mund të kualifikohen për shkak të kriterëve tejet të ashpra që parasheh ky ligj.

Dhe, kur kemi parasysh tërë këto aktivitete, atëherë del si nevojë e ngutshme plotësimi dhe ndryshimi i këtij ligji, jo vetëm për shkak të nevojave që ka tregu i brendshëm, por se ai në shumë pika nuk përputhet me rregullore dhe standarde të Organizatës Botërore të Tregtisë dhe të Bashkimit Evropian. Do të ishte mirë që ndryshimet të ndodhin sa më parë, e jo që ky ligj apo edhe ligjet tjera, nëse bëhen pengesë për anëtarësim në këtë asociacion.

Grupi Parlamentar i LDK-së, po ashtu ka konstatuar se disa zgjidhje e që parasheh ligji nuk ndihmojnë aq shumë në mbrojtjen e tregut dhe të prodhuesve vendorë. Së pari kemi parasysh se masat mbrojtëse bëhen në formë të tarifës e jo të kuotës. Kjo e dyta është zgjidhje më e mirë, meqenëse merr parasysh kapacitetet prodhuese të brendshme dhe nevojat e tregut.

Gjendja rregullohet shumë më mirë me kuotë se sa me tarifa, përkatësisht me një taksë shtesë, e cila mund të reflektojë në çmimin e fundit të mallit. E dyta, norma për 25% për një prodhues apo 50% për një grup prodhuesish të një produkti të ngjashëm është shumë e lartë. Kjo del nga fakti se normat e këtilla pamundësojnë prodhuesit që nuk e arrijnë këtë përqindje, por që në fakt kanë nevojë për mbrojtje.

Për këtë arsye, Grupi Parlamentar i LDK-së kërkon që kjo normë të hiqet krejtësisht, ndërsa në mekanizmat përbrenda MTI-së që trajtojnë çdo kërkesë që vjen nga prodhuesit dhe të vendosin në bazë të arsyeshmërisë dhe faktet e siguruara.

Po ashtu, kufizimet e këtilla janë në kundërshtim me rregullat e Organizatës Botërore të Tregtisë dhe të Bashkimit Evropian. Njëkohësisht, duhet ndryshuar afatin kohor për

aplikimin e masave të përkohshme mbrojtëse nga 90 ditë në 200 ditë. Kjo duhet të bëhet për dy arsye:

E para, sepse brenda 90 ditësh është vështirë të vërehen efektet e masave të aplikuara dhe është afat shumë i shkurtër për përshtatje;

E dyta, meqenëse afate të këtilla kohore kanë Organizata Botërore e Tregtisë dhe Bashkimi Evropian.

Grupi Parlamentar i LDK-së po ashtu, vlerëson se MTI-ja nuk ka kapacitete të mjaftueshme për zbatimin e këtij ligji. Madje, në disa raste nuk është edhe aq shumë e qartë se cili Departament apo drejtori e saj të merret me çështje të caktuara. Kur e themi këtë kemi parasysh faktin se nuk dihet saktësisht, se cila drejtori apo divizion i MTI-së merret saktësisht me hetimet, ndërprerjen dhe përfundimin e hetimeve apo me shqyrtimin e dënimeve.

Sa është e vërtetë kjo situatë në MTI, e vërteton rasti i aplikimit të masave mbrojtëse për çimento, përkatësisht për taksën për 35% të importit të saj. Së pari një masë e tillë më shumë ka destabilizuar tregun, se sa që ka dhënë ndonjë efekt mbrojtës, ka rrezikuar furnizimin e rregullt të tregut si dhe shtrenjtimin e këtij artikulli.

Prandaj, me plot arsye edhe një herë konstatojmë se MTI-ja kur ka marrë këtë vendim, nuk i ka respektuar procedurat që kërkon ligji. Nuk ka pasur konsultime para inicimit e hartimit kur është marrë vendimi për inicimin e hetimit nuk janë informuar palët e interesuara, nuk janë dërguar pyetësorët e as që është dhënë afati prej 30 ditësh për përgjigje dhe nuk është konstatuar dëmi serioz ose kërcënimi nga ky dëm, ashtu siç kërkohet me ligj.

Rasti i masave mbrojtëse për importin e çimentos, por njëkohësisht edhe të metat tjera që ka konstatuar Grupi Parlamentar i LDK-së të theksuara në fillim, imponojnë nevojën që ky ligj të merret me shqyrtim më serioz, përkatësisht të bëhet ndryshimi i tij, në mënyrë që të jetë më efikas, më lehtë i zbatueshëm dhe në përputhje me rregullat e standardet e Organizatës Botërore të Tregtisë dhe të Bashkimit Evropian.

Me gjithë të gjitha këto vërejtje që i ka, Grupi Parlamentar i LDK-së për këtë raport, prapëseprapë do ta përkrahë me mendim që MTI-a do ta respektojë mendimin e Komisionit me rekomandimet që i kemi dhënë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Gjatë monitorimit të zbatimit të këtij ligji, veçanërisht në diskutimin që e kemi pasur me ministren për Tregti dhe Industri, ka thënë diçka interesant, mendoj unë.

Në njërën anë e ka arsyetuar ligjin dhe mënyrën se si është përpiluar ky ligj edhe me rregullat ndërkombëtare të tregtisë, pra ka thënë që nuk jemi munduar deri në një masë të

mos i shkelim rregullat ndërkombëtare të Organizatës Botërore të Tregtisë e kështu me radhë dhe në anën tjetër ka thënë që po ashtu, ligji i është përshtatur rrethanave të vendit. Pra, në disa raste i kemi marrë parasysh rrethanat e vendit, natyrisht me synimin, siç thoshte ajo, për t'i shërbyer ekonomisë së vendit. Ndërkohë, që pastaj arsyet e moszbatimit të ligjit deri në njëfarë mase i arsyetonte edhe me atë, ose mos marrjen e masave më mirë të them, për rastet e caktuara, të cilat u ngritën si çështje nga deputetët, që janë të rëndësishme për mbrojtjen e prodhimit vendor, tha që nuk na lejon ligji, që në njëfarë mënyre i ra që në fakt ligji nuk i paska marrë fare parasysh rrethanat e vendit. Pra, nuk paska qenë në përputhje me rrethanat e vendit, se po të ishte bërë për Kosovën, atëherë do t'ia kishte mundur Qeverisë apo në këtë rast Ministrisë së Tregtisë, për të marrë masa për ta mbrojtur ekonominë e vendit.

Pra, deri tash ne e dimë që ky ligj është zbatuar vetëm në rastin që më së shumti ka bërë bujë, është zbatuar në rastin e bllokimit të çimentos dhe në asnjë rast tjetër, kur ka shumë kërkesa dhe arsyetime të ndryshme, për ta zbatuar edhe në fushat tjera, në industritë tjera, që i ka Kosova ose që mund t'i zhvillojë Kosova.

Por, natyrisht që ky ligj edhe në zanafillën dhe qëllimin e tij, kurrë nuk i ka pasur që ta mbrojë ekonominë e vendit, por vetëm të shërbejë si njëloj mekanizmi përmes të cilit Qeveria nuk e lejon situatën të bëhet më keq se sa që është. Pra, po ta lexosh ligjin me vëmendje dhe mënyra se si zbatohet ai, ky është qëllimi kryesor i tij. Pra, jo ta përmirësojë prodhimin industrial në Kosovë dhe ta rrisë atë, por ta mirëmbajë në gjendjen në të cilën është.

Për shembull, nëse ka rrezik që një kompani të bëhet edhe më keq se sa që është, sepse nuk po i mbrohet tregu, atëherë intervenon Qeveria, për ta mbajtur gjendjen aty ku është. Dhe, kjo nuk është politikë e zhvillimit ekonomik, kjo është politikë e stagnimit ekonomik, pra të mbesim këtu ku jemi.

Dhe në këtë drejtim, ne konsiderojmë që Kosovës i nevojitet një ligj i cili është shumë më efikas edhe një politikë, më mirë të them, që e mbron prodhimin e vendit dhe i zëvendëson importet e shumta, që i ka Kosova, në ndërkohë që kjo politika e Qeverisë së Kosovës për ta lënë, në rastin më të mirë po them, vendin në gjendjen në të cilën është, është politikë e cila po e shkatërron ekonominë e Kosovës.

Dhe në këtë drejtim, konsiderojmë që as ky ligj për masat mbrojtëse dhe as rishikimi i tij, që do të bëhet sipas rekomandimeve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, nuk do ta përmirësojë kushedi sa gjendjen në Kosovë, por jemi për këto rekomandime, për shkak se konsiderojmë, që këto rekomandime megjithatë e bëjnë ligjin më të zbatueshëm dhe e bëjnë ligjin më të përdorshëm për çështje të caktuara, edhe pse ky ndryshim apo rishikim i ligjit do të jetë i sponsorizuar nga Qeveria dhe natyrisht që duhet ta shohim edhe se në çfarë mënyre po e ndryshon ligjin Qeveria dhe çfarë qëllimi ka Qeveria përmes këtij ligji.

Por, për sa i përket rekomandimeve, ne konsiderojmë që duhet të votohen, sepse janë një obligim i mirë për Qeverinë që të fillojë të mendojë për prodhimin vendor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën zoti Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do t'i përkrahë rekomandimet që ka dhënë Komisioni për Zhvillim Ekonomik dhe përgëzon punën që ka bërë si Komision dhe këto rekomandime. Është mirë që këto rekomandime po jepen para se të ndryshojë ky projektligj dhe nëse merren parasysh këto rekomandime dhe disa vërejtje që u dhanë nga deputetët, shpresoj që në të ardhmen ky projektligj do të jetë më efikas dhe i zbatueshëm në praktikë, për nevojat e Kosovës dhe do të mbrojë produktet vendore që është qëllimi i gjithë deputetëve e posaçërisht deputetëve të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

Prandaj, në parim do t'i përkrahim këto rekomandime që i ka dhënë Komisioni i Zhvillimit Ekonomik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Duke marrë parasysh se komisionet parlamentare kanë të drejtën edhe në bazë të Rregullores së punës, që është obligim i tyre që të bëjnë edhe monitorimin e ligjeve dhe draftimin e ligjeve, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, kësaj radhe ka pas marrë Ligjin për masat mbrojtëse në import, që ta monitorojë për arsye se të shohim në gjendjen reale faktike, si është zbatuar ky ligj dhe sa ka pasur mundësi të zbatohet ky ligj.

Në rast se shohim rekomandimet e Komisionit dhe punën e Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjit, mund të themi se Komisioni duhet të ketë lëvdata, për arsye se ka bërë një punë mjaft të mirë gjatë monitorimit të Ligjit për masat mbrojtëse të importit. Rekomandimet të cilat janë nxjerrë në mënyrë të përbashkët nga gjithë Komisioni Parlamentar, jepet të kuptohet se Ligji për masat mbrojtëse në import duhet të ndryshojë, për arsye se ekonomia e Kosovës nuk është edhe aq e zhvilluar e njëkohësisht bizneset kosovare nuk janë edhe aq të mbrojtura me ligjet të cilat i kemi miratuar brenda Kuvendit të Kosovës, po nga ky Kuvend.

Rekomandimet, të cilat i ka nxjerrë Komisioni Parlamentar shihet mjaft mirë, se kërkohet nga Qeveria, që të bëhet plotësim-ndryshimi i Ligjit për masat mbrojtëse.

Mundësia e aplikimit të mbrojtjes në formë të kuotës, nuk e di kjo sa do të jep mundësinë Qeverisë që në bazë të kuotës të ketë mundësinë e aplikimit të masave mbrojtëse.

Shqyrtimi i kufizimit nga 25% për një prodhues apo 50% për një grup prodhuesish, këtë e kemi diskutuar edhe gjatë Komisionit dhe besoj, që edhe ministrja pasi t'i marrë rekomandimet dhe në komision ka deklaruar që do të jetë mundësia e juaj dhe e imja që të bëjmë plotësim-ndryshimin e ligjit.

Përfshirja e mekanizmit shtesë për kërkesat e ruajtjes së informatave konfidenciale, këtu duhet të themi, se duhet të ketë staf profesional në Departamentin për masat mbrojtëse dhe nuk e di se a është ai Departament i formuar aq mirë, që të ketë mundësinë që të ruajë këto materiale konfidenciale.

Harmonizimi i afateve kohore, për masat e përkohshme mbrojtëse me rregullativat e OBT-së dhe të BE-së, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë të veprojnë në pajtim me nenin 7 të Ligjit për masat mbrojtëse të importit, duke iniciuar hetime, pa pasur kërkesë me shkrim ose në emër të prodhuesit vendor.

Ministria duhet në këtë pikë duhet të themi se Ministria duhet të marrë vendimet për masat mbrojtëse atëherë kur iniciohen hetimet, në bazë të tregut. Më së miri tregu e përcakton çështjen se cili biznes po dëmtohet, cili prodhues vendor po dëmtohet dhe Qeveria dhe Ministria e Tregtisë të përkrahë me vendime konkrete Departamentin e tregtisë, që unë e thash këtu pak më parë, në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe administrative dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë duhet t'i raportojë Komisionit për Zhvillim Ekonomik për nivelin e zbatimit të ligjit së paku një herë në vit.

Nuk është çështja që së paku një herë në vit, por në esencë mund të themi se Qeveria është e obliguar të zbatojë ligjin çdo ditë, ndërsa ne si deputetë kemi të drejtë ndoshta çdo dy javë t'i thërrasim Qeverinë dhe të na tregojë edhe në Kuvend se si është çështja e zbatueshmërisë së ligjeve.

Në përgjithësi Koalicioni për Kosovë të Re përkrahë rekomandimet e Komisionit Parlamentar dhe uron që komisioni të marrë në monitorim edhe shumë ligje të tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Votimi shtyhet kur të ketë mjaft deputetë për të votuar. Vazhdojmë me pikën e tetë:

8. Shqyrtimi i raportit vjetor të performansës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012

Për të raportuar lidhur me këtë raport ftoj zotin Sadriu, për ta arsyetuar raportin.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përshëndetje për ju kolegë deputetë,

Sipas Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditorit të Kosovës, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm GZAP mund t'i dorëzojë Kuvendit të Republikës së Kosovës deklaratë financiare, të certifikuar nga auditorët e jashtëm dhe një raport mbi veprimtarinë e saj gjatë vitit.

Auditimi i pasqyrave financiare të GZAP-it bëhet nga auditorët e jashtëm, të cilët zgjedhen dhe emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, gjegjësisht nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, në bazë të përfundimit të Kryesisë së Kuvendit dhe bashkërendimit me administratën e Kuvendit, siç është Drejtoria e Prokurimit ka bërë

përzgjedhjen e kompanisë BDU për auditimin e pasqyrave financiare të GZAP-it për vitin 2012.

Sipas raportit të GZAP-it në sezonin e auditimit të periudhës 2011-2012 janë kryer gjithsej 101 auditime, prej tyre Zyra e GZAP-it ka audituar 83 njësi, ndërsa 18 sish i ka kontraktuar me operatorë të ndryshëm.

Krahasuar me opinionin e dhënë nga viti i kaluar, këtë vit ka progres në këtë fushë, ku nga 15 opinione të pakualifikuara në vitin e kaluar, këtë vit kemi 35 sish pra, shihet që është rritur, si dhe nga tri opinione të kundërta në vitin e kaluar, këtë vit nuk kemi fare, kurse, nga 9 opinione që viti i kaluar i karakterizonte si mohim opinionit, këtë vit i kemi vetëm 3 dhe ajo ka të bëjë me tri komunat në veri.

Gjatë auditimit janë dhënë 590 rekomandime, prej tyre 366 për nivelin qendror, ndërsa për nivelin lokal 224 , prej tyre ishin adresuar plotësisht 185, apo vetëm 31%, të adresuara pjesërisht janë 208 sosh apo në përqindje 35%, ndërsa pa adresuar 34, dukuri kjo mjaft shqetësuese me rastin e mos adresimit të rekomandimeve nga ana e organizatave buxhetore.

GZAP ka paraqitur shpenzimet për kode ekonomike, si shpenzime të udhëtimit, shpenzime për trajnime, shpenzime për auditimet e kontraktuara, mirëmbajtjen e objektit, sigurimin e veturave dhe pothuajse përqindja më e madhe nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve i dedikohet pozicionit të qerasë, dukuri kjo që reflekton edhe nëpër institucionet tjera, për të cilën kemi diskutuar në rastet tjera.

Po ashtu, GZAP në raport ka paraqitur edhe çështjen e burimeve njerëzore, ka të punësuar 142 punëtorë, për vitin 2012 ka rekrutuar 28, i ka prej tyre për pjesën e stafit administrativ, ndërsa 114 janë auditorë të kualifikuar.

Gjatë vitit 2012, GZAP ka rekrutuar 18 pozita, prej tyre 8 i ka pasur në zëvendësim nga pushimet e ndryshme të personelit që ka.

Numri i auditorëve të certifikuar si auditorë është 25, një rritje të një pozite krahasuar me vitin e kaluar, 29 të certifikuar, 28 teknikë kontabiliteti, 14 për trajnim, 8 auditorë të performansës dhe një auditor të brendshëm.

Sipas raportit të dorëzuar nga kompania BDO Kosova për GZAP janë adresuar disa të gjetura. GZAP në raste nuk e ka caktuar një person adekuat për menaxhimin e kontratave.

Megjithatë kontratat janë nënshkruar nga persona tjetër, pra që nuk kanë qenë të caktuar.

Mbledhjet me procedurë të kuotimit për furnizim identik, rasti i marrjes me qira të aparatit të fotokopjimit me afat prej 10 muajve, ndërsa kontrata kishte qenë në 12 muaj.

Pra, kemi tejkalim shkurtim të afatit. Harmonizimi i regjistrimit të aseteve mbi 1000 euro në mes modulit të regjistrimit të pasurisë dhe simfake regjistrimi i katër kamerave, vlera

totale, e cila është 4 mijë e 83 euro, gabime në kuotizimin e aseteve dhe zbatimi i normave të zhvlerësimit dhe amortizimit, rasti ka të bëjë me softuerin për auditim ku ish caktuar periudha zhvlerësuese 7 vjet, ndërsa sipas udhëzimit administrativ nga Ministria e Financave, në vitin 2009 ajo do të duhet të ishte 10.

Po ashtu në disa raste të tjera jetëgjatësia e përcaktuar në regjistra ka dallime varësisht prej sistemit, mungesës së nënshkrimeve të formave standarde të raportimit, të pranimit të mallrave dhe shërbimeve, në disa raste mungon nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar tek format standarde.

Në përgjithësi të gjitha rekomandimet e dala nga Kompani audituese në këtë rast BDO “Kosova” për auditimin e pasqyrave financiare ZAP-i për vitin 2012 në një formë apo tjetër nuk kanë konstatuar shkelje materiale, por kryesisht ka të bëjë me shkelje të procedurave.

Sipas vlerësimit të Komisionit për raportim i ZAP-it është bërë me kohë dhe sipas afateve ligjore. Mbulimi i auditimit po përmirësohet dukshëm, ka një ngritje të numrit të auditimeve të kryera vitin e fundit.

Me kalimin e kohës është reduktuar numri i auditimeve të kontraktuara që ishte në një kuotë shumë të lartë në vitet e më hershme.

Shqetësuese për Komisionin mbetet auditimi i performansës edhe pse ZAP-i ka paralajmëruar se do të ketë numër më të madh të performansës, ai realisht ka dorëzuar numër shumë të vogël dhe disa prej tyre nuk i ka publikuar fare për shkak të kualitetit të dobët të tyre. Kemi premtime që kjo situatë do të mbulohet më mirë në veçanti pas binjaktivizimit të Zyrës së Auditorit Gjeneral me disa institucione simotra, por shpresojmë që kjo dukuri këtë vit ta paraqesë në një numër të planifikuar i ka 8.

Me ligj, ZAP dorëzon raportin e punës me pasqyra audituese financiare, por auditimi i pasqyrave financiare nuk jep një pasqyrë të saktë për punën e këtij institucioni.

Kuvendi në vazhdimësi e ka përkrahur fuqizimin e këtij institucioni. prandaj me qëllim që Kuvendi të ketë një pasqyrë të qartë për gjendjen në këtë institucion dhe me qëllim të përkrahjes së më tutjeshme, Komisioni ka rekomanduar që të miratohet Raporti vjetor i performansës së ZAP-it, por njëkohësisht ka rekomanduar të bëjë një auditim të performansës për ZAP-in për vitin 2012-2013. Faleminderit!

KRYESUESI: Fillojmë në emër të grupeve. Zonja Dibra e ka fjalën.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Raportin të cilin po e shqyrtojmë sot është më shumë raport vjetor i punës së Zyrës së Auditorit Gjeneral për vitin 2012 që gjithashtu këtij raporti i është bashkangjitur edhe raporti i auditorit, pra auditimi i pasqyrave vjetore financiare të kësaj zyre për vitin 2012.

Gjatë vitit 2012 kjo zyra ka kryer afro 100 auditime ku prej tyre 87 auditime të rregullsisë, 2 auditime të performansës, 8 auditime menaxheriale, 3 auditime të Fondit të Donatorëve. Nga këto 87 auditime të rregullsisë janë dhënë 35 opinione pakualifikuara, 32 opinione të pakualifikuara me theksim të çështjes, 4 opinione të kualifikuara, 3 mohim i opinionit dhe asnjë opinion i kundërt.

Krahasuar me vitin 2011 në vitin 2012 kemi progres në dhënien e opinioneve. Këto opinione të dhëna nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për rregullsinë e parasë publike vërtetojnë se organizatat buxhetore e kanë shpenzuar paratë publike në përputhshmëri me ligjin.

Shqetësuese është fakti se numri i auditimeve të performansës është shumë i ulët, pavarësisht kërkesës së vazhdueshme të Komisionit për ngritjen e auditimeve të performansës.

Mendoj që zyra ka staf të mjaftueshëm për kryerjen e këtyre auditimeve, mirëpo duhet ditur të bëhet mirë ristrukturimi i stafit brenda zyrës.

Shqetësimi im në vazhdimësi ka qenë se mungesa e auditimeve të performansës është pikërisht mos vullnet i autoritarit gjeneral për një ristrukturim të stafit në bazë të meritave dhe përvojës adekuate të auditorëve. Sikur kjo të ndodhte do të realizohej plani të cilin vazhdimisht Zyra e Auditorit e bën, por asnjëherë nuk mund ta realizojë në kontekst të realizimit të auditimeve të performansës.

Po ashtu e ceka edhe në fillim që raportit vjetor i janë bashkangjitur edhe pasqyrat vjetore të audituara, mirëpo ky raport nuk jep një pasqyrë të saktë për punën e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Shqetësimet kanë qenë të shumta rreth rekrutimit dhe ristrukturimit të stafit brenda Zyrës së Auditorit. Për këtë fakt auditori nuk ka dhënë asnjë koment edhe pse auditori i pavarur i ka parë këto procese gjatë auditimit, mirëpo nuk e dimë ku ka qenë arsyeja, ata janë thirrur në mungesë të fushëveprimit, pse nuk ka shkruar asnjë koment rreth strukturimit, rekrutimit të stafit.

Për këtë arsye Komisioni ia ka dhënë një rekomandimit Kuvendit të Republikës së Kosovës që të angazhojë një kompani audituese private që të bëjë auditimin e performansës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012 dhe 2013.

Dhe ne si Grup Parlamentar e përkrahim këtë rekomandim të Komisionit dhe gjithashtu rekomandimin për ta aprovuar raportin e punës.

Po ashtu, gjatë analizës së raportit shihet se Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka funksionuar si duhet, kështu të paktën është paraqitur në raportin vjetor dhe nuk është dhënë asnjë sqarim pse nuk është bërë ndonjë auditim eventual apo nëse është bërë cili është bërë për cilin sektor.

Pra, kjo është një përmbledhje e ceku edhe kryetari i Komisionit më në detale rreth punës dhe aktivitetit të Zyrës së Auditorit Gjeneral, prandaj ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrahim raportin me rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i LDK-së, Imri Ahmeti e ka fjalën.

IMRI AHMETI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Kolegë deputetë,

Raporti i performansës të Zyrës së Auditorit për vitin 2012, padyshim paraqet gjithanshëm punën e këtij institucioni dhe veçanërisht është i detajuar në çështjet e auditimeve të kryera.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm nga viti në vit ka arritur të ngritë mbulushmërinë e auditimeve dhe shifrat e dhëna në këtë raport krahasuar me sezonin e kaluar gjithsesi janë pozitive dhe duhet vlerësuar pozitivisht.

Zyra e Auditorit ka shtuar dukshëm kapacitet njerëzore dhe ka bërë angazhime për zhvillimin e tyre profesional.

Në këtë drejtim janë angazhuar dhe në shumë projekte të tjera të jashtme dhe vërehet një bashkëpunim i mirë i Zyrës me partnerë të tjerë.

Megjithatë siç u tha edhe nga parafolësit mendoj se cilësia përmbajtësore e auditimeve duhet shtuar në mënyrë që ndikimi i tyre të jetë më efektiv në menaxhimin e financave publike nga organizatat buxhetore të audituara.

Në fakt është shumë relevant fakti se janë shtuar opinionet e pakualifikuara të auditorit nga viti në vit, mirëpo nëse e bëjmë një krahasim me raportet e viteve të kaluara vërehet se po thuaja janë të njëjta probleme dhe rekomandime të përsëritura.

Standardet në bazë të cilave jepet opinionit janë të njëjta si në vitet paraprake dhe gjithashtu janë të njëjta edhe për kompanitë kontraktuese ku qasja e tyre për dhënien e opinionit krahasuar me Zyrën e Auditorit, janë krejtësisht ndryshe.

Edhe pse Zyra e Auditorit i ka shtuar burimet njerëzore dhe kapacitetet financiare, numri i auditimeve të kontraktuara konsiderojmë se mbetet ende shumë i lartë.

Pothuaj në çdo rast është përmendur se auditimet e performansës duhet shtuar dhe këtë besoj tani më edhe Zyra e Auditorit e ka përmendur edhe vetë që ka nevojë të shtohet numri i këtyre auditimeve.

Në raport janë dhënë informacione për shpenzimet buxhetore dhe disa informata për rekrutimin e personelit, përkatësisht të dhëna të ndryshme statistikore për ta, mirëpo në raport nuk janë prezantuar informata për ushtrimin e brendshëm të disa veprimtarive

administrative dhe zbatimin e legjislacionit në fusha të caktuara si për marrëdhënien reale të punës, organizimin përkatësisht rristurimin e brendshëm të tij.

Auditimi i pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit është bërë nga një kompani e kontraktuar nga Kuvendi. Konsideroj se detyra që iu ka dhënë kësaj kompania nuk ishte e plotë. Përveç shënimeve për pasqyrat financiare nuk kemi informata të tjera për çështjet administrative organizative dhe funksionale të Zyrës së Auditorit. Prandaj, zyrtarët përgjegjës të Kuvendit të cilët e iniciojnë dhe e procedojnë procedurën e auditimit të Zyrës së Auditorit, duhet të kenë kujdes dhe të projektojnë detyrën për auditim të jashtëm të këtij institucioni me kërkesa më të specifikuar.

Përgjithësisht këtë raport edhe grupi ynë parlamentar e mbështet dhe do ta aprovoj për. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes”, zoti Hoti e ka fjalën.

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryesues!

Raporti vjetor i performansës së Auditorit të Përgjithshëm para së gjithash duke qenë se kemi të bëjmë me një raportim të rregullt periodik që është i përcaktuar sipas mandatit ligjor, këtij raportit do t’i duhej t’i bëhen disa vlerësime në aspektin formal.

Në përgjithësi ky raport përmban një pjesë përshkuese të gjendjes faktike për të cilën do të duhet të trajtojë se sa është reale e sa jo kritika në aspektin formal edhe shpenzimi i hapësirës me materiale të panevojshme, si fotografi dhe vizatime të dizajnuara.

Nuk mund të mohojë askush efektin vizuel lidhur me çfarëdo punimi përshkues për një raport kaq serioz e sidomos kur ky raport paraqitet nga një autoritet siç është Auditori i Përgjithshëm, mendoj se kemi parasysh një rregullsi po thuajse prefektë.

Gjithashtu kritika të cilën dua të drejtoj është se shtypja e këtij raportit në format të tillë dhe me materiale aq të shtrenjta më duket e paarsyeshme e aq më tepër kur ky shpenzim krijohet nga Auditori i Përgjithshëm, i cili do të duhej më së mirë të jetë shembull i ekonomizimit të shpenzimeve reprezentative.

Në faqen 7 të raportit kuptohet në pjesën e gjuhës shqipe, në pjesën tekstuale të emëruar si Qeverisja e përbashkët dhe modernizimi është theksuar se ka filluar të zbatohet strategjia dalëse e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, ku është theksuar objektiviteti lidhur me ngritjen profesionale të stafit që është e kuptueshme, por është për t’u brengosur se në asnjë pjesë të këtij raportit nuk janë theksuar problemet adekuate me stafin, gjë që kishte për të lënë hapësirë dhe bazueshmëri për vetë Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm lidhur me kufizimet buxhetore me të cilat po ballafaqohet, e gjithashtu edhe shpenzimet shtesë që duhet t’i krijojë për shkak të mungesës së stafit.

Në pikën 2.1, nën pjesën e treguesve të rezultatit përkitazi me mbulimin e auditimit dhe duke e parë se mbulueshmëria është rritur dukshëm që nga viti 2012 ku edhe vetë keni përshkruar se kemi audituar 100% të hyrave dhe 99% të ardhurave, rezultatet e zbatimit

të rekomandimeve tuaja, shihen se nuk merren në konsideratë nga organizatat buxhetore. Pra, në vend se të rritet rregullsia krahas me rritjen e auditimeve, ne e kemi të kundërtën, sa më shumë auditime aq më tepër po dalin në pah parregullsitë e organizatave buxhetore lidhur me shpenzimet e shkaktuara në to.

Është për t'u vlerësuar që Zyra e Auditorit e ka rritur numrin e auditimeve të kryera përgjatë vitit 2012/2013 ku janë kryer 113 auditime e gjithashtu ku janë angazhuar 11 auditime të kontraktuara private.

Në tabelën 2, është e pa llogaritur një shumë që këto auditime prej 60 mijë euro, përderisa për vitin e kaluar janë audituar 18 komuna në vlerë prej 90 mijë eurove.

Përse në fusnotën e çmimit të auditimeve të kontraktuara për vitin 2012/2013 është thënë se kjo është shumë e përlogaritur nga se procedurat e prokurimit nuk janë finalizuar, çka nënkupton kjo se ende nuk është përmbyllur procesi i prokurimit ku do të dihet saktë çmimi i auditorëve të kontraktuara.

Në tabelën 3, të raportit është theksuar se nga 89 opinione në vitin 2011 janë 35 opinione të pakualifikuara, ndërsa në vitin 2010 vetëm 15 sosh.

Pyetja është pse është kaq dallimi i madh brenda një viti, ky dallim konsiston për periudha të njëjta edhe lidhur me opinionet e kualifikuara?

Kur jemi tek buxheti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, vlen të theksohet se në përshkrimin e shpenzimeve të buxhetit shohin se relativisht më së paku është shpenzuar për mjetet mallra dhe shërbime për dy vjetët në vitin 2012 90.1%, në vitin 2011, 88.7%. Duke parë se këto shpenzime nuk janë duke u shpenzuar tërësisht a nuk kishte me qenë kërkesë më reale dhe e arsyeshme e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm që të ulen të ardhurat në mallra dhe shërbime duke i rritur mjetet financiare për paga dhe mëditje me qëllim të ngritjes së burimeve njerëzore, ngase vetëm sipas shpenzimeve nga totali i shpenzimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm janë 31% nga mallrat dhe shërbimet.

Edhe ne si Grup i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta votojmë me të gjitha të gjeturat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i AAK-së, zoti Muharremaj e ka fjalën.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka shqyrtuar Raportin e performansës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, të cilit i janë bashkangjitur edhe pasqyrat vjetore financiare të cilat janë audituar nga kompania audituese e përzgjedhur.

Sipas raportit të ZAP-it në sezonin e auditimit 2011/2012 janë kryer 101 auditime, prej tyre të kontraktuara nga puna e ZAP-it ishin me operatorë të ndryshëm ekonomikë, 18 shosh, apo rreth 20% të tyre.

Një raport i auditimit të Buxhetit të Kosovës, 87 auditime të rregullsisë, 2 auditime të performansës, 8 auditime menaxheriale dhe 3 auditime të Fondit të donatorëve.

Krahasuar vitin 2011 me vitin 2012, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka arritur të shtojë numrin e auditimeve për 12 sosh.

Gjatë sezonit të auditimit 2011/2012 opinionet e dala nga këto auditime janë 35 opinione të pakualifikuara, 32 opinione të pakualifikuara me theksim të çështjes, 15 opinione të kualifikuara, 4 opinione të kualifikuara me theksim të çështjes, zero opinion të kundërta dhe 3 mohime të opinionit.

Krahasuar me opinionet e dhëna nga viti i kaluar këtë vit kemi progres në këtë fushë, ku nga 15 opinione të pakualifikuara në vitin e kaluar, këtë vit kemi 35 si dhe nga 3 opinione të kundërta, këtë vit nuk kemi fare këtë opinion.

Gjithashtu 9 opinione nga viti i kaluar si mohim i opinionit, ndërsa këtë vit kemi vetëm tri.

Po ashtu gjatë auditimeve janë dhënë 590 rekomandime, prej tyre 366 për nivelin qendror, ndërsa 224 për nivelin lokal.

Prej tyre ishin adresuar plotësisht 185 apo 31% të adresuara pjesërisht 208 sosh apo 35%, ndërsa të paadresuara 34% prej tyre, dukuri kjo mjaft shqetësuese me rastin e mosadresimit të rekomandimeve nga organizatat buxhetore.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike i Kuvendit të Republikës së Kosovës së bashku me Zyrën e Prokurimit të Kuvendit ka bërë përzgjedhjen e Kompanisë BDO “Kosova” për të bërë auditimin e pasqyrave vjetore financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012.

Sipas raportit të dorëzuar nga Kompania BDO “Kosova” për zyrat e Auditorit të Përgjithshëm janë adresuar disa të gjetura, menaxhimi i kontratave blerjet me procedurë të kuotimit për furnizim identike, harmonizimi i regjistrit të aseteve mbi 1000 euro ndërmjet modulit të regjistrimit të pasurive, mungesë e nënshkrimeve në forma standarde të raportit të pranimi të mallrave dhe shërbimeve.

Koment i përgjithshëm. Në përgjithësi të gjitha rekomandimet e dala nga Kompania audituese BDO “Kosova” për auditimin e pasqyrave vjetore financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012, në një formë apo tjetër nuk janë konstatuar shkelje materiale.

Prandaj, duke u bazuar në atë që u tha më lart Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës propozon që të miratohet Raporti vjetor i performansës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm me pasqyrat e audituara financiare për vitin 2012.

Po ashtu ishte edhe rekomandimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike që Kuvendi i Kosovës ta angazhojë një kompani audituese e cila do të bëjë auditimin e performansës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012 dhe 2013 që deri tani një auditim i tillë ka munguar, sepse është bërë vetëm auditimi i pasqyrave vjetore financiare e jo edhe auditimi i performansës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar Koalicioni për Kosovën e Re, e ka fjalën zonja Selmani, kryetare e Grupit.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re ka shqyrtuar Raportin vjetor të performansës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012.

Në rast se e shohim raportin mund të themi se prapëseprapë ka një progres, por ky progres duhet të jetë më i madh për arsye se duhet të dihet saktësisht kah dhe si po shkon buxheti i Republikës së Kosovës.

U fol edhe nga parafolësit cilat janë opinionet e pakualifikuara dhe me theks të çështjes opinion i kualifikuar, mirëpo në efekt prapëseprapë mund të themi se ne duhet si Kuvend të kemi një ristrukturim të stafit të ZAP-it dhe të bëhet një auditim i brendshëm mbasandaj një auditim i jashtëm. Nëse auditimi i brendshëm del negativ atëherë mund të themi se performansa e asaj njësie buxhetore nuk është efikase, efektive dhe ekonomike dhe nuk mund të themi se një auditor i jashtëm mund të bëjë një auditim aq të mirë kur auditimi i brendshëm nuk është i mirë.

Si Grup Parlamentar e përkrahim raportin, mirëpo me theks të veçantë që të kemi kujdes në të ardhmen edhe vetë të ZAP-i dhe çështja e stafit të tyre dhe jo vetëm të bëhet auditimi i pasqyrave, mirëpo të bëhet edhe performansa e cila jep në mënyrë të saktë çështjen efikase të menaxhimit të parasë publike, efektive dhe ekonomike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Radha është e deputetëve, zoti Lladrovci e ka kërkuar fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa dashur t'i përsëris ato që i tha kryetari dhe anëtarët e Komisionit ky raport është pasqyrim real i punës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Ky raport i ngrit edhe të arriturat e ZAP-it, por edhe sfidat me të cilat ballafaqohet ZAP si institucion.

Prej të arriturave mund të theksoj çështjen e sasisë, cilësisë dhe atë të besueshmërisë.

Me sasi mund të them se është evidente se nga një numër i vogël i raporteve të rregullsisë në të kaluarën rreth 24 në vitin 2008, tash ky institucion ka prodhuar rreth 90 raporte të rregullsisë për këtë sezon.

Cilësia e raporteve të pranuar të rregullsisë është mjaft e lartë.

Nëse flasim edhe për raportet e performansës, ZAP-i ka planifikuar të prodhojë rreth 24 raporte të ndryshme jo të rregullsisë, ku hyjnë ato të performansës menaxheriale të sistemit të prokurimit dhe sistemeve tjera të cilat presim t'i pranojmë në periudhën në vijim dhe të gjykojmë cilësinë e tyre.

Në këtë raport shohim se ka edhe rritje të besueshmërisë, sepse ofrojnë informata të besueshme dhe po vërehet edhe komunikim më i mirë me entitetet të cilat po pajtohen gjithnjë e më shumë me rekomandimet dhe po punojnë bashkërisht në evitim të problemeve.

Siç po thotë edhe opozita, pra ZAP po ofron raporte të besueshme, e ato raporte po tregojnë përmirësimin gjeneral të performansës.

Njëra prej sfidave të ngritura është ai i ligjit të ri për ZAP-in, të cilin edhe ne si Komision e kemi evidentuar se ka nevojë dhe do të ndihmonte edhe më tutje në punën e pavarur të këtij institucioni.

Sfidë e fundit mbetet edhe akomodimi i këtij institucioni në zyrat e përshtatshme e cila pos që po ofron hapësirë njëkohësisht do të krijonte edhe kursime buxhetore.

Edhe unë i rekomandoj deputetët që ta votojnë këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të ngre dy çështje apo kërkesa të cilat i ka pasur pothuajse Zyra e Auditorit të Përgjithshëm prej viti në vit dhe njëra prej tyre është çështja që kjo Zyre e cila është shumë e rëndësishme dhe kjo Zyre e cila e auditon buxhetin e Kosovës në përgjithësi si të atij niveli qendror, po ashtu edhe të atij të nivelit lokal dhe njëkohësisht të agjencive të ndryshe, kërkesë e përhershme e tyre ka qenë do të thotë që të sigurohet objekt publik dhe të mos vazhdohet akoma më tutje me objekt privat, për të cilin paguajnë një qira do të thotë në bazë të shumë informatave mbi 100 mijë euro kjo zyre paguan qira do të thotë në vit. Dhe po të llogaritet prej themelimit e deri më tani do të thotë, konsiderohet që është një shumë jashtëzakonisht e madhe që konsiderohet që ndoshta me këto mjete financiare të ndara nga buxheti i Kosovës, ndoshta ka pasur mundësi që të ndërtohet një objekt i ri dhe të krijohet hapësirë më e mirë dhe punë më efikase për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm.

Dhe çështje tjetër të cilën unë do ta ngre u tha edhe nga parafolësit tjerë, kemi të bëjmë me çështjen e 18 auditimeve të cilët janë kontraktuar nga auditorë, nga kompanitë e ndryshme në vlerë prej 60 mijë euro. Do të thotë vitin e kaluar ka qenë një shumë prej 90 mijë euro, ndërsa këtë vit është shuma prej 60 mijë eurove, gjë që konsideroj që më mirë do të ishte që të rritet stafi në këtë zyre, me të vetmin qëllim që kjo zyre është përgjegjëse

edhe me ligj që të bëjë auditimin e të gjitha agjencive dhe parasë publike në përgjithësi dhe të mos shkohet akoma më tutje me kontraktimin e kompanive për të cilën është dhënë edhe vërejtje, sidomos nga disa komuna që më mirë këtë auditim ta bëjë zyra e cila është përgjegjëse dhe përkatëse se sa auditime të kontraktuara që i kushtojnë buxhetit të Qeverisë së Kosovës.

Edhe unë në parim këtë auditim e mbështes dhe do ta aprovoj dhe konsideroj që Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është kah e bën një punë jashtëzakonisht të mirë dhe po ashtu ka një performansë edhe pse është shqetësuese nga Komisioni, por konsideroj që ka një performansë të mirë sa i përket auditimit të përgjithshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Unë përmbledhtazi do të them telegrafikisht atë që kam vërejtur në raportin e Auditorit të Përgjithshëm dhe veçanërisht do të nënvizoj cilësinë e raporteve të rregullsisë, cilësinë e raporteve të performansës, informatat edhe komunikimet janë bërë të besueshme dhe ky institucion ka ngritur performansën dhe gjithë ky raport të krijon besueshmërinë se Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka ngritur cilësinë e punës dhe të shërbimeve dhe këtë ide e përforcojmë nga ky raport që tani e kemi analizuar. Kaq.

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe për këtë nuk ka kuorum për të votuar.

Është pika e nëntë e radhës që duhet ta diskutojmë dhe pastaj është votimi i fshehtë.

9. Shqyrtimi i raportit përfundimtar të Komisionit Hetimor Parlamentar

Komisioni Hetimor Parlamentar, i formuar nga Kuvendi më 28 mars 2013, në pajtim me nenin 77, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 8 të Ligjit për hetimin parlamentar dhe nenin 69, paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit lidhur me faturimin e shpenzimeve të rrymës elektrike për muajin janar 2013, kohën e llogaritjes sipas tarifës së lirë, njësoret digjital dhe masat e ndërmarra lidhur me këtë rast, ka përfunduar punën e vetë dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin përfundimtar me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare.

E ftoj kryetarin e Komisionit Hetimor Parlamentar, deputetin Mustafa për arsyetimin e raportit me rekomandime. Zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Zoti nënkryetar,

Duke pasur parasysh seriozitetin e Qeverisë edhe ministrin përkatës, që do të duhej së paku njëri të jetë, unë kërkoj që kjo pikë sot të mos shqyrtohet, sepse është raport, janë të gjetura, ato që janë të shkruara dhe nuk ka asnjë arsye që së paku njëri prej ministrave, ai i Zhvillimit Ekonomik po edhe ky tjetri që ka qenë para tij, të mos jenë këtu dhe ta dëgjojnë këtë raport. Prandaj, kërkoj që në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së që kjo pikë sot të mos shqyrtohet, por në seancën e radhës.

KRYESUESI: Unë po e kuptoj kërkesën tuaj dhe personalisht jam dakord me atë që po e thoni por për t'iu shmangur ne duhet të kemi kuorum...

(Ndërhyrje)

Po de, por duhet votuar, këtu është problemi. S'kemi kuorum. Sa janë në sallë? Le të vijnë, ftoni me zile.

(Ndërhyrje)

Atëherë, regjia, bini ziles dhe kemi një mocion nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike. Besoj se janë diku, se edhe 2 deputetë na duhen për të votuar mocioni.

Atëherë, kemi një mocion të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës që shqyrtimi i pikës 9 të rendit të ditës së sotëm të shtyhet për seancën e ardhshme me arsyetimin që ministrat nuk janë këtu dhe debati duhet të zhvillohet në këto raporte.

Unë mocionin e hedh në votim ose nëse grupet parlamentare dëshirojnë të deklarohen lidhur me mocionin. Po në emër të grupit s'e ke as kryetarin as nënkryetarin dhe nuk është mirë kështu.

Në rregull, në qoftë se ke autorizim për të folur në emër të grupit fjalën e ke dhe merre fjalën. Zoti Ramiz Lladrovci. E hap diskutimin lidhur me mocionin e Lidhjes Demokratike.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupit parlamentar nuk i pengon për ta shtyrë për seancën tjetër këtë pikë të rendit të ditës, por konstatimi i kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së se ka të gjetura nuk ekziston, sepse Komisioni ka konstatuar se nuk ka pasur të gjetura, nuk ka shkelje në raport. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i "Vetëvendosjes", zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Raporti natyrisht se ka të gjetura, se mos të kishte pasur të gjetura s'ishte prodhuar si raport.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes „Vetëvendosje“ natyrisht që edhe një herë po them e dënon këtë mos seriozitet të Qeverisë, sepse këtu po flasim për një raport të një Komisioni hetimor që është krijuar me 2/3 e këtij Kuvendi dhe raporti ose Komisioni edhe raporti e ka në shënjestër edhe angazhimin e Qeverisë për një çështje të caktuar përveç tjerash dhe ky mos seriozitet i Qeverisë, natyrisht që duhet vërtet të dënohet nga Kuvendi, konsideroj unë, që të marrim pjesë në ato pika ku ata janë të domosdoshëm, për shkak se mënyra e vetme që i ka mbetur këtij Kuvendi është të paktën t' i diskutojë dhe të ballafaqohet me Qeverinë për këto çështje, ndërkohë që ata edhe këtij ballafaqimi po i ikin.

Më së miri kishte me qenë siç ishte ideja fillestare, natyrisht që këtë kërkesë ta bëjë kryetari i Komisionit Hetimor e jo ndonjë prej grupeve parlamentare, por si do qoftë ne e

përkrahim që të shtyhet dhe kërkohet po ashtu nga Kuvendi që në njëfarë mënyre t'u bëjë obligative Qeverisë që të marrin pjesë kur të diskutohet kjo pikë në javën e ardhshme, po qe se diskutohet në javën e ardhshme.

KRYETARI: Në emër të Aleancës, kryetari i Grupit Parlamentar, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kryetar!

Edhe ne mendojmë se është jashtëzakonisht serioze të mos e kemi Qeverinë këtu sot dhe mendojmë se duhet të shtyhet dhe definitivisht të jetë e qartë se nuk mund të shqyrtohet raporti i Komisionit Hetimor pa prezencën e Qeverisë këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Duke parë rekomandimet që kanë dalë nga ky Komision Hetimor duhet të jemi transparent se këto janë rekomandime të cilat i drejtohen Zyrës së Rregullatorit, i drejtohen Çelik Limakut dhe ndërsa ne në afekt kemi pasur çështjen e faturimit në muajt e fundit të vitit, mirëpo për arsye pasi që s'janë ministri i Zhvillimit Ekonomik këtu dhe ministri i Financave, atëherë këtë raport mund ta lëmë për një seancë të ardhme.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të SLS Petar Miletqi e ka fjalën.

PETAR MILETIĆ: Podržavamo odlaganje tačke.

KRYETARI: Në emër të 6+ , kryetarja Myfera Shinik e ka fjalën.

MÜFERA ŞİNİK: Başkanın önermiş olduğu 9. noktanın ertelenmesini kabul ediyoruz.

KRYETARI: Në emër të “Zajednička Budućnost”, Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedniče!

I Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” slaže se da se tačka odloži za narednu sednicu.

KRYETARI: Faleminderit! Tash po shkojmë në procedurë të votimit për shtyrje për një seancë tjetër.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash.
Janë 74 deputetë të pranishëm fizik. Regjia, votojmë tash.

Me 67 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim - Shqyrtimi i raportit përfundimtar të Komisionit Hetimor Parlamentar shtyhet për seancën e radhës.

(Ndërprerje e incizimit)

Të nderuar deputetë, tani e votojmë raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2012.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatoj se me 54 vota për, 9 kundër dhe 2 abstenime, Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2012.

Tani votojmë Raportin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për masat mbrojtëse të importit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatoj se me 59 vota për, 10 kundër dhe 1 abstenim Kuvendi e miratoi raportin me rekomandimet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit numër 04/L-047 për masat mbrojtëse të importit.

Dhe e votojmë pikën e tetë:

- Raporti vjetor të performansës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se me 67 vota për, 2 kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi raportin vjetor të performansës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012, bashkë me rekomandimin e Komisionit funksional.

Dhe tani kalojmë në pikën e dhjetë të rendit të ditës:

10. Zgjedhja e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në bazë të nenit 6 të Ligjit për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, ka zhvilluar procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve për drejtor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës i ka rekomanduar për votim dy kandidatë për drejtor të kësaj Agjencie.

Kuvendi prej 2 kandidatëve për drejtor të Agjencisë të Agjencisë zgjedh 1 kandidat me votim të fshehtë.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Bujqësi dhe Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, nuk është këtu. Kush e do fjalën në emër të Komisionit?
Fjalën e ka deputeti Salih Morina, në emër të Komisionit.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor, në bazë të nenit 6 të Ligjit për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, në disa mbledhje të mbajtura zhvilloi procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve për drejtor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, ndërsa në mbledhjen e mbajtur më 2 korrik 2013 vendosi njëzëri që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim:

I rekomandohen Kuvendit për votim kandidatët për drejtor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, të radhitur sipas rezultateve të poentimit si në vijim:

- Safet Goxhuli, i ka 8.35 dhe
- Idriz Blakaj, i ka 8.57.

Kuvendi prej 2 kandidatëve për drejtor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës e zgjedh 1 kandidat me votim të fshehtë.

Arsyetimi:

Komisioni në pajtim me nenin 6 të Ligjit për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, me 3 qershor 2013 ka shpallur konkursin publik për paraqitjen e kandidatëve për drejtor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, në afatin e paraparë me konkurs kanë aplikuar 8 kandidatë dhe atë:

1. Idriz Blakaj,
2. Safet Goxhuli,
3. Sejdi Halimi,
4. Ismajl Rudari,
5. Ramë Hamzaj,
6. Valbona Kastrati,
7. Nexhip Sheholli dhe
8. Flaka Sejfullahu.

Prandaj ne i rekomandojmë Kuvendit të Kosovës se janë 2 kandidatë të përzgjedhur zotin Safet Goxhuli dhe zotin Idriz Blakaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, ju njoftoj se në bazë të nenit 6 të Ligjit për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, zgjedhja e drejtorit të agjencisë bëhet me votim të fshehtë, me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm për mandat pesëvjeçar, pa të drejtë rizgjedhje.

Për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet krijimi i një Komisioni votues në përbërje nga një deputet prej secilit grup parlamentar, me mbështetje të zyrtarëve të Administratës.

Fillojmë me grupin e parë. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, cilin kandidat e keni? Fjalën e ka deputeti Elmi Reçica.

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i PDK-së e propozon deputeten Xhevahire Izmaqi për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë së Menaxhimit të Komplekseve Memorialë të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ismet, kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar! Ne e propozojmë deputeten Afërdita Shaqiri.

KRYETARI: Faleminderit! Nga “Vetëvendosja”, kryetari i Grupit, Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERY: Faleminderit, kryetar!
Ne propozojmë deputeten Albana Gashi.

KRYETARI: Në emër të Aleancës, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ne propozojmë deputetin Bali Muharremi.

KRYETARI: Kryetarja e Koalicionit, propozimi juaj?

MYZEJENE SELMANI: Zonjën Sevdije Lama.

KRYETARI: SLS-ja?

PETAR MILETIĆ: Predlažemo Murselja Haljiljia!

KRYETARI: Grupi “6+”

MUFERA SHINIK: Grupi “6+” e propozon deputetin Enis Kervan.

KRYETARI: Faleminderit! Edhe Grupi Parlamentar “Zajednička Budućnost”, Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Predlažemo Bobana Todorovića.

KRYETARI: Atëherë na duhet një votim formal. Kush është për këtë Komision? Faleminderit! A ka kush kundër? Nuk ka. Atëherë e lus Komisionin që t’i zë vendet e veta.

Amir Ahmeti, Adem Grabovci, Afërdita Shaqiri-Berisha, Afrim Hoti, Afrim Kasolli, Gëzim Kelmendi, Agim Kuleta, Ahmet Isufi, Albana Fetoshi, Albana Gashi, Ardian Gjini, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Burim Ramadani, Daut Haradinaj, Ali Sadriu,

Albert Kinolli, Alma Lama, Anton Çuni; Arben Gashi, Armend Zemaj; Aurora Bakalli, Azem Syla, Bahri Thaçi; Lutfi Haziri, Arsim Bajrami, Bali Muharremi, Berat Buzhala; Behar Selimi, Amir Ahmeti, shkoi, Bekim Haxhiu; Biserka Kostiq, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra; Danush Ademi, Donika Kadaj-Bujupi, Duda Balje, Elmi Reçica; Emilija Rexhepi, Enis Kervan, Nait Hasani; Eqrem Kryeziu, Etem Arifi, Fadil Demaku; Fatmir Limaj, Fatmir Xhelili, Jeton Svirca; Flora Brovina, Florin Krasniqi, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca; Goran Marinkoviq, Nijazi Idrizi, Haki Demolli; Halit Krasniqi, Hamza Balje, Hydajet Hyseni-Kaloshi, Hashim Deshishku, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami; Emin Gërbeshi, Idriz Vehapi; Imri Ahmeti, Ismet Beqiri, Jakup Krasniqi; Jasmina Zhivkoviç;

(Drejtimit e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti)

KRYESUESI: Jelena Bontiq, Justina Pula; Kymete Bajraktari, Latif Gashi; Liburn Aliu, Lirije Kajtazi; Lumnije Morina; Lutfi Haziri, Lutfi Zharku, Fikrim Damka; Kurtan Kajtazi, Suzan Novobërdaliu, Mufera Shinik; Muhamet Mustafa, Mursel Halili, Myzejene Selmani; Naser Osmani, Nazane Breca, Kimete Bytyqi; Sasha Millosavljeviq, Petar Miletiq, Rada Trajkoviq; Ramë Vataj, Ramiz Kelmendi, s'është, Ramiz Lladrovci, Rasim Demiri, Rexhep Selimi, Rita Hajzeraj-Beqaj; Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala; Sali Asllanaj, Salih Morina, Salihe Mustafa; Sasha Djokiq, Milivoje Stojanoviq; Sevdije Lama; Shaip Muja; Skënder Hyseni, Boban Todoroviq, Sreten Ivanoviq, Teuta Haxhiu, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Ukë Rugova; Vesimir Saviq, Vesna Mikiq, Visar Ymeri; Vjollca Krasniqi, Vjosa Osmani; Valbona Dibra, Xhevahire Izmaqu; Xhevdet Neziraj, Zenun Pajaziti; Xhavit Haliti.

ENIS KERVAN: Sefer Goxhuli, Idriz Blakaj, Sefer Goxhuli, Sefer Goxhuli, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, e pavlefshme, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, Sefer Goxhuli, Sefer Goxhuli, e pavlefshme, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, Sefer Goxhuli, Idriz Blakaj, Sefer Goxhuli, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, Sefer Goxhuli, Sefer Goxhuli, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, e pavlefshme, Sefer Goxhuli, Idriz Blakaj, Sefer Goxhuli, Sefer Goxhuli, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, Sefer Goxhuli, Sefer Goxhuli, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, e pavlefshme, e pavlefshme, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, Sefer Goxhuli, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, Sefer Goxhuli, e pavlefshme, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, e pavlefshme, e pavlefshme, Sefer Goxhuli, Sefer Goxhuli, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, e pavlefshme, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, Sefer Goxhuli, Sefer Goxhuli, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, e pavlefshme, Idriz Blakaj, Idriz Blakaj, e pavlefshme, Sefer Goxhuli, Sefer Goxhuli.

KRYESUESI: Fjalën e ka Komisioni.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni Votues, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e

Komplekseve Memoriale të Kosovës, në mbledhjen plenare të mbajtur më 12 korrik 2013, konstaton, si në vijim:

Në votim kanë marrë pjesë gjithsej 83 deputetë.

Të pavlefshme janë 11 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë si në vijim:

- Sefer Goxhuli ka fituar 22 vota,
- Idriz Blakaj ka fituar 50 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 6 të Ligjit për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës dhe nenin 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se zoti Idriz Blakaj zgjidhet drejtor i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës me mandat pesëvjeçar, pa të drejtë rizgjedhje. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, me kaq e përfundojmë seancën e sotme. Mirupafshim javën e ardhshme në seancën e re!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*